

# BULETINI

REVISTË HULUMTUESE, FETARE, SHKENCORE  
vëllimi 9, nr. 1

SCIENTIFIC RELIGIOUS JOURNAL  
volume 9, no. 1 / 2025

Të gjitha temat e botuara në “Buletin” janë të skanuara me programin  
*Inspera originality*, dhe nuk janë konstatuar plagjiat.

Baza e të dhënave dhe indekset ku skanohet revista:



Boton: **Fakulteti i Studimeve Islame**

**Dekani**

Prof. Asoc. Dr. Islam Hasani

**Redaktor përgjegjës**

Prof. Ass. Dr. Rexhep Suma

**Redaksia**

Dr. Ajni Sinani

Prof. Ass. Dr. Lulzim Esati

Prof. Dr. Fahrush Rexhepi

Prof. Ass. Dr. Zija Abdullahu

Prof. Ass. Dr. Musa Vila

**Këshilli redaktues ndërkombëtar**

1. Prof. Asoc. Dr. Diane Chapman, North Carolina State University, USA.
2. Prof. dr. Elez Osmani, Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, Shqipëri.
3. Prof. Ass. Dr. Feim Gashi, Kırklareli University, Turkey.
4. Prof. Asoc. Dr. Muhamed Ali, University of Sharjah, United Arab Emirates.
5. Prof. Ass. Dr. Jashar Sherif, University of Thessalonik, Greek .
6. Prof. Ass. Dr. Hajrudin Hodžić, Faculty of Pedagogy in Bihać, Bosnia and Herzegovina.
7. Prof. Asoc. Dr. Ziber Lata, Fakulteti i Shkencave Islame, Shkup, Maqedonia e Veriut .
8. Dr. Eduard Caka, studiues nga Instituti i Historisë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë.
9. Dr. Behlul Kanaqi, profesor në Medresenë “Mehmed Fatih” - Mali i Zi.
10. Prof. Asoc. Dr. Khalif Muammar A. Harris, Faculty of Social Sciences and Humanities Universiti Teknologi Malaysia.

**Sekretar i redaksisë**

Mr. Vedat Shabani

**Redaktor gjuhësor**

Prof. Ass. Dr. Ferid Selimi

**Redaktor teknik dhe ballina**

Nuhi Simnica

**Shtypi**

“Printing press”- Prishtinë

**Adresa**

@ Fakulteti i Studimeve Islame

Rr. Bajram Kelmendi Nr.174, P.O.Box.10000, Prishtinë

Tel dhe Fax: 038-243-887

www.buletini.net    www.fsi-edu.net    buletini@info.net    facebook.com/buletiniFSI  
p-ISSN 3007-3677    e-ISSN 3078-7467    CEOOL



FAKULTETI I STUDIMEVE ISLAME I PRISHTINËS

# BULETINI

REVISTË HULUMTUESE, FETARE, SHKENCORE  
vëllimi 9, nr. 1

SCIENTIFIC RELIGIOUS JOURNAL  
volume 9, no. 1 / 2025

p-ISSN 3007-3677

e-ISSN 3078-7467



KDU 28(05)

Prishtinë  
2025



# Përmbajtja

---

<b>EDITORIALI</b>	<b>7</b>
Braktisja e vetvetes	9
<b>ARTIKUJT</b>	<b>19</b>
Në kujtim të profesorit dhe dekanit të parë të Fakultetit të Studimeve Islame Doc. Dr. Rexhep ef. Bojës (20.06.1946-14.09.2021) <i>Prof. Asoc. Dr. Islam Hasani</i>	21
Thirrja islame në kohën e katër halifëve - Ebu Bekri r.a. <i>Prof. Ass. Dr. Rexhep Suma</i>	27
Komentimi i Kuranit nga h. Sherif Ahmeti <i>Dr. Azmir Jusufi</i>	59
Koncepti i Vahjit (Shpalljes) në këndvështrimin islam dhe në atë perëndimor <i>Prof. Ass. Dr. Valmire Batatina- Krasniqi</i>	75
Metodologjia e shkrimit të hadithit në librin El Athar të Imam Muhamed Ibën El Hasan Esh Shejbanit <i>Dr. Muhamed Stublla</i>	95
Veshja e mëndafshit mes të ndaluarës dhe të lejuarës <i>Prof. Ass. Dr. Ilmije Kuçi</i>	113
Myftiu në Malin e Zi me seli në Ulqin (1881-1887) sipas dokumenteve arkivore <i>Mr. Ali Bardhi</i>	127
Mediat shqipe në Kosovë dhe përdorimi i internetit në informimin për pandeminë Corona-19 <i>Prof. Ass. Dr. Ferid Selimi</i>	149
<b>KRONIKË</b>	<b>161</b>
Aktivitete të Fakultetit të Studimeve Islame 1 janar 2024 - 30 qershor 2024 <i>Mr. Vedat Shabani</i>	163



# EDITORIALI



## Braktisja e vetvetes

Koha postmoderne e post të vërtetës dhe sistemet e saj po jeton apo synon të jetojë në folklorizma apo spektakle, ku me anë të tyre po fshihet realiteti, që po tentojnë të instrumentalizojnë. Mjedisi shqiptar historikisht është karakterizuar me një frymë të tolerancës, ku fetë dhe komunitetet e tjera, krahas atij me shumicë absolute, shqiptarëve myslimanë, kanë jetuar nën hijen e harmonisë, respektit e dashurisë njerëzore, që për opinionin evropian dhe botëror ka qenë shembull e model. Statistikat zyrtare të publikuara nga entet statistikore shtetërore flasin, se shqiptarët me shumicë absolute janë të përkatësisë islame dhe kanë respektuar dhe nderuar fetë dhe komunitetet e tjera pa ushtruar dhunë apo çfarëdo lloj presioni tjetër. Feja në mesin shqiptar është kuptuar dhe praktikuar si diçka shpirtërore dhe larg folklorizmave. Asnjëherë nuk ka pasur këso spektaklesh konvertimesh çfarë po përjeton Kosova në këto muajt e këtij viti. Personat e konvertuar bazuar në të kaluarën e tyre nuk kanë qenë besimtarë praktikantë të fesë islame dhe u kanë munguar edhe njohuritë bazike për islamin. Ata i kanë dhënë vetës të drejtë të flasin, të interpretojnë dispozitat e fesë, si dhe të fyejnë çdo gjë. që është islame, me pretekstin që të kthehemi në fenë e të parëve, që aludohet në katolicizëm. Ushtrimi i bindjes fetare është e garantuar me kushtetutë dhe me akte juridike. Disa medie po kontribuojnë në krijimin e një klime të intolerancës dhe të diskriminimit, duke u ofruar hapësirë mediale të konvertuarve dhe kjo po merr formën e spektakleve televizive, e jo, që është e drejtë e secilit të deklarohet dhe të shfaq besimin e tij çfarëdo qoftë, por jo edhe duke bërë dhunë psikologjike e presion mbi popullatën shumicë absolute të Kosovës me besim islam. Kushtetuta parashikon të drejtën e lirisë së ndërgjegjes dhe fesë për të gjithë qytetarët, përfshirë të drejtën për ta ndërruar, shprehur apo për të mos e shprehur besimin fe-

tar; për ta ushtruar fenë apo për të mos e ushtruar fenë; dhe për t'iu bashkuar apo refuzuar bashkimit të një bashkësie fetare. Edhe nga aspekti fetar, secili ka të drejtë të zgjedh të besojë apo jo. **“E ti thuaj: “E vërteta është nga Zoti juaj, e kush të dojë, le të besojë, e kush të dojë, le të mohojë...”**. (El Kehf, 29).

Islami e ka mbajtur në këmbë identitetin kombëtar, andaj këto lëvizje siç është “Lëvizja e Deçanit”, apo “Lëvizja për braktisjen vullnetare të fesë islame” e që më vonë shfaqet haptazi qëllimi i tyre për të bërë thirrje në kthimin në fenë e të parëve, duke aluduar në katolicizëm. Kjo nismë nuk do të ketë efekt dhe do të jenë të dështuar ata që e pretendojnë këtë, sepse nuk ka bazë, mbështetje dhe shtrirje në kombin tonë, dhe si ideologji ndihmon në shpërbërjen e kombit shqiptar. Akterët e kësaj lëvizjeje, fillimisht kishin propaganduar se po ruajnë trungun shqiptar nga siç thonë ata “interpretimet e gabuara të mësimave islame”, dhe kjo sipas tyre përbën shkelje të ndjenjave kombëtare. Kjo aspak nuk qëndron, sepse predikuesit islam nuk bëjnë klasifikime të tilla, porse ata janë të obliguar të përçojnë frymën e tolerancës, harmonisë dhe respektin e dashurisë ndërnjerezore.

Kjo ka bërë që të ketë reagime nga më të ndryshmet si të krerëve të institucionit të BIK-ut po ashtu edhe të personaliteteve të jetës politike, akademike, kulturore, etj. Krijimi i ndasive dhe i urrejtjes së tillë ka bërë të reagojë edhe Këshilli i Bashkësisë Islame në Deçan. “Ju kujtojmë se populli ynë me besimin islam, dhe besimet e tjera, ka ditur të ruajë dhe të kultivojë paqen dhe tolerancën ndër-fetare, fakt i çmuar shumë përgjatë historisë sonë. Mbështetur në këtë fakt, lëvizjet e tilla kanë tendencë qëllimkëqija dhe atakojnë atmosferën e shkëlqyeshme të ndërtuar me shekuj te ne, sepse me këtë, veçanërisht sulmohet Islami”, thuhet në reagimin e KBI-së në Deçan. Po në këtë rrafsh Lidhja e Historianëve të Kosovës “Ali Hadri” dega në Deçan, ka reaguar ashpër dhe shpreh shqetësimin e saj në lidhje me një organizim të tillë, ku persona tashme të njohur edhe për publikun, kanë manifestuar, duke nxitur urrejtje deri në mos durim në një aktivitet me qëllime propagandimin fetar. Kjo iniciati-

ve e thirrur në emër të një të ashtuquajture “Lëvizje: Braktisja vullnetare e fesë islame”, nuk është asgjë me shumë e asgjë më pak se sa thirrje dhe nxitje urrejtjeje mes komuniteteve të caktuara fetare në Kosovës. Për këtë kjo është e papranueshme dhe e dënueshme.

\* \* \*

E ardhmja i përket pluralizmit dhe tolerancës për ta bërë të mundshme bashkëjetesën. Burimet dhe dokumentet historike dëshmojnë qartë dhe shkencërisht se shqiptarët assesi nuk përquafuan Islamin nën dhunë e terror e shpatë. Studiuesi Noel Malcolm, duke shpjeguar këtë fenomen në librin e tij “Kosova një histori e shkurtër”, vë theksin se gjendja e përgjithshme e kishës nuk ishte e mirë. Ankesat për mungesën e priftërinjve katolikë vazhduan edhe gjatë shekullit XVII (Në një raport të vitit 1630 thuhet se “mijëra” katolikë të trevës së Prizrenit po e humbnin fenë për këtë shkak. Se disa ndër pjesëtarët e klerit kishin përgatitje të dobët’. Sipas një françeskani, që vizitoi Gjakovën, në vitin 1638, katolikët po kalonin në fenë islame jo vetëm për shkak të mungesës së priftërinjve, por edhe për shkak të paaftësisë dhe të paditurisë së priftërinjve, që shërbejnë në Gjakovë. Në vitin 1661, Pjetër Bogdani vinte në dukje në një raport, se prifti i Famullisë së Prizrenit, Gregor Mazreku” e kalon pothuajse tërë kohën, duke bërë qejf, duke pirë derisa e humbte veten. (Malcolm, 2011:181).

Një nga prioritet më qenësore të elitave tona politike do të duhej të ishte ruajtja me ligj dhe moscënueshmëria e tolerancës dhe e harmonisë ndërjetare të shqiptarëve nga impakti dhe nga duart e zeza, që kanë për qëllim mbjelljen e përçarjeve të kombit tonë. Sigurisht se kjo arrihet, duke forcuar dhe fuqizuar raportet vëllazërore të brendshme kombëtare, pa i prekur dhe as lënduar ndjenjat fetare të askujt. Mozaiku dhe diversiteti që kanë shqiptarët, qoftë të natyrës fetare, gjuhësore a krahinore, përbën një nga karakteristikat që populli ynë të krenohet. Respektimi i diversiteteve, mendimeve, harmonisë dhe respektit ndërjetar mes nesh duhej të shihej si asete kombëtare, që krijojnë ura uniteti dhe fuqizimi si fe dhe si

komb, dhe duke qenë ndryshe nga njëri-tjetri nuk do të thotë se nuk mund të bashkëpunojmë në të mirë të njëri-tjetrit dhe të vendit tonë. Ky fakt, gjeneratave të reja do t'u garantonte stabilitet dhe tejkalim të sfidave, që i presin në shekullin 21, siç janë problemet më të mëdha, që janë grumbulluar: zbrazja e trojeve tona, kazinotë, përdorimi i drogës (për fat të keq, sipas statistikave zyrtare, përdoruesit e saj kanë nën moshën 11 vjeçe), përkujdesja shëndetësore, niveli i arsimit, edukimi i mirëfilltë i të rinjve, etj.

\* \* \*

Ky numër i Revistës përfshinë 7 artikuj kërkimorë kryesorë, një artikull *In memoriam*, dhe kronikën e aktiviteteve të Fakultetit të Studimeve Islame, ku secili duke hedhur dritë mbi mënyrat e ndryshme në të cilat tradita ligjore dhe teologjike islame është formësuar dhe ndërthurur me shoqëritë paramoderne dhe moderne. Punimi i parë është “Në kujtim të profesorit dhe dekanit të parë të Fakultetit të Studimeve Islame – Doc. Dr. Rexhep ef. Bojës” nga autori Prof. Asoc. Dr. Islam Hasani, i cili theksoi se më 14 shtator 2024 u bënë tre vite, që kur imami, pedagogu, studiuesi, myftiu, dekani, udhëheqësi i Bashkësisë Islame të Kosovës, veprimtari dhe diplomati i Kosovës, Dr. Rexhep ef. Boja kaloi në botën e amshuar. Me rastin e këtij përvjetori, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, më datën 18-19 tetor, 2024 organizoi konferencën shkencore “Dr. Rexhep Boja - prijës, vizionar dhe burrshtetas i shquar”, në të cilën morën pjesë shume personalitete të shquara, udhëheqës fetarë, diplomatë, politikanë dhe bashkëpunëtorë e studiues nga vendi, rajoni dhe Bota, e ku u shpalosen të dhëna jetëshkrimore dhe u kujtua e u vlerësua puna e frytshme e dr. Rexhep ef. Bojës. Në fushën shkrimore, dr. Rexhep Boja është autor i shumë studimeve në fusha të ndryshme, me të cilat është paraqitur në konferenca e simpoziume dhe i artikujve të shumtë, që janë botuar në gazeta e revista vendore e ndërkombëtare në gjuhën shqipe dhe në atë arabe. Intervistat e tij dhënë shtypit vendor dhe atij ndërkombëtar, vazhdimisht kanë ofruar informacione të nevojshme për gjendjen

në Kosovë, në veçanti për dhunën dhe terrorin, që ushtronte okupatori serb në Kosovë. Gjithashtu, është edhe autor i dy librave: “*Shqiptarët (Arnautët) dhe Islami – Myslimanët në ish-Jugosllavi*”, botim në gjuhën arabe, pjesa e parë përmban disertacionin e magistraturës, ndërsa pjesa tjetër e librit përmban disertacionin e doktoratës. Dr. Rexhep Boja ka botuar në gjuhën shqipe edhe librin “*Për një të nesërme më të mirë*” (botoi: Kryesia e BIK-ut, Prishtinë, 2003).

Në vijim Prof. Ass. Dr. Rexhep Suma sjell artikullin “Thirrja islame në kohën e katër halifëve - Ebu Bekri r.a.”, Si një nga shokët më të afërt të Muhamedit a.s., që ishte, ai kishte një pozitë të lartë në zemrat e myslimanëve dhe kishte një ndikim të madh në drejtimin dhe udhëzimin e tyre drejt të mirës dhe të drejtës. Para dhe pas vdekjes së Muhamedit a.s., ai bënte përpjekje të mëdha për të ftuar njerëzit të besonin në Allahun e vetëm dhe profetin e Tij, dhe kishte një rol kyç në stabilizimin e myslimanëve në Islam dhe në udhëzimin e tyre. Pas marrjes së halifatit, ai pati një rol kryesor në drejtimin e përpjekjeve për të përhapur Islamit dhe për të mbrojtur dhe mbajtur e unifikuar qëndrimet dhe fjalën e myslimanëve karshi sfidave të mëdha, që e shoqëruan islamit dhe da’ven në përgjithësi në këtë kohë. Në kohën e Ebu Bekrit, thirrja islame u përhap gjerësisht nëpër territore të reja dhe u përball me sfida të ndryshme. Ai përballë me rebelime në disa pjesë të qeverisjes së tij, duke përfshirë ndërprerjen e të dërguarit të zekatit nga disa fiset arabe. Megjithatë, ai arriti të ruajë unitetin e komunitetit mysliman dhe të zgjeronte territorin e halifatit. Përveç përpjekjeve në zgjerimin territorial, Ebu Bekri u fokusua gjithashtu në mbledhjen e të dhënave të shkruara të fjalëve të Muhamedit a.s., dhe në rregullimin e tyre në një formë të shkruar, të njohur sot si Kuran. Për të forcuar strukturën e shtetit mysliman, ai gjithashtu kreu disa ndryshime administrative dhe ushtarake.

Punimi i tretë me titull “Komentimi i kuranit nga h. Sherif Ahmeti”, i autorit Dr. Azmir Jusufi, shpjegon se përgjithësisht bëhet fjalë për komentimin e Kuranit nga një prej figurave më të shquara të shqiptarëve në Kosovë dhe më gjerë, Haxhi Sherif Ahmetin. Prandaj, para së gjithash,

bëhet fjalë për nevojën dhe vlerën e komentimit të Kuranit dhe për Sherif Ahmetin si komentues të parë të komentimit komplet të Kuranit në gjuhën shqipe. Gjithashtu, në punim bëhet fjalë për metodologjinë e përdorur gjatë komentimit të Kuranit nga ky erudit midis popullit shqiptar; për komentimin e Kuranit në frymën e kohës dhe të nevojave të njerëzve, si dhe për përdorimin e hadithit gjatë komentimit të Kuranit, etj. Punimi, në përgjithësi jep pasqyrë për kontributin e Sherif Ahmetit në fushën e komentimit të Kuranit në gjuhën shqipe dhe se Sherif Ahmeti la pas veprimtarinë e shkruar në fushën e komentimit të Kuranit në gjuhën shqipe në revistat islame në Kosovë, siç janë: “Takvim”, “Edukata Islame” dhe “Dituria Islame”.

Në vazhdim kemi paraqitur punimin e radhës, “Koncepti i vahjit (shpalljes) në këndvështrimin islam dhe perëndimor” nga Prof. Ass. Dr. Valmire Batatina- Krasniqi, ku trajtimi i kësaj tematike nga këndvështrimi tefsiror, pra brenda kornizës së integritetit të Kur’anit fisnik dhe të kuptimit të tij gjuhësor, pa dyshim ka edhe rëndësinë e veçantë për të vënë në pah kuptimin e vërtetë të vahjit. Koncepti i vajit, pa dyshim që zgjoi vëmendjen e shumë studiuesve islam dhe të tjerë dhe në lidhje me të u sollën përkufizime, trajtime dhe qëndrime të ndryshme. Nga ky këndvështrim në këtë studim sillen njohuri mbi kuptimin tefsiror-kuranor të konceptit të vahjit, përkufizimet, përmbajtjen, mënyrat e shpalljes dhe qëndrimet e dijetarëve islam dhe të autorëve perëndimor në lidhje me të.

Në vijim kemi punimin, “Metodologjia e shkrimit të hadithit në librin El Athar të Imam Muhamed Ibën El Hasan Esh Shejbanit” nga autori Dr. Muhamed Stublla. Ky studim është autorial, është rezultat i leximit dhe i analizës së secilit transmetim, andaj, kemi paraqitur transmetimet nga Muhamedi a.s., sahabët dhe tabiinët. Ky studim përfshin numrin e kapitujve, temat e tyre, transmetimet dhe atribuimi i tyre nga autorët e atyre transmetimeve, pastaj i kemi krahasuar mes vete. Vlen të theksohet se, kemi përcaktuar disa nga kriteret që autori i librit kishte në konsideratë gjatë shkrimit të transmetimeve. Rëndësia e studimit të kësaj teme shfaqet përmes këtyre njohurive: Njohja me librin dhe autorin e tij, veçanë-

risht pasi që autori është prej dijetarëve, literatura e të cilit është pranë neve dhe ky libër është prej librave të parë të hadithit; Kuptimi i metodologjisë së autorit, si dhe njohja e kushteve apo e kritereve në libër, bëhet më i lehtë.

Autorja Prof. Ass. Dr. Ilmije Kuçi, ka paraqitur temën “Veshja e mëndafshit mes të ndaluarës dhe të lejuarës”, ku çështja e veshjes në Islam, qoftë për burrat apo gratë, është një nga çështjet e rëndësishme në Legjislacionit Islam, andaj dhe juristet i kanë kushtuar vëmendje të veçantë kësaj çështje dhe kanë përcaktuar kapituj të veçantë për rregullat e saj. Në të vërtetë fokusimi i saj shon drejt sqarimit të dispozitës së veshjes së mëndafshit për burrat. Sepse, legjislacioni Islam ka lejuar që burrat dhe gratë të zbukurohen, veçanërisht me veshje, por njëkohësisht ka bërë edhe disa kufizime, duke përfshirë ndalimin e disa llojeve të veshjeve si për burrat ashtu edhe për gratë, ndërsa disa vetëm për burrat, në përkushtim ndaj Zotit të Madhëruar. Ai i lejoi disa gjëra dhe i ndaloi disa gjëra të tjera, jo për t'i kufizuar njerëzit, por për t'u përmbajtur kufijve dhe rregullit në univers. Kjo, sepse Zoti xh.sh., është i Urtë në urdhrat dhe ndalesat e Tij. Ai nuk urdhëron përveç asaj që është në interes të njeriut dhe nuk ndalon përveç asaj që është e dëmshme për të, ku urtësia e këtyre urdhëresave dhe ndalesave mund t'i shfaqet krijesave të Tij dhe mund të mos i shfaqet.

Autori, Mr. Ali Bardhi sjell studimin e tij empirik të titulluar “Myftiu në Malin e Zi me seli në Ulqin (1881-1887) sipas dokumenteve arkivore”.

Tema që ka marrë në shqyrtim për të trajtuar ka të bëjë me institucionin e Myftinisë në Malin e Zi në periudhën nga Kongresi Berlinit deri te Konferenca e Londrës, me theks në çështjen e emërimit të myftiut në bazë të dokumentacionit arkivor dhe të studimeve të publikuara. Në këtë artikull janë trajtuar çështjet që ndërlidhen me institucionin e Myftinisë që nga formimi i tij me seli në Ulqin në kufijtë e Malit të Zi, të dalë nga Kongresi i Berlinit, zhvendosjes së tij nga Ulqini në Podgoricë, kompetencat e emërimit dhe shkarkimit të myftiut, vendi prej nga vjen ai, përkatësinë e tij kombëtare, gjuhën, etj. do theksuar që ky institucion i

Myftinisë ishte formuar në kuadër të nenit 27 të Kongresit të Berlinit, i cili përfshin intervalin kohor mars 1881 - qershor 1912. Në këtë kuadër myftinjët u emëruan nga Shejhu'l-Islami në Stamboll dhe u miratuan nga krajli i Malit të Zi.

Prof. Ass. Dr. Ferid Selimi ka zhvilluar një hulumtim rreth përdorimit të internetit nga mediat shqipe në Kosovë në funksion të informimit për Pandeminë COVID-19” ku rrah një çështje të informimit të qytetarëve të Republikës së Kosovës rreth dhe për pandeminë COVID-19. Qëllimi i punimit ishte që të nxjerr në pah se cilat burime të informacionit janë përdorur nga qytetarët e Republikës së Kosovës dhe cilat nga to ishin më të besueshme. Objektivat e punimit janë që të jepet një pasqyrë e qartë rreth përdorimit të internetit, mediave sociale dhe rrjeteve sociale nga qytetarët e Republikës së Kosovës. Nga ky hulumtim del që gazetat e shtypura janë përdorur më së paku rreth informacioneve, që kishin të bënin me pandeminë COVID-19, nga fakti se që nga marsi i vitit 2020, ato më nuk funksionojnë në Kosovë, por që qytetarët mund të përcillnin gazetat ditore të shtypura në shtetet e rajonit. Për përdorim të burimeve informative, qytetarët janë shërbyer dhe shërbehen edhe nga televizionet dhe radiot, të cilat sipas tyre janë më të besueshmet, sa u përket burimit të informacionit. Pra, edhe pse pjesa dërrmuese e qytetarëve, thuhet tërë informimin për pandeminë COVID-19 e kanë marrë nga mediat sociale dhe rrjetet sociale, megjithatë, këtyre burimeve të informacionit nuk i kanë besuar sa u kanë besuar burimeve të informacionit nga televizionet dhe nga radiot.

Në fund të këtij numri të revistës “Buletini”, Mr. Vedat Shabani, ka bërë përmbledhjen e aktiviteteve të Fakultetit të Studimeve Islame.

\* \* \*

*Lexues të nderuar!*

Revista “Buletini” që nga numri i kaluar është indeksuar dhe pajisur me numrin ISSN 3007-3677 (Print) nga Qendra ISSN në Paris, si dhe më 26.12.2024 është indeksuar nga po e njëjta Qendër edhe në versionin online me numër ISSN 3078-7467, gjithashtu është në rrugë të mirë të antarësohet edhe në platformat e revistave të indeksuara me kredibilitet të lartë ndërkombëtar. Po ashtu më 16 dhjetor 2024 revista “Buletini” është indeksuar edhe në platformën CEEOL (Central and Eastern European Online Library) me qendër në Frankfurt am Main (Gjermani). Platforma CEEOL përmban revista akademike, libra, dhe dokumente kërkimore nga një gamë e gjerë disiplinash, duke përfshirë shkencat humane, sociale dhe studimet kulturore, historike dhe zhvillimeve politike në vendet e Europës Qendrore dhe Lindore.

Këtë ia kemi borxh lexuesit, studentëve tanë si dhe qarqeve akademike. Me këtë rast redaksia vazhdon të mbetet e përkushtuar të bëjë zgjerimin dhe krijimin e hapësirave për hulumtues e studiues të rinj ku do të ofrohet kontribut në disiplinat e saj të përfaqësuara në avancimin e teorie, epistemologjisë, pedagogjisë dhe metodave, por gjithmonë, duke ruajtur frymën e traditës së themelimit dhe objektivave së saj.

Të gjitha temat e botuara në “Buletin” janë të skanuara me programin *Inspira originality*, dhe nuk janë konstatuar plagjiat.

Për fund, shpresën dhe ndihmën e kemi nga Krijuesi fuqiplotë, i Cili jep sukses dhe pranueshmëri të vizionit të Revistës në mesin e komunitetit shkencor edhe më gjerë.

*Prishtinë, janar 2025*

**Prof. Ass. Dr. Rexhep SUMA**

Orcid.org/0009-0009-4920-2838

rexhep.suma@fsi-edu.net

PROFESOR NË FAKULTETIN E STUDIMEVE ISLAME, PRISHTINË

REDAKTOR PËRGJEGJËS I “BULETINI”-t.



**ARTIKUJT**



# Në kujtim të profesorit dhe dekanit të parë të Fakultetit të Studimeve Islame Doc. Dr. Rexhep ef. Bojës (20.06.1946-14.09.2021)

---

Prof. Asoc. Dr. Islam Hasani\*



Më 14 shtator të vitit 2024 u bënë tre vite nga kur imami, pedagogu, studiuesi, myftiu, dekani, udhëheqësi i Bashkësisë Islame të Kosovës, veprimtari dhe diplomati i Kosovës, Dr. Rexhep ef. Boja kaloi në botën e amshuar. Me rastin e këtij përvjetori, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, më datën 18-19 tetor, 2024 organizoi konferencën shkencore “Dr. Rexhep Boja - prijës, vizionar dhe burrështetas i shquar”, në të cilën morën pjesë shumë personalitete të shquara, udhëheqës fetare, diplomat, politikane dhe bashkëpunëtorë dhe studiues nga vendi dhe nga jashtë. Aty u shpalosën të dhëna jetëshkrimore dhe kujtuan e vlerësuan punën e frytshme të Dr. Rexhep ef. Bojës. Në këtë Konferencë kontributin e tyre e dhanë edhe disa pedago-

---

\* Autori Prof. Asoc. Dr. Islam Hasani masterin dhe doktoraturën e ka përfunduar në International Islamic University Malaysia, drejtimi: Islamic Civilization PhD University Malaya Academy of Islamic Studies, drejtimi: Islamic Banking and Finance. Është profesor në Fakultetin e Studimeve Islame në Prishtinë dhe njëherit dekan i këtij Institucioni. E-mail: [Islam.Hasani@fsi-edu.net](mailto:Islam.Hasani@fsi-edu.net); [orcid.org/0000-0001-9893-205](https://orcid.org/0000-0001-9893-205),

gë nga Fakulteti i Studimeve Islame, të cilët ndriçuan aspekte të punës së Dr. Rexhep ef. Bojës si një ndër themeluesit dhe pedagogët dhe dekan i parë i Fakultetit të Studimeve Islame.

Meqenëse aktet e kësaj konference do të botohen së shpejti nga organizatori i kësaj Konference dhe ato do të bëhen pjesë e lexuesit të gjerë, në këtë numër të revistës “Buletini” nuk mund të mos e kujtojmë dhe të mos vlerësojmë punën dhe veprimtarinë e gjithmbarshme të Dr. Rexhep Bojës, e në veçanti kontributin në Fakultetin e Studimeve Islame.

Që në fillim duhet theksuar faktin se Dr. Rexhep Boja pjesën më të madhe të punës dhe jetës së tij e kaloi në Fakultetin e Studimeve Islame, duke qenë pedagog dhe dekan i tij.

Shëmbëlltyra, vizioni, dhe veprimtaria e tij pedagogjike arsimore mbeten si fanarë e ndriçues të Fakultetit të Studimeve Islame, i cili prore vazhdon dhe synon t’i mbajë ato pozita mësimore, arsimore dhe programuese, të cilat, që në fillimet e tij, i vuri dhe i konceptoi Dr. Rexhep Boja me bashkëpunëtorët e tij të palodhshëm, siç ishin pedagogët e shquar, Pajazit Nushi, Ejup Statovci, Qemajl Morina, Resul Rexhepi, Isa Bajçinca, Naim Tërnavë e të tjerë, shumica e të cilëve njëherësh ishin edhe ndër profesorët e parë të Fakulteti.

Falë këtij brezi të prijësve dhe të profesorëve tanë, Fakulteti i Studimeve Islame u bë realitet dhe nisi rrugëtimin e tij drejt dijes, suksesit dhe perspektives së shoqërisë sonë. Fakulteti i Studimeve Islame sot e përgjithmonë do të jetë mirënjohës dhe falënderues ndaj të gjithë atyre, që dhanë kontributin e çmuar në hapjen, mbarëvajtjen dhe në zhvillimin e këtij institucioni të lartë arsimor islam në gjuhën shqipe. Emrat e tyre do të shkruhen me shkronja të arta në historinë e Fakultetit të Studimeve Islame, sepse këta ishin më meritoret për hapjen e fakultetit.

Prandaj sot kur e kujtojmë profesorin dhe dekanin tonë, Dr. Rexhep Bojën, nuk mund të mos kemi ndjenja respekti, dashurie, vlerësimi e mirënjohje të thellë dhe të themi se historia e Fakultetit të Studimeve Islame nuk mund të shkruhet pa Dr. Rexhep Bojën, sepse më të edhe filloi që ta bëjë historinë, fakulteti ynë.

Duke e kujtuar profesorin dhe dekanin tonë, në këtë përvjetor të kalendarit të tij në botën tjetër, do të shpalosim në vija të përgjithshme, disa të dhëna jetëshkrimore për të, të bindur se për Dr. Rexhep Bojën do të shkruhet e do të flitet gjatë, shumë gjatë. Aq sa do të ekzistojë Fakulteti i Studimeve Islame, për të do të mbahen dhe organizohen sesione e konferenca shkencore në vazhdimësi, sepse veprimtaria e Dr. Rexhep Bojës është e shumanshme, ndaj dhe e nevojshme për t'u vështruar në shumë aspekte. Sigurisht që në këtë drejtim, Fakulteti i Studimeve Islame do të jep kontributin e tij, qoftë me organizimin e konferencave shkencore, qoftë edhe me pjesëmarrjen e pedagogëve të tij nëpër këto konferenca.

## Jetëshkrimi i Dr. Rexhep ef. Bojës

Rexhep Boja lindi më 20 qershor të vitit 1946 në fshatin Kërrnicë, të Klinës. Mësimet e para i mori në Pejë, te mualimi dhe hoxha i shquar Hfz. Muhamed ef. Gashi. Pas kryerjes së mejtepit, shkollimin fillor e përfundoi në Shtupel (Klinë), ndërsa të mesëm e përfundoi në Medinë pranë Universitetit Islamik. Më pas, studimet e larta i vazhdoi në Fakultetin e Da'ves në Universitetin Islamik në Medinën e Ndrishme, të cilin e mbaroi me afat rekord dhe me sukses solid. Rrugëtimin e tij në formimin akademik e vazhdoi në studimet e magjistraturës, ku diplomoi në vitin 1981, me temën *“Shqiptarët (Arnautët) dhe Islami”*. Ndërsa, në vitin 1985 doktoroi me temën *“Myslimanët në Jugosllavi”*. Gjatë kohës së studimeve postdiplomike që angazhuar edhe si edukator në kuadër të konvikteve të Universitetit Islamik të Medinës.

Pas përfundimit të studimeve të doktoratës, ndonëse pati oferta për të punuar në Medinë, ai megjithatë, kishte vendosur që të kthehej në vendlindjen e tij, pra në Kosovë, për të dhënë kontributin e tij për popullin e vet, ku fillimisht filloi punën si imam, hatib dhe mualim në “Xhaminë e Kuqe” të Pejës. Po atë vit, angazhohet edhe në Medresenë “Alaudin” për lëndën e jurisprudencës islame (fikh) dhe të Imamitit. Përvoja e Dr. Rexhep Bojës në Medrese bëri që ai pas pak vitesh të kalonte në Kryesinë të Bashkësisë Islame, për t'i udhëhequr myslimanët e Kosovës për 13 vjet

me radhë (1990-2003). Koha kur Dr. Rexhep ef. Boja e ka udhëhequr Bashkësinë Islame të Kosovës, ka qenë koha më e vështirë në shumë aspekte, e në veçanti në aspektin politik. Por, falë gjindshmërisë së tij dhe bashkëpunimit me strukturat udhëheqëse të Bashkësisë Islame, ia doli që me shumë sukses të mbronte interesat e institucionit, të cilin e udhëhiqte dhe të vendit, të cilit i përkiste. Gjatë kësaj periudhe, Bashkësia Islame e Kosovës dhe Dr. Rexhep Boja në krye të saj, kanë dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në shtetformimin dhe shtetndërtimin e Kosovës.



*Dr. Rexhep Boja, në ambientet e Fakultetit të Studimeve Islame, si anëtar i komisionit për vlerësimin e një punimi të diplomës (foto 2009)*

Në vitin 1992, falë rolit të Dr. Rexhep Bojes dhe të bashkëpunëtorëve të tij u themelua dhe nisi punën Fakultetit i Studimeve Islame, ku Dr. Rexhep Boja ishte ndër pedagogët e parë dhe dekan i parë i këtij fakulteti.

Dr. Rexhep Boja karrierën e tij prej intelektualit e ka përmbyllur duke qenë ambasador i Republikës së Kosovës në Arabinë Saudite dhe në disa shtete fqinje të saj, detyrë kjo, të cilën e përfundoi me sukses.

Dr. Rexhep ef. Boja ka kryer edhe një varg detyrash të tjera fetare e shtetërore me rëndësi, si: Këshilltar i Ministrit të Shëndetësisë të Kosovës; anëtar në Këshillin e Lartë Botëror për xhamitë në Ligën e Botës Islame; anëtar në Këshillin Transitor kosovar të formuar nga OKB-ja; anëtar i Riastetit të Bashkësisë Islame në Sarajevë në ish-Federatën Jugosllave; anëtar në Këshillin Shura për Euro-Azi, etj.

Në fushën shkrimore, Dr. Rexhep Boja është autor i shumë studimeve në fusha të ndryshme, me të cilat është paraqitur në konferenca e simpoziume dhe i artikujve të shumtë, që janë botuar në gazeta e revista vendore e ndërkombëtare në gjuhën shqipe dhe arabe. Intervistat e tij dhënë shtypit vendor dhe atij ndërkombëtar, vazhdimisht kanë ofruar informacione të nevojshme për gjendjen në Kosovë, në veçanti për dhunën dhe terrorin, që ushtronte okupatori serb në Kosovë. Gjithashtu, është edhe autor i dy librave: *“Shqiptarët (Arnautët) dhe Islami – Myslimanët në ish-Jugosllavi”*, botim në gjuhën arabe, ku pjesa e parë përmban disertacionin e magjistraturës, ndërkaq pjesa tjetër e librit përmban disertacionin e doktoratës. Dr. Rexhep Boja ka botuar në gjuhën shqipe edhe librin *“Për një të nesërme më të mirë”* (botoi: Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë 2003).

Dr. Rexhep ef. Boja ndërroi jetë më 14 shtator të vitit 2021, ndërsa u varros më 15 shtator të vitit 2021 në vendlindje - Kërnice të Klinës, ku morën pjesë familjarë, miq, dashamirë, kolegë, ish-nxënës dhe ish-studentë, e autoritete fetare nga Bashkësia Islame e Kosovës, të Maqedonisë Veriore dhe të Shqipërisë, si dhe autoritete politike lokale e qendrore, të

cilët në fjalët e tyre të rastit vlerësuan lart punën dhe kontributin fetar dhe kombëtar të Dr. Rexhep Bojës.

Namazit të xhenazes i priu Myftiu i Bashkësisë Islame të Kosovës, Naim ef. Tërnavë, ndërsa duanë e xhenazes e bëri kryetari i BFI-së së Maqedonisë së Veriut, Hfz. Shaqir ef. Fetahu.

Në përmbyllje të shkrimit përkujtues për profesorin dhe dekanin tonë, themi se Dr. Rexhep Boja do të kujtohet si një nga personalitetet shqiptare më të njohura, i cili duke respektuar mësimet e fesë islame dhe duke pasur për model punën e paraardhësve të tij si të Haxhi Ymer ef. Prizrenit, Vehbi ef. Dibrës dhe shumë e shumë të tjerëve, fenë dhe atdheun kurrë nuk i ka ndarë, e për to ka bërë shumë dhe s'ka kursyer asgjë. Kurse si pedagog, ai ishte një model, një shembull, që duhet ndjekur. Prandaj dhe sot, shumë nxënës dhe studentë të tij e kujtojnë me pietet për urtësinë e tij, për dinjitetin njerëzor dhe intelektual që ka treguar.

E lusim Zotin e Gjithëmëshirshëm që Dr. Rexhep ef. Bojën ta ketë pranuar në mëshirën e Tij të pakufishme dhe ta shpërblejë me Xhenetin Firdevs!

# Thirrja islame në kohën e katër halifëve - Ebu Bekri r.a.

---

Prof. Ass. Dr. Rexhep Suma\*

## Abstrakt

Si një nga shokët më të afërt të Muhamedit a.s., ai kishte një pozitë të lartë në zemrat e myslimanëve dhe kishte një ndikim të madh në drejtimin dhe udhëzimin e tyre drejt të mirës dhe të drejtës. Para dhe pas vdekjes së Muhamedit a.s. ai bënte përpjekje të mëdha për të ftuar njerëzit të besonin në Allahun e vetëm dhe në profetin e Tij, dhe kishte një rol kyç në stabilizimin e myslimanëve në Islam dhe në udhëzimin e tyre. Pas marrjes së halifatit, ai pati një rol kryesor në drejtimin e përpjekjeve për të përhapur Islamin dhe për të mbrojtur dhe mbajtur e unifikuar qëndrimet dhe fjalën e myslimanëve karshi sfidave të mëdha, që e shoqëruan islamin dhe da'ven në përgjithësi në këtë kohë. Në kohën e Ebu Bekrit, thirrja islame u përhap gjerësisht nëpër territore të reja dhe u përball me sfida të ndryshme. Ai përballtet

---

\* Prof. Asist. Dr. Rexhep Suma, masterin e ka përfunduar në teologji islame në Fakultetin e Studimeve Islame në Prishtinë, kurse doktoratën në Universitetin ndërkombëtar- Fakultetin e Studimeve Islame- në Novi Pazar, në fushën e daves. Është profesor në Fakultetin e Studimeve islame. Email: rexhep.suma@fsi-edu.net, Orcid Id: 0009-0009-4920-2838.

me rebelime në disa pjesë të qeverisjes së tij, duke përfshirë ndërprerjen e dërguarit të zekatit nga disa fise arabe. Megjithatë, arriti të ruaj unitetin e komunitetit mysliman dhe të zgjeronte territorin e halifatit. Ai gjithashtu kreu disa ndryshime administrative dhe ushtarake për të forcuar strukturën e shtetit mysliman.

**Fjalë kyçe:** Ebu Bekr; As-hab; davelogji; halif; shtet islam.

## Abstract

As one of the closest companions of Muhammad (pbuh), he held a high position in the hearts of Muslims and had a significant influence on their guidance towards goodness and righteousness. Before and after the death of Muhammad (pbuh), he made great efforts to invite people to believe in the one God, Allah, and His Prophet, and played a key role in stabilizing Muslims in Islam and guiding them. After assuming the caliphate, he played a major role in leading efforts to spread Islam and to protect and maintain the unity and stance of Muslims against the great challenges that accompanied Islam and the Da'wah in general during this time. During Abu Bakr's time, the Islamic call spread widely across new territories and faced various challenges. He dealt with rebellions in some parts of his governance, including the cessation of sending Zakat by some Arab tribes. Nonetheless, he managed to preserve the unity of the Muslim community and expand the territory of the caliphate. He also implemented several administrative and military changes to strengthen the structure of the Muslim state.

**Keywords:** Abu Bakr; Sahabah; Dawalogy; Caliph; Islamic State.

## Hyrje

Historia e periudhës së metodologjisë së thirrjes islame në kohën e katër kalifëve (11 h- 40 h) mbetet periudha më e rëndësishme në historinë e përhapjes së vlerave të Islamit dhe njëherësh vazhdimësi e periudhës së Muhamedit a.s., duke forcuar parimet e saj, që ndjekin metodologjinë kuranore, e cila shpjegon metodat e thirrjes, në të cilat janë të thirrur. Kjo periudhë fillon pas vdekjes së Muhamedit a.s. (8 qershor 632 në Medinë), kur u shpallën kalifët e parë të Islamit për të udhëhequr komunitetin mysliman. Këta katër halifët janë: Ebu Bekr Essidiki (11-13h), Omer ibn Hatabi (13-23h), Othman bin Afani (23-35h) si dhe Ali ibn Ebi Talib (35-40h). Është e rëndësishme të theksohet se kjo thirrje islame e kohës së katër halifëve zgjati 30 vite. Pra, nga viti i dhjetë (10) sipas hixhretit dhe përfundon me vdekjen e kalifit të katërt, Ali ibn Ebi Talibit, në vitin 661, gjegjësisht në vitin 40, sipas hixhretit. Alkame thotë që hilafeti i katër hulefai-rashidinëve ka zgjatur tridhjetë vite. Ebu Bekri ka sunduar dy vite, tre muaj e dhjetë ditë. Hilafeti i Omerit ka zgjatur dhjetë vite, gjashtë muaj e tetë ditë. Hilafeti i Osmanit ka zgjatur njëmbëdhjetë vite, njëmbëdhjetë muaj e nëntë ditë. Hilafeti i Aliut ka zgjatur katër vite, nëntë muaj e shtatë ditë. Sipas burimeve dhe dokumenteve historyike, Muhamedi a.s. ka paralajmëruar se hilafeti i tyre do të zgjasë 30 vite.

Na ka treguar Ahmed b. Meni – atë e ka informuar Surejh b. Numan, <sup>1</sup> atë Hashreth b. Nubate, <sup>2</sup> duke transmetuar nga Seid b. Xhumhani, <sup>3</sup> ai nga Sefini <sup>4</sup> - që i Dërguari i Allahut, ka thënë: “Në mesin e pasuesve të mi, hilafeti do të zgjasë tridhjetë vite. Pas asaj ka për të qenë mbretëri.” <sup>5</sup>

<sup>1</sup> Surejxh b. Numan b. Mervan el-Xhevheri Ebu Hasan el-Bagdadi është transmetues i besueshëm nga gjenerata e dhjetë.

<sup>2</sup> Haxhxhaxh b. Nubate el-Eshxhe Ebu Mukerrem el-Vasiti el-Kufi është transmetues i sigurtë nga gjenerata e tetë. Megjithatë, ndonjëherë, me rastin e transmetimit të haditheve ka bërë paragjykime

<sup>3</sup> Seid b. Xhumhan el-Eslemi Ebu Hafs el-Basriu është transmetues i sigurtë nga gjenerata e katërt

<sup>4</sup> Sefina është Mehran Ebu Abdurrahmani. Ai është i mbrojturi i të Dërguarit të Allahut. Ebu Bekri ka udhëhequr dy vite, tre muaj dhe dhjetë ditë.

<sup>5</sup> Tirmidhiu, Ebu Davudi, Nesaiu, ibn Maxhe, Ahmedi dhe ibn Hibban.

Këto tri dekada janë një nga momentet më të rëndësishme në historinë e Islamit, ku u vendos dhe u forcua themeli i parë i udhëheqësisë myslimane pas vdekjes së profetit. Këta halifë u përqendruan gjithashtu në organizimin e shtetit mysliman, në vendosjen e institucioneve të reja administrative dhe ligjore dhe në kultivimin e një qeverisjeje të drejtë e të barabartë për të gjithë besimtarët. Këta halifë gjithashtu mbështetën veprimtarinë e udhëheqësve fetarë dhe të këshilltarëve për të zgjidhur çështjet e përkushtuara ndaj fesë dhe të gjithë komunitetit.

Përkushtimi ndaj thirrjes islame në periudhën e halifëve të drejtë u shfaq në dy drejtime:

1. Udhëzimi dhe drejtimi i myslimanëve drejt ligjit të Zotit dhe udhëzimit të Profetit a.s. në çdo çështje fetare dhe sociale në predikimet e xhumasë dhe të festave dhe në çdo rast.
2. Komunikimin e thirrjes islame tek jo-myslimanët me të gjitha metodat dhe mjetet e thirrjes, dhe shokët e Muhamedit a.s., bënin thirrje në vendet e hapura derisa banorët e tyre pranonin Islamin me zgjedhje dhe dëshirë.<sup>6</sup>

Në këtë periudhë, në rajone të ndryshme gjerësisht u përhap thirrja islame dhe halifët e kësaj periudhe u shpallën si udhëheqësit e besimtarëve myslimanë. Ata kanë luajtur një rol kyç në zgjerimin e territorit të Islamit dhe në stabilitetin e komunitetit mysliman. Pas vdekjes së katër kalifëve të parë, shfaqen periudha të ndryshme në historinë e Islamit, duke filluar me kalifatet, e për të vazhduar me periudhën e sundimit të dinastive të ndryshme.

Sipas transmetimeve të Muhamedit a.s. ai ishte njëri ndër dhjetë të përgëzuarve me xhenet. Ebu Musa r.a. dëfton këtë ndodhi: “Mora abdes në shtëpi pastaj dola dhe thashë: “Sot do t'i ngjitem pas të Dërguarit të Allahut dhe do të jem me të gjithë ditën.” Shkova në xhami dhe pyeta për Pejgamberin a.s.. Më thanë se kishte dalë e kishte ikur kënde (duke me treguar nga kishte shkuar). Kështu, vazhdova pas tij, duke pyetur, de-

---

<sup>6</sup> Abdurrahim Muhamed el Magdhevi, *El usus el ilmije li menhexhi ed'daveti'l islamije*, Daru'l hadare li'neshri ve'tevzi, bot. 3, Riad, 2018, f. 161.

risa (e pashë) të hynte në vendin e pusit Eris. U ula te dera, që ishte me dega palme hurme dhe prita derisa i Dërguari i Allahut kreu nevojën dhe mori avdes. Pastaj shkova tek ai, kur ai u ul në grykën e pusit Eris, në mes të dy anëve, me këmbët e zbuluara deri në gjunjë, që i kishte varur në pus. E përshëndeta dhe pastaj u ktheva prapë e u ula te dera. Thashë (me vete): “Sot do të jem roja e Pejgamberit a.s.” Pastaj erdhi Ebu Bekri dhe e shtyu derën. Pyeta: “Kush është?” Ai më tha: “Ebu Bekri.” I thashë të priste dhe shkova të pyes të Dërguarin e Allahut a.s.. I thashë se Ebu Bekri kërkon leje për të hyrë. Ai a.s. më tha: “Lëre të hyjë dhe përgëzoje me Xhenet!” U ktheva dhe i thashë Ebu Bekrit: “Hyr! I Dërguari i Allahut të përgëzon me Xhenet.” Ai hyri dhe u ul në të djathtë të të Dërguarit të Allahut a.s., në grykën e pusit, duke i varur këmbët si Pejgamberi a.s. dhe i zbuloi ato deri në gjunjë. Pastaj unë u ktheva te dera dhe u ula. (Kur dola nga shtëpia) vëllanë tim e lashë, duke marrë avdes dhe deshi të më vinte pas. Thashë (me vete): “Në qoftë se Allahu ia do të mirën atij (vëllait tim), atëherë do ta sjellë atë këtu”. Papritur erdhi dikush dhe e shtyu derën. Pyeta se kush ishte. Më tha se ishte Umer Ibn Hattabi. I thashë që të priste, pastaj shkova tek i Dërguari a.s., e përshëndeta dhe i thashë: “Umer Ibn Hattabi kërkon leje për të hyrë.” Ai a.s., tha: “Lëre të hyjë dhe përgëzoje me Xhenet.” U ktheva dhe i thashë: “Hyr! I Dërguari i Allahut a.s. të përgëzon me Xhenet.” Ai hyri dhe u ul pranë të Dërguarit a.s. në të majtë të tij në grykën e pusit dhe vari këmbët në të. Përsëri u ktheva dhe u ula te dera, duke thënë (me vete): “Në qoftë se Allahu ia do të mirën filanit (vëllait), atëherë do ta sjellë atë këtu”. Atë çast erdhi dikush dhe e shtyu derën. E pyeta se kush ishte dhe mu përgjigj se ishte Uthman Ibn Affani. I thashë të priste dhe shkova e i tregova Pejgamberit a.s.. Ai më tha: “Lëre të hyjë dhe përgëzoje me Xhenet pas një sprove, që do t’i bjerë.” Kështu u ktheva dhe i thashë: “Hyr. I Dërguari a.s. të përgëzon me Xhenet pas një sprove që do të të bjerë.” Ai hyri dhe e gjeti grykën e pusit të zënë, kështu që u ul përballë Pejgamberit a.s. në anën tjetër.”<sup>7</sup> Po ashtu argumentet, që dëshmojnë se ky ishte një njeri, që ka

---

<sup>7</sup> Buhariu, nr. 3674.

bartur misionin e thirrjes islame me përgjegjësi të lartë dhe ka sakrifikuar gjithçka nga jeta. Është edhe hadithi tjetër, që ka paralajmëruar Muhamedi a.s., se ai do të jetë shehid. Enesi r.a. tregon se, një herë, Pejgamberi a.s. u ngjit në malin e Uhudit dhe me të ishin edhe Ebu Bekri, Umeri dhe Uthmani, kur mali u tund me ta. Atëherë Pejgamberi a.s. i tha (malit): *“Qëndro, o Uhud! Me të vërtetë, mbi ty janë vetëm një Pejgamber, një Siddik (i besuar) dhe dy shehidë (dëshmorë).”*<sup>8</sup>

## Ebu Bekri dhe roli i tij në thirrjen islame (573-634)

Ebu Bekr bin Ebi Kuhafe es-Sidik,<sup>9,10</sup> Ai i takonte fisit Tejm. Pas vdekjes së Muhamedit a.s., thirrja islame u vazhdua me qëndrueshmëri dhe forcë nën udhëheqjen e tij si halif i parë. Ky sahabi ishte njeriu i dytë pas Muhamedit a.s., që thirri dhe predikoi Islamin. Mësoi në shkollën e Muhamedit a.s., u edukua dhe u formua në këtë frymë, e cila reflektoi thellë në karakterin e këtij personaliteti të thirrjes islame, një ndër më të mëdhatë në historinë e predikimit të islamit.

Ebu Bekri, me t’u përgjigjur thirrjes islame, filloi aktivitetin e tij si thirrës. Së pari ndikoi në familjen e tij, duke iu përgjigjur që të gjithë thirrjes në Islam, pos njërit djalë. Buhariu transmeton prej Aishes, e thotë: “Nuk i mbaj mend prindërit e mi përveçse ata ishin fetarë.<sup>11</sup> I Dërguari i Allahut kishte miqësi me Ebu Bekrin edhe para islamit, ndërsa me Islamin, kjo u shndërrua në miqësi besimi, respektivisht dashuria mes tyre ishte për Allahun xh.sh. Ishte ky personalitet, për të cilin Muhamedi a.s. kishte thënë në hadithin e tij, që transmeton Omer b. Hatabi r.a. se i

<sup>8</sup> Buhariu, nr 3675.

<sup>9</sup> Emri i tij i plot është: Abdullah b. Osman b. Amër b. Omer b. Ka’b, b. Sa’d b. Tejm b. Murre b. Ka’b b. Luejj b. Galib. Nëna e tij quhej Selma, edhe ajo gjithashtu njihej me emrin Umu’l hajr b. Sahr, e cila e pranoi Islamin në periudhën e Mekës. Ebu Bekri u lind më 23 gusht 573, tri vjet pas ngjarjes së elefantit. Vdiq në vitin e 13 h, në moshën 63 vjeçare.

<sup>10</sup> Muhamed Rida, *Ebu Bekri es-sdiki evelu hulefairr-rashidin*, bot. dytë, Daru’l kutub el arabije, Kajro, 2004, f. 13.

<sup>11</sup> Buhariu, Kitabu el kefale, babu xhivari ebi Bekr fi ahdin’nebij.

Dërguari a.s. ka thënë: *"Po që se në njërin cep të peshores do të vendosej besimi i Ebu Bekrit dhe në cepin tjetër besimi i të gjithë banorëve të tokës, besimi (imani) i Ebu Bekrit do të peshonte më shumë."*<sup>12</sup> Kurse me një rast Ibn Abbasi transmeton se Muhamedi a.s. ka thënë:

*"Sikur të kisha marr dikë për mik, do të kisha marrë Ebu Bekrin. Por ai është vëllai dhe shoku im"*.<sup>13</sup> Një herë Ali ibn ebi Talib hipi në minber dhe gjatë ligjërimit, u tha: "A e dini se cili është njeriu më i guximshëm?" Ti je o Prijës i besimtarëve, ia kthyen njerëzit! Është e vërtetë se nuk është ndeshur dikush me mua, vetëm se e kam shtrirë për tokë, porse më i guximshmi është Ebu Bekri. Një herë ne përgatitëm një ndenjësë për Profetin pranë Qabesë dhe thamë: kush do të qëndrojë me Profetin, që të mos i vërsulej kush nga kurejshët? Pasha Allahun nuk iu afrua atij, kush veçse Ebu Bekri qëndronte me shpatë të zhveshur mbi kokën e tij. Ky është njeriu më i guximshëm. Pastaj vazhdoi e tha: Një herë e pashë Profetin, që po e shtynin dhe po e mundonin kurejshët dhe nuk iu afrua askush tjetër pos Ebu Bekrit, i cili herë i shtynte e herë kacafytej me ta e u thoshte: Mjerë për ju, vallë po e vrisni këtë njeri se thotë Zoti im është Allahu?! Më pas Aliu ngriti xhyben e tij dhe filloi të qante derisa iu lag mjekra dhe ashtu u drejtua nga njerëzit e u tha: "Ju kërkoj për hir të Allahut të më thoni: cili është më i mirë, besimtari nga familja e faraonit, apo Ebu Bekri? Njerëzit heshtën dhe askush nuk foli. Aliu atëherë tha: Pasha Allahun, një çast nga jeta e Ebu Bekrit është më e mirë dhe më me vlerë se e gjithë jeta e besimtarit nga familja e faraonit. Sepse ky e fshehu besimin, ndërsa Ebu Bekri e shfaqti atë".<sup>14</sup>

<sup>12</sup> Hadith sahih, ahrexhehu Is'hak b. Rahevejh në Musnedin e tij (3/669), El Hattabi në *"El gunjeti ani'l kelami ve ehlihi"*, f. 47; Bejhekiu në *"Shuabu'l iman"*, 1/69 nr. 36; Ibn Asakiri në *"Terihu'l dimashk"*, 30/127; nga Abdullah b. Mubarek e ky nga Abdullah bin Shevdheb, Muhamed b. Xhuhadete, nga Selemete b. Kuhejl, nga Huzejl b. Shurahbil dhe nga Abdullah b. Ahmed b. Hanbel në *"Es-suneh"*, 1/378, nr. 821-822. Sikurse po ashtu e gjejmë në *"Tuhfetu'l ahvezi"*, 7/298; Kenzu'l ummal, 35614.

<sup>13</sup> Buhariu, nr. 3656, Fedailu ashabi'n nebi, 5.

<sup>14</sup> Ebu'l Fida el Hafidh b. Kethir Ed-dimeshki, *El Bidajetu ve en-nihajetu*, Daru'lkutub el ilmije, botim i parë, Bejrut, 1994, v. 3, f. 271.

Ky personalitet i thirrjes islame ishte i veçantë në jetën e Pejgamberit a.s., andaj me të drejtë gjatë tërë jetës së kaluar gjysmë shekulli, i Dërguari a.s. e vizitonte Ebu Bekrin dy herë në ditë. Andaj, u kthye në perspektivë, kur qyteti i Medinës përjetonte ditët e fundit të lumturisë, që kishte zgjatur me vite. I Dërguari i Allahut e kishte kuptuar se ishte afruar çasti për t'u takuar me mikun më të lartë (*Refik'ul-Ala*). Nga që i qenë shtuar dhimbjet, me vështirësi mund t'u bashkohej sahabëve. Atë ditë u ngjit në minberin prej tre shkalleh druri të Mesxhidit të Medinës, dhe prej aty mbajti një fjalim, që i tronditi zemrat e shokëve. Duke nënkuptuar veten tha: “Allahu një rob të Tij e ka lënë të zgjedhë, që t'i japë sa të dojë nga begatitë e kësaj bote ose të preferojë begatitë qiellore në madhërinë e Tij. Ai rob preferoi ato në madhërinë e Allahut.” Pas këtyre fjalëve prekëse, Ebu Bekri nuk mundi t'i përmbante lotët. Ai e kishte kuptuar se ishte afruar koha për t'u ndarë nga ai shpirt i dashur, me të cilin kishte kaluar momentet më të bukura dhe më të veçanta. I Dërguari i Allahut e mbaroi fjalimin me këto fjalë, që e qetësuan Ebu Bekrin: “Njeriu, i cili me ka mbështetur më shumë nga të gjithë me pasurinë dhe miqësinë e tij është Ebu Bekri. Nëse do t'i jepja një hise të veçantë nga miqësia ndokujt nga ummeti im, pa dyshim do t'ia jepja Ebu Bekrit. Por vëllazëria islame (është më sublimë se miqësia personale)...”<sup>15</sup> Sipas transmetimeve të Aishes ra., i Dërguari i Allahut nuk e harronte shokun e tij, e vizitonte dy herë në ditë, në mëngjes dhe në mbrëmje<sup>16</sup>. Dy miqtë e afërt, të cilët kishin kaluar gjysmë shekulli me njëri-tjetrin, edhe shqetësimin e shpërnguljes në një vend të ri e patën përjetuar së bashku. Meka atë ditë përjetonte një ditë historike. I Dërguari a.s. në kohën kur të gjithë bënë gjumin e pasdites, shkoi në shtëpinë e Ebu Bekrit, mikut të vjetër dhe shokut të afërt. Njerëzit e shtëpisë menjëherë e kuptuan se kjo nuk ishte një vizitë e zakonshme. I zoti i shtëpisë, sapo e pa tha: “Nëna dhe babai im t'u bëfshin kurban! Beto hem në Zot se nuk do të vije po të mos ishte ndonjë çështje me rëndësi!” I Dërguari i Allahut dukej i shqet-

<sup>15</sup> Buhariu, nr. 3904, Menakibul' ensar, 45. Buhariu, nr. 3656, Fedailu as'habi'n-nebi, 5.

<sup>16</sup> Buhariu, nr. 476, salat, 86.

tësuar. Kërkoi të mbetej i vetëm me mikun e tij dhe tha: “Allahu i Lartë më dha leje për t’u shpërngulur nga Meka (në Medine).” Ebu Bekri r.a. e pranoi me habi e kënaqësi këtë propozim. Pa humbur kohë, filluan përgatitjet për rrugë.<sup>17</sup>

Po ashtu nga hixhreti si ngjarje e madhe në historinë e thirrjes islame, Muhamedi a.s. zgjodhi ta merrte si bashkudhëtar si shok dhe mik i fshehtësive si dhe përgjegjësinë e udhëtimit ta merrnin së bashku. Ai njëherë tjetër e lavdëroi Ebu Bekrin dhe ia përmendte mirësitë e tij. Njëherë e lavdëroi shokun e tij të shpellës<sup>18</sup>. Me të cilin kishte qenë së bashku në ditët më të rënda, duke thënë: “Ai na ka bërë neve mirësi të tilla, shpërblimin e të cilave do t’ia japë vetëm Allahu në Ditën e Gjykimit!”<sup>19</sup> Qëndrimin e këtyre të dyve në maje të kodrës, Allahu në Kuran kështu e përshkruan:

***Nëse nuk e ndihmoni atë (Muhamedin a.s.), atë pra e ka ndihmuar Allahu, kur e përzunë ata që nuk besuan të dytin prej dyve. Kur ishin në shpellë, ai (Muhamedi a.s.) i tha shokut të vet (Ebu Bekrit r.a.): “Mos u brengos, vërtet Allahu është me ne!” E Allahu zbriti qetësinë (sekinen) e Vet mbi të, dhe e fuqizoi me fuqi që ju nuk e patë dhe e bëri fjalën e atyre që nuk besuan më të ultën, kurse fjala e Allahut është më e larta. Allahu është i Fuqishmi, i Urti.***<sup>20</sup>

Ebu Bekri r.a. tregon: “Isha me Pejgamberin a.s. në shpellë. Kur ngri-ta kokën pashë këmbët e njerëzve. Thashë: “O i Dërguari i Allahut! Në goftë se disa prej tyre do të vështrojnë poshtë, do të na shohin.” Pejgamberi a.s. më tha: “Rri urtë, o Ebu Bekr! Ne jemi dy dhe Allahu është i Treti i tyre.”<sup>21</sup>

<sup>17</sup> Buhariu, nr. 3905, Menakibul’ ensar, 45.

<sup>18</sup> Tirmidhiu, nr. 3670, Menakib, 16.

<sup>19</sup> Tirmidhiu, nr. 3661, Menakib, 15.

<sup>20</sup> Et-tevbe, 40.

<sup>21</sup> Buhariu, nr. 3922, <http://www.buhariu.com/buhariu/?h=1595> (04.06.2024).

Ky rekomandim dhe ky vlerësim tepër i thellë nga ana e tij dokumenton thellësinë dhe fuqinë e besimit të Ebu Bekrit. Duke thënë se besimi i tij do të peshonte më shumë sesa besimi i të gjithë ummetit, sugjeron se besimi dhe devocioni i tij ishin të jashtëzakonshëm dhe të pashoq. Kjo është një lavdërim i lartë për karakterin dhe besimin e tij. Për besimtarët, Ebu Bekriu është një shembull i fuqishëm i përkatësisë dhe i devotshmërisë ndaj besimit. Duke vlerësuar se besimi i tij do të peshonte më shumë në peshoren e moralit dhe të devotshmërisë sesa besimi i të gjithë ummetit, tregon një ndjenjë të thellë të respektit dhe admirimit për rolin dhe kontributin e tij në historinë e Islamit. Kjo shprehje mund të përdoret për të theksuar, se për disa njerëz, figura e Ebu Bekrit është kaq e lartë sidomos në fushën e da'ves dhe e rëndësishme saqë besimi dhe përkushtimi i tij përshkruhet si i pamposhtur dhe i papërballueshëm nga besimi i të tjerëve. Është një mënyrë për të theksuar rolin e tij të jashtëzakonshëm në historinë e Islamit dhe për të ilustruar se si besimi i tij ka lënë një ndikim të thellë në zemrat e besimtarëve. Zaten edhe misioni i thirrësit islam lidhet tërësisht me çështjen e besimit në Krijuesin Një, por edhe në besimin, që ka për vetë mesazhin në të cilin thërret si predikues. Nga Enesi r.a. përcillet se Profeti (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: “Më i mëshirshmi i myslimanëve në këtë ummet (popull) është Ebu Bekri, më i rrepti në zbatimin e ligjeve të Allahut është Umeri, njeriu më i turpshëm është Uthmani, lexuesi më i mirë i librit të Allahut është Ubej bin Kabi, njeriu, që ka më tepër njohuri rreth ndarjes së pasurisë së trashëguar është Zejd bin Thabiti, më i dituri rreth hallallit dhe haramit është Muadh bin Xhebeli. Çdo popull ka besnikun e tij dhe besniku i këtij ummeti është Ebu Ubejdeh bin Xherrah.”<sup>22</sup>

Në marrëdhëniet e të dërguarit të Allahut me sahabet, mbizotëronin kriteret kur'anore dhe pejgamberike. Prandaj Pejgamberi a.s. dhe sahabet, në marrëdhëniet e tyre ruanin ekuilibrin dhe maturinë. Sahabët, të cilët ishin shumë të vetëdijshëm për dashurinë, mëshirën dhe simpatinë e

<sup>22</sup> Transmeton Ahmedi në Fedailu es-sahabeh 1/544 dhe nr. 716, Tirmidhiu, nr. 3 790. Hadithi është sahih sipas Albanit.

Pejgamberit a.s. për ta, pa e lëshuar aspak respektin dhe nderimin për të, në prani të tij ndiheshin shumë të qetë.<sup>23</sup> Aishja r.a. transmeton se njëherë, gjatë ditës së Minas (festës së kurbanit), dy shërbëtore i patën rënë deficit në dhomën e tij, ndërsa Pejgamberi s.a.v.s. vetëm sa ishte mbuluar me rrobat e tij dhe qe shtrirë e nuk i pati penguar ato. Ebu Bekri, i cili erdhi pas pak, kur e pa këtë gjendje, i qortoi ato, por Pejgamberi s.a.v.s ia priti: “Lëri ato o Ebu Bekr! Çdo popull ka një festë. Festa jonë është në këto ditë?!.”<sup>24</sup> Po ashtu, ai e mori me vete Aishen r.a. për të ndjekur lojërat, që shfaqnin etiopianët në mesxhid, dhe kur Omeri r.a. tentoi t'i qortonte e t'i largonte nga mesxhidi, ai ndërhyri dhe tha: “Lëri ata të luajnë të lirë!”<sup>25</sup> Ebu Bekri zhvilloi një jetë të pastër edhe para përqafimit të Islamit. Nuk kishte pirë alkool e as nuk u ishte lutur idhujve të Mekës. Vajza e tij, Aishja r.a. -nëna e besimtarëve- duke përshtuar personalitetin e tij kishte thënë: Ebu Bekri ia kishte ndaluar alkoolin vetës dhe nuk ka pirë as para dhe as në Islam. Ai e dinte se pirja e alkoolit nuk sillte asgjë përveç së ligës dhe shpeshherë thoshte që, ata që përdorin alkool herët a vonë do të humbin nderin dhe dinjitetin e tyre...”

Gjatë tërë jetës së tij, asnjëherë nuk i shkaktoi dëm e as nuk lëndoi asnjë krijesë. E kishte ruajtur Zoti xh.sh. nga gjërat e ndaluara, duke e përgatitur për një mision sublime për të bartur barrën e myslimanëve më vonë si shoqërues i parë i Muhamedit a.s. dhe më vonë si halif. Sjelljet dhe karakteri i tij vlerësohej dhe çmohej nga shoqëria e Mekës. Ishte person me integritet, reputacion, i pasur, dhe burim ndihmese për të pafuqishmit.<sup>26</sup> Në dokumentet islame nuk regjistrohen të dhëna të moshës së hershme të fëmijërisë dhe asaj rinore. Ajo që mësojmë nga literatura islame është fakti se ai që në rini është marrë me tregti mëndafshi dhe rrobash, duke bërë shitblerje mes Shamit dhe Jemenit. Mësohet se kur

<sup>23</sup> Islami nëpërmjet haditheve, Kryesia e çështjeve Fetare të Turqisë, Logos-A, Shkup, përkthyes Nasir Rexhepi, Istanbul 2017, botim i dytë, v. 6, f. 430.

<sup>24</sup> Buhariu 3931, menakibu'l-ensar, 46.

<sup>25</sup> Buhariu, nr. 988, Idejn, 25.

<sup>26</sup> Abdurrahman b. Muhamed b. Haldun, *Mukaddime*, Daru'l kitab el Arabi, bot. i parë, Bejrut, 1996, f. 206.

kaloi në Islam kishte një kapital prej 40.000.00 dërhëm, sikurse lexohet nga tekstet historike, ai ishte po në të njëjtin karvan, në të cilin kishte udhëtuar Muhamedi a.s. për tregti në Siri.<sup>27</sup>

Në vegjëli shquhej për vepra të mira dhe karakterizohej me njohuritë e tij mbi gjenealogjinë fisnore, sa që merrej shembull për të tjerët,<sup>28</sup> i pashëm, i butë, bujar, i sinqertë, i ndershëm, i dashur, sa që në atë periudhë thirrej me pseudonimin “Atik”, d.m.th. i pashëm, i fismë, i butë. E me kalimin e viteve, mori epitetin “Es-Siddik”, d.m.th. i sinqerti (që gjithmonë e thotë të vërtetën). Ai shfaqti besnikëri ndaj misionit të Muhamedit a.s. atëherë kur askush nuk e besonte dhe është i pari që u bë mysliman nga burrat. Nga gratë ishte Hatixheja, që e para u bë myslimane, pastaj prej skllëvërve ishte Zejd b. Harithe, nga fëmijët ishte Aliu r.a. Ebu Bekri kishte pozitë të lartë në mesin e kurejshitve dhe ishte thirrës i madh në mesin e tyre. Transmeton Junusi nga Ibn Is’haku, se një ditë Ebu Bekri takoi Muhamedin a.s. dhe e pyeti: Muhamed! A është e vërtetë ajo, që po thonë kurejshitët, se ke braktisur zotërat tanë dhe i ke mohuar ato?-Po si jo!. Unë jam i Dërguar i Zotit me mesazh për të thirrur për te Zoti në të vërtetën. Për Zotin kjo është e vërtetë. Andaj po të ftoj ty o Ebu Bekr në besimin në një Zot që s’ka tjetër pos Tij, dhe të mos adhurojmë askë pos Tij, dhe i lexoi Kuran. Ebu Bekri me këtë rast nuk e pranoi e as nuk e refuzoi. Më pas u bë mysliman. I mohoi zotërat e kotë, duke u bërë një besimtar shembull dhe predikues i madh i Islamit.<sup>29</sup>

Rrëfen i Dërguari a.s. “*Këdo që kam thirrur në islam, s’do mend se ka shfaqur një dozë dyshimi, përpos Ebu Bekrit.*”<sup>30</sup> Ndërsa një ditë tjetër Resulullahu përsëri ua rikujtoi vlerat dhe karakteristikat e Ebu Bekrit, duke thënë “*S’ka dyshim që Allahu më dërgoi Pejgamber për juve. Kur unë jua*

<sup>27</sup> Islam ansiklopedisi, Turkiye Diyanet Vakifi, ISAM (Islam Arastirmalari Merkezi, Istanbul, 2020, v. 10, f. 102.

<sup>28</sup> Ebu Bekr Ahmed b. Husejn. Delailu’n nubuveti ve mea’rifetu ahvali sahibush’sheriati, botim i parë, Daru’l kutubi’ i lmije, Bejrut, 1995, f. 165.

<sup>29</sup> Ebu’l Fida el Hafidh b. Kethir Ed-dimeshki, *El Bidajetu ve en-nihajetu*, Daru’lkutub el ilmije, botim i parë, Bejrut, 1994, v. 2, f. 22.

<sup>30</sup> Muhamed Kandahlevi, *Hajatu`-s-Sahabe*, Mektebetu’l ilm, v. 1, Delhi i ri, 2013, f. 79.

*përçolla juve këtë, të gjithë më thatë 'gënjen'. Ndërsa Ebu Bekri më tha: "Të vërtetën e ke thënë" dhe bashkë me fjalën e dhënë, i besoi kaq shumë kësaj rruge, saqë dha çdo gjë nga aftësitë e tij dhe nga pasuria e tij. Më pas, përsëriti dy herë: "Tani, nuk do të ma mërzisni më mikun tim, apo jo?"<sup>31</sup> Dhe kështu filloi të thirrej mes shokëve të tij, Ebu Bekr es-Siddik. Me kalimin e viteve këto karakteristika e përbënin figurën e tij një model thirrësi në rrugën e Allahut xh.sh. dhe të Dërguarit të Tij.<sup>32</sup>*

Në misionin e da'ves duhet qenë i bindur, i sinqertë në vlerat dhe parimet në të cilat ftohet. Islami vazhdimisht kërkon nga pjesëtarët e tij, që në vetvete të jenë të devotshëm, të vërtetët në misionin e da'ves dhe të kenë sinqeritet në qëllimet dhe objektivat, që ia kanë vënë vetes dhe kjo të reflektojë në suksesin si dhe të merituarit e shpërblimit të Allahut xh.sh. Zaten ky kusht është për të gjitha veprat në islam, por ndër më fisniket në komunikimin e da'ves.. Allahu xh.sh thotë:

*"Vetëm Allahut i takon adhurimi i vërtetë".<sup>33</sup> "Thuaj unë jam i urdhëruar që ta adhuroj Allahun me përkushtim të sinqertë".<sup>34</sup>*

Devotshmëria dhe sinqeriteti ishin cilësitë kryesore të thirrësit, Ebu Bekrit, drejt fjalës së Allahut xh.sh.. Në saje të këtyre cilësive arriti ta dallonte të vërtetën nga e kota, dhe kjo la gjurmë të thella edhe tek ata, që ftoi në islam. Shpirtrat njerëzorë natyrshëm priren drejt së vërtetës dhe origjinalitetit dhe shmangen nga e kota dhe e pavërteta. Tiparet e Ebu Bekrit si thirrës në islam u bënë shkak inspirimi për shumë njerëz, që më vonë bartën flamurin e paqes në botë. Ebu Bekri r.a., arriti ta dallonte të mirën nga e keqja, ashtu siç thotë edhe Ebu Hajan El Endelusi: "Ftesa për tek e mira, për të bërë gjëra të mbara dhe për të ndaluar të këqijat, i takon ta bëjë vetëm ai njeri, që e njeh të mirën dhe të keqen. Njeh si duhet zhvilluar kjo urdhëresë dhe si duhet kryer në terren. I padituri qëllon që

<sup>31</sup> Ibn Hisham, *Es-siretu en-nebevije*, v.2, f.90.

<sup>32</sup> Islam ansiklopedisi, Turkiye Diyanet Vakifi, ISAM (Islam Arastirmalari Merkezi, v. 10, Istanbul, 2020, f. 102.

<sup>33</sup> Ez-Zumer, 3.

<sup>34</sup> Ez-Zumer, 11.

mund të urdhërojë diçka të keqe apo të ndalojë diçka të mirë... mund të tregohet i ashpër aty ku duhet të tregohet i butë, apo e kundërta.<sup>35</sup>

## Sfidat dhe telashet në misionin e da'vetit në Mekë

Ebu Bekri gëzonte një popullaritet të lartë në mesin e masës, qoftë në Meke dhe jashtë saj. Ishte një figurë e nderuar dhe e respektuar. Por kur filluan të përhapnin vlerat islame në mesin e mekasve, jobesimtarët reagan shumë ashpër dhe nuk kursyen as Ebu Bekrin dhe shfrytëzonin çdo rast për ta sulmuar atë. Gjatë kësaj periudhe, numri i myslimanëve kishte mbërritur në 40. Meqë i erdhi edhe urdhri nga Allahu, që të predikonte haptazi, Ebu Bekri i propozoi Muhamedit a.s., që të fillonin me predikimin e islamit haptazi, sepse, deri para këtij urdhri, publikimi ishte zhvilluar fshehtas. ***“Publiko haptas atë për të cilën urdhërohesh e hiq idhujtarëve.”***<sup>36</sup>

***“Dhe tërhiq vërejtjen farefisit tënd më të afërt. E të jesh i butë ndaj besimtarëve që pranuan ty.”***<sup>37</sup>

***“Dhe thuaj: “Unë jam qortues i hapët (për dënimin nga Zoti për ata që kundërshtojnë.”***<sup>38</sup>. Dhe, me këtë rast Ebu Bekri ishte sahabiu, që iu gjet në çdo ndihmë dhe përkrahje, që kishte misioni i daves. Në një rast kur Muhamedi a.s., derisa ishte duke bërë tavaf rreth Qabesë, mushrikët e fyne keq Pejgamberis a.s., Ebu Bekri u kishte thënë: *Dëgjoni o Kurejshë, për Atë në dorën e të Cilit është shpirti im, nëse nuk më besoni, unë do t’ju sjell shkatërrim!*” ata u shtangën dhe u larguan, por të nesërmen u mblodhën prapë tek këndi i Qabesë, duke ua përkujtuar atë, që ndodhi një ditë më parë. Kur, qe, u paraqit Muhamedi a.s. Të gjithë kërcyen përnjëherë dhe e rrethuan, duke i thënë: “A je ti që po thua kështu, kështu?”-ia përsë-

<sup>35</sup> Muhamed b. Jusuf b. Ali b. Hajan (i njohur si Ebu Hajan ethirud'din), *Tefsiru'l bahri'l muhit*, Daru'l kutub el ilmije, v. 3, Bejrut, 1993, f. 20.

<sup>36</sup> El Hixhr, 94.

<sup>37</sup> Esh-Shuara, 214-215.

<sup>38</sup> El Hixhr, 89.

ritën fjalët, që kishte deklaruar, duke fyer zotat e tyre dhe fenë e tyre. Pejgamberi a.s., u përgjigj: “Po, unë jam ai që i ka thënë këto!”. Tha: Atëherë e pashë njërin prej tyre, duke e kapur për palën e pelerinës së tij, ndërsa Ebu Bekri r.a., i doli përpara dhe duke qarë i tha: “A doni ta vrisni njeriun, vetëm pse po thotë Zoti im është Allahu?!”. Pastaj ata u larguan prej tij. Kjo është gjëja më e keqe, që kam parë nga kurejshët, duke i bërë atij.”<sup>39</sup>

Pasi e pranoi Islamin Ebu Bekri r.a., ai e shfaqti atë publikisht dhe filloi t'i ftonte njerëzit në besim në Allahun dhe Pejgamberin e Tij. Ai ishte i afërt me popullin e tij dhe shumë i dashur. Ai ishte njohësi më i mirë i gjenealogjisë së Kurejshëve dhe dinte më tepër rreth tyre, si të mirat edhe të këqijat. Ai ishte tregtar, i njohur për moralin dhe bamirësinë e tij. Njerëzit shkonin tek ai dhe shoqëroheshin me të, për shkak të diturisë së tij për punë tregtare dhe për biseda të këndshme.

## Elita mekase u bë mysliman në saje të Ebu Bekrit

Në fushën e da'velogjisë, sa më i dashur dhe i afërm të jetë thirrësi me njerëzit, aq më shumë i përgjigjen ftesës së tij dhe aq më shumë grumbullohen rreth tij. Modestia e bën thirrësin më të dashur te shtresat e shoqërisë. Këtë karakteristikë, siç urdhëron Allahu xh.sh., e ka maknifetuar Ebu Bekri r.a. dhe i ka kuptuar drejtë ajetet kuranore: ***Përkufizojë veten tënde me ata që lusin Zotin e tyre mëngjes e mbrëmje, e që kanë për qëllim kënaqësinë (razinë) e Tij, dhe mos i hiq sytë e tu prej tyre e të kërkosh bukurinë e kësaj bote dhe mos iu bind atij që ia kemi shmangur zemrën e tij prej përkujtimit ndaj Nesh dhe i është dhënë epshit të vet, pse puna e tij ka mbaruar.***<sup>40</sup>

Në saje të këtyre tipareve, ai rrinte dhe qante hallet e tyre, ndihmonte të varfrit, shoqëronte xhenazet e tyre, vizitonte të sëmurët dhe ftonte

<sup>39</sup> Ibn Hisham, *Essiretu ennebevije*, Daru ihjai et'turath el arabi, botimi 1, Bejrut, 1995, v. 1, f. 79.

<sup>40</sup> El Kehf, 28.

në Islam ata te të cilët kishte besim. Kështu, përmes thirrjes së tij, Islamin e pranuan Othman b. Affani, Zubejr b. Avami, Abdurrahman b. Avfi, Sa'd b. Ebi Vekasi, Talha b. Ubejdullahu, Othman b. Medh'un, Ebu Ubejde b. El-Xherahi, Ebu Seleme b. Abdulesed dhe Erkam b. Ebi Erkam r.a, Seid b. Zejdi, Fatime bintu Hatabi, Esmā bintu ebi Bekri, Aishe bint ebi Bekr (nëna e besimtarëve), Ummu Fadli, Habbab b. Eretti, Utbeh b. Gazeuani, Umejr ibn ebi Vekasi, Abdullah b. Mes'udi, Ubbejde b. Harith, Mesud b. Amër el Karij, Selit b. Amër, Hatib b. Amr, Ajjash bin ebi Rebia dhe gruaja e tij Esmā bint Selame, Hunejs b. Hudhāfe, Amir b. Rebia, Abdullah b. Xhahsh dhe vëllau i tij Xhafer bin ebi Talibi dhe gruaja e tij Esmā bint Umejs, Hatib bin Harith dhe gruaja e tij Fatime bint Muxhel-lil, dhe vëllai i tij Hatab dhe gruaja e tij Fukejhe bint Jesar, Muammer b. Harith, Saib b. Uthman Medh'un, Mattalib b. Ez'her dhe gruaja e tij Remle bint ebi Avf, Nuhman (emri i tij ishte Neim) b. Abdulla, Amir b. Fuhejre, Halid b. Se'id bin As dhe gruaja e tij Amine bint Halef, Hatib b. Amër, Ebu Hudhejfe b. Utbe b. Rebia, Vakid b. Abdullah, Halid b. Amir, Amir, Akil dhe Ijjas benu Bekir b. Abd Jalil, Ammar b. Jasir, Suhejb b. Sinan Rumi, etj. Është interesant fakti se këta emra ishin nër kolosin më të mëdhenj të islamit dhe sikur mos të kishin besim, dhe sinqeritetin e Ebu Bekrit, si mendjendritur nuk do ta dëgjonin të përfaqonin islamin. Por, Ebu Bekri kishte një metodë të veçantë, që tërhiqte këta persona drejt thirrjes islame dhe kishte pranueshmëri. E si të mos e kishte këtë, kur për mësuës kishte Pejgamberin a.s. Andaj të gjithë ata, që studiojnë biografinë e tyre të sakrificës sublime dhe ofertat e tyre, vetëm që fusha e daves të mos ndalej, e duke sakrifikuar gjithçka, vetëm për ta ngritur lartë fjalën *La ilahe ilallah*. Ishin, pra, personalitete të larta, që treguan sinqeritet në jetë dhe me Zotin<sup>41, 42</sup>.

---

<sup>41</sup> Xhibrin Abdullah el Xhibrin, Ebu Bekr esididik ve devruhu fi'daveti el islamije", (punim magjistrature), Al Imam Muhamed b. Saud Islamic University, Fakulteti i Daves dhe komunikimit, Riad, 1987, f. 82.

<sup>42</sup> Ibni Hisham, Biografia e Pejgamberit a.s., përktheu Miftar Ajdini, Logos-A, Shkup, 2017, f. 72.

Këta falnin namazin dhe jepnin lemoshë.<sup>43,44</sup> Në jetën e tij Ebu Bekri ka treguar moral të lartë dhe marrëdhënie të ngrohta në fushën e thirrjes islame dhe nuk ka tipar më të çmuar individual të individit sesa edukata e as cilësi më të afërt për masën sesa manifestimi i komunikimit të afërt e i ngrohtë me ta. Çdo lloj ashpërsie dhe sjellje jo korrekte me ta, do t'i largonte njerëzit nga ai, sepse, Allahu xh.sh. thotë: **“Sikur të ishe i ashpër dhe i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje”**.<sup>45</sup> Kështu, ai vazhdon të mbetet shembulli më i mirë për thirrësit në islam edhe në ditët e sotme. Kujtohet për leximin me zë të Kuranit para mushrikve kurejsh, ishte njeri plotë ndjenja, gjatë leximit të Kuranit, sytë i derdhnin lot, qante me zë, faltoren e kishte te dera e shtëpisë. Gjatë faljes së namazit, kur lexonte pjesë nga Kurani, rreth tij tuboheshin robër, gra e fëmijë, dhe të entuziazmuar dëgjonin tek recitonte fjalët, të cilat më parë, ata as që i kishin dëgjuar.

Vërtet njerëzit e parë, që pranuan Islamin dhe da'ven ishin shtylla kurrizore e predikimit të fesë islame. Me ta kishte biseduar dhe i kishte bindur Ebu Bekri, që të vinin te Muhamedi a.s. dhe të pranonin islamin. Këta shokë të nderuar u bënë myslimanë njëri pas tjetrit para Profetit të Allahut, dhe ishin bazat e para të thirrjes islame, duke u bërë kështu fryma e parë që e ndihmoi në përforcimin e fesë dhe në mbështetjen e tij. Prandaj, Allahu i nderoi dhe i ndihmoi ata. Njerëzit vazhdimisht hynin në fenë islame, duke u bashkuar me grupe burrash dhe grash. Të gjithë këta pionierë ishin thirrës në Islam, e pas tyre vijonin ata që ishin më parë, një për një dhe grupi, pavarësisht numrit të vogël, ishin një forcim i thirrjes, një kështjellë e mesazhit në historinë e Islamit. Ebu Bekri ndihmoi familjen e tij të pranonin Islamin. Myslimanë u bënë: Esmā, Aishja, Abdullahi, bashkëshortja e tij Ummu Ruman dhe shërbëtori i tij Amir b.

<sup>43</sup> Ibn Hisham, *Essiretu ennebevije*, Daru ihjai et'turath el arabi, botimi parë, Bejrut, 1995, v. 2, f. 289.

<sup>44</sup> Munir Muhamed Gadban, *El menhexhul hareki lis-siretin-nebevije*, Mektebetu'l menar, bot. 7, Ez-zerka, Jordani, 1992, v. 1, f. 22.

<sup>45</sup> Ali Imran, 159.

Fuhejra. Cilësitë e tij morale të larta dhe karakteri i tij mbresëlënës ishin faktorë të rëndësishëm për të çuar njerëzit drejt Islamit, sepse ai kishte një autoritet të madh në popullin dhe fisin e tij. Ai ishte i dashur dhe person i përshtatshëm për ta. Ishte më i përshtatshëm për Kurejshitët dhe një figurë kryesore në kohën e tij. Qe një udhëheqës i nderuar dhe i sjellshëm, që ndihmonte. Ndhmonte me para, ftonte mysafirë shtëpi dhe me mikpritjen e tij në Mekë, askush nuk mund të matej. Pastaj ishte edhe një komunikues i shkëlqyeshëm. Këto cilësi dhe virtyte morale janë të domosdoshme për të ftuarit drejt Allahut, ndryshe ftesa e tyre nuk do të pranohej. Biografia e të Drejtëve na jep një kuptim të mëtejshëm të mënyrës se si ai e kuptonte Islamin dhe si jetonte me të, në jetën e tij, duke treguar thirrësit sesi duhej të ndiqnin shembullin e tij në predikimin e fesë. Ebu Bekri nuk u ndal vetëm te bartja e dritës së thirrjes, (dave) por gjithashtu mbante peshën e shqetësimit për të dobët e shoqërisë së tij. Ai shpenzonte për lirin e skllavëve besimtarë nga pronarët e tyre mizorë dhe të ashpër. Kështu, i ktheu ata nga poshtërimi i dobësisë në lavdinë e vëllazërisë islame. Nga ngushtica e kufrit, në gjerësinë e besimit dhe të devotshmërisë. Një nga ata, që u munduan shumë ishte dhe Bilalli, robi i Umeje b. Halefit, i cili kur mori vesh se Bilalli ishte bërë mysliman e torturoi. E la pa ngrënë e pa pirë. Madje e nxori në shkretëtirën përvëluese në pikun e nxehtësisë. Mbi gjoks i vendosi një gurë të madh dhe i kërkoi të braktiste fenë islame. Ndërsa, Bilalli me atë pak fuqi dhe ndjenjë, që i kish mbetur, shpreh fjalën më të rëndë për umejen, fjalë e cila shkatërronte çdo ëndërr për ta: Ehad, ehad. Me të marrë vesh Ebu Bekri për këtë ngjarje, shkoi të bindte Umejen, që t'ia shiste Bilallin. E ai, në vend të tij t'i jepte një skllav tjetër më të fuqishëm. Ndërsa, në një transmetim tjetër, thuhet se, Bilallin, Ebu Bekri e bleu për dyzet monedha ari. Pasi e bleu, ai e liroi Bilallin, në mënyrë që ta adhuronte Allahun i lirë. Kështu jetoi Bilalli pjesën tjetër të jetës. I lirë dhe duke shoqëruar Muhamedin a.s., e duke qenë myezini i tij. Po ashtu ka liruar

nga robëria Amir b. Fuhejre<sup>46</sup>, Um Amiis, Zunejra, Nehdije me vajzat e tyre, si dhe të një sërë robërish të tjerë

## Thirrja islame kërkonte një vend më të sigurt

Me vështirësimin e ambientit të thirrjes islame në Mekë, kur mekasit kishin planifikuar të asgjësonin fizikisht Muhamedin a.s., e kur në Mekë përveç muhaxhirëve të burgosur dhe atyre, që ishin kthyer kah feja e tyre, kishte mbetur vetëm Ali b. Ebi Talibi dhe Ebu Bekër b. Ebi Kuhafe Siddiku, r.a., Ebu Bekri disa herë i kishte kërkuar leje Muhamedit a.s. për hixhret, por ai gjithmonë i kishte ikur kësaj kërkese, duke i thënë: *“Mos u ngut! Ndoshta Allahu do të japë bashkudhëtarë!”* Natyrisht, Ebu Bekri dëshironte që, pikërisht ai të bëhej bashkudhëtar i tij, prandaj menjëherë bleu dy deve, të cilat i ushqeu të mbyllura në shtëpinë e tij. E kur erdhi urdhri për Hixhret, Muhamedi a.s. i tha: Allahu më ka lejuar të dal dhe të bëj hixhret!” Ebu Bekri tha: “Së bashku, o i Dërguar i Allahut?!” Tha: Së bashku!” Aishja ka thënë: “Vallahi, kurrë më parë nuk kisha parë, që dikush të qante nga gëzimi. Atë ditë pashë Ebu Bekrin. Miqësia e tij me profetin mori lidhjen e lartë dhe të përrjetshme, duke qenë bashkëndjekës i tij në momentet e vështira dhe të lumtura të jetës.

***“Nëse nuk e ndihmoni atë (Muhamedin), atë pra e ka ndihmuar Allahu, kur e përzunë ata që nuk besuan të dytin prej dyve. Kur ishin në shpellë, ai (Muhamedi i tha shokut të vet (Ebu Bekrit r. a.): “Mos u brengos, vërtet Allahu është me ne!” E Allahu zbriti qetësinë (sekinen) e Vet mbi të, dhe e fuqizoi me fuqi që ju nuk e patë dhe e bëri fjalën e atyre që nuk besuan më të ulëtën, kurse fjala e Allahut është më e larta. Allahu është i Fuqishmi, i Urti.”***<sup>47</sup>

<sup>46</sup> Sqarim: Amir b. Fuhejre ishte robi i Ebu Bekrit, i kulloste delet e veta në afërsi të shpellës Thevr ku ishin fshehur Muhamedi a.s. me Ebu Bekrin tri ditë gjatë Hixhretit dhe pak para mbrëmjes u çonte qumësht.

<sup>47</sup> Et-tevbe, 40.

Një nga pikat më të larta të kësaj lidhjeje të përjetshme ishte udhëtimi i vështirë i Hixhretit nga Meka në Medinë (622), si një prej akteve heroike dhe të thellësisë së dashurisë e të largimit.

## Ebu Bekri u zgjodh si halif

Kur Profeti a.s., pa tek Ebu Bekri forcën e besimit, të drejtësisë ndaj njerëzve dhe aftësinë për të udhëhequr, ia parapërgatiti rrugën për marrjen e halifatit. Ai tha: “Allahu dhe besimtarët nuk pranojnë tjetër veç Ebu Bekrit.”<sup>48</sup>

Kalimin në botën tjetër të Muhamedit a.s., Ebu Bekri i priu dhe e përjetoi mjaftë rëndë sikurse çdo sahabi tjetër, që e donte dhe e respektonte personalitetin e Muhamedit a.s., Ishin çaste të vështira dhe pikëlluese. Pejgamberi a.s. i kishte dhënë disa shenja, për të si halife, kur i ishte rënduar shëndeti. Me kokë të mbështjellë, mezi kishte dalë në namaz të sabahut. Ndërsa, Ebu Bekri me njerëzit tashmë ishte në namaz. Sapo kishte dalë, njerëzit i kishte kapluar një gëzim dhe Ebu Bekri e kishte kuptuar, se kjo mund të ndodhte vetëm për shkak të Muhamedit a.s., ndaj ishte tërhequr nga vendi ku qëndronte në namaz. Por, Muhamedi a.s. e kishte shtyrë në shpinë dhe i kishte thënë: “Priju njerëzve në namaz” ishte ulur e ishte falur në të djathtë të Ebu Bekrit.<sup>49</sup> Atë ditë, Muhamedi a.s. vdes, mu në kohën e nxehtësisë së paradites. Njerëzit nuk qenë pajtuar dot se prijësi i tyre në misionin e daves, kishte vdekur. Omeri r.a. nuk ishte pajtuar me një realitet të tilë dhe kishte vazhduar t’u fliste njerëzve, sikur ai të mos kishte vdekur. Ebu Bekri i kishte thënë: “Ngadalë, o Omer! Mjaft!”. Omeri kishte refuzuar të ulej. Atëherë Ebu Bekri u ishte drejtuar njerëzve, e kur ata kishin dëgjuar zërin e tij, i ishin shmangur Omerit dhe ishin kthyer nga Ebu Bekri. Ai kishte falënderuar Allahun dhe e kishte lavdëruar e më pas u ishte drejtuar masës, duke u thënë: “O

<sup>48</sup> Buhariu, 5666, Muslimi, 2387.

<sup>49</sup> Ibn Hisham, *Essiretun' ebeviye*, Daru ihjai et'turath el arabi, botimi 1, Bejrut, 1995, v. 4, f. 310.

njerëz, ju them se kush ka adhuruar Muhamedin, le ta dijë se Muhamedi tashmë ka vdekur. E kush e dhuron Allahun, le ta dijë se Allahu është i gjallë. Ai kurrë nuk vdes!” Pastaj kishte lexuar këtë ajet:

***“Muhamedi nuk është tjetër vetëm se i dërguar. Edhe përpara tij pati të dërguar (që vdiqën ose u vranë). E nëse ai vdes ose mbytet, a do të ktheheshit ju prapa (nga feja ose lufta)? E kushdo që kthehet prapa, ai nuk i bën dëm Allahut aspak, kurse Allahu Ne do t’i shpërblejë mirënjohësit”.***<sup>50</sup>

Kur Omeri kishte dëgjuar këtë ajet të lexuar nga Ebu Bekri, ishte habitur e ishte ligështuar sa që s’kishte mundur të qëndronte në këmbë. Ishte ulur në tokë dhe çdo gjë ishte qartësuar dhe ishte pajtuar se Muhamedi a.s. kishte vdekur.<sup>51,52</sup> Fjalimi i Ebu Bekrit, qetësoi zemrat e mjerrueshme të myslimanëve. Të gjithë këta kishin përsëritur fjalët hyjnore, që i kishte kujtuar Ebu Bekri dhe të gjithë u ishin nënshtuar vullnetit hyjnor.<sup>53</sup>

Thirrja për të vërtetën (da’ve) nuk mbaron me vdekjen e të dërguarve të Zotit, dhe me thirrësit e imamët, sepse ajo është e përvetshme, edhe nëse ata nuk janë të përvetshëm, vendosmëria e tyre përhapet te ndjekësit dhe i furnizon ata me atë, që u duhet për suksesin e tyre, ndërsa ata vazhdojnë të mbeten të lidhur me të.

Pas një periudhe kohore sahabët vendosën që të shprehin betimin për besnikërinë. Ebu Bekri u zgjodh halif pas vdekjes së Profetit në vitin 632 dhe qëndroi në këtë pozitë deri në vdekjen e tij në vitin 634. Ai ishte një nga shokët më të afërt të Muhamedit a.s. dhe një nga personalitetet më të rëndësishme në fillimet e Islamit. Prandaj, kontributi i tij e bën që, ai të mbetet një nga figurat më të rëndësishme dhe më të ndritura në historinë e Islamit, në formimin dhe përhapjen e thirrjes islame që në

<sup>50</sup> Ali Imran, 144.

<sup>51</sup> Mustafa Subai, *Es-siretu en-nebevije durusun ve iberun*, el Mektebu’l islami, bot. 9, Bejrut, 1986, f. 171.

<sup>52</sup> Sahihu’l buhari, 1/169 dhe Sahihu’l Muslim, 1/306.

<sup>53</sup> Muhamed Ali, Muhamedi profeti ynë, Dituria, Tiranë, 1991, f. 174

fillimet e saj. Roli i tij në thirrjen islame ishte shumë i rëndësishëm dhe i fuqishëm, sepse, ishte ndër të parët, që u bë mysliman, duke pranuar besimin e Islamit me sinqeritet dhe qëndrueshmëri pas dëgjimit të thirrjes së Muhamedit a.s. Mundi i tij në shërbim të Fjalës së Zotit la gjurmë të thellë në historinë e fesë islame dhe shpërndarjen e rrezeve të saj në katër anët e botës. Kontributi i Ebu Bekrit përmes thirrjes së familjarëve, miqve dhe komunitetit në përhapjen dhe komunikimin e Islamit ishte i dukshëm. Ai punoi me zell në përhapjen e thirrjes islame dhe propagandimin e mesazhit të besimit dhe tevhidit. Po ashtu, roli tij në mbajtjen e myslimanëve të qëndrueshëm para sfidave dhe vuajtjeve, që ata përjetuan në fillim ishte shumë i rëndësishëm. Pas vdekjes së Muhamedit a.s., Ebu Bekri u zgjodh halif i myslimanëve dhe udhëhoqi komunitetin islam me urtësi dhe drejtësi. Ai bëri përpjekje të mëdha në tubimin e Kuranit në një libër të vetëm, e cila kishte një rëndësi të madhe në bashkimin e fjalës së myslimanëve dhe në përmirësimin e identitetit islam.

Gjatë sundimit të tij, arriti të menaxhonte jashtëzakonisht mirë në aspektin politik, ushtarak, ekonomik, shoqëror, por edhe më të madhe, në atë të daves. Me zgjuarsinë, trimërinë dhe përvojën e tij të jashtëzakonshme, arriti t'i mundte rebelët, më pas u përball me ata, që refuzuan dhënien e institucionit të zekatit si dhe përgatiti ushtrinë në krye të së cilës ishte Usama ibn Zaid, r.a., i cili arriti të zgjeronte mendimin dhe vlerat e islamit në vende të ndryshme, që nuk kishin arritur më parë. Qëllimi i dërgimit në luftëra e zona të ndryshme ishte i qartë: për të thirrur në islam dhe për të vendosur dominimin e Fjalës së Allahut në planetin tokë. Ebu Bekri r.a., drejtoi strategun më të madh ushtarak të të gjitha kohërave, Halid b. Velid-in në Irak, me këtë qëllim dhe detyrë të lartë. Halidi ishte një komandant ushtarak i shquar dhe ai u bë i njohur për taktikat e tij të shkëlqyera ushtarake dhe për sukseset e tij në betejat kundër armiqve të Islamit dhe luajti një rol kyç në përhapjen e Islamit në Lindjen e Mesme dhe në Afrikën Veriore.

## Fjalimi i parë i Ebu Bekrit si halif

Urtësia dhe efektiviteti i ligjërimit të Ebu Bekrit pasi u zgjedh halife i myslimanëve shikohet brenda kornizave të fesë së drejtë. Ishte ndër oratorët dhe thirrësit më të mirë. Fjalimi pas vdekjes së Profetit, fjalimi, mbajtur në Ditën e Sekijfes, fjalimi pas besatimit (El-Bejah), fjalimi kur shumë njerëz e braktisën fenë, fjalimi kur i mblodhi ushtritë për luftimin e ithtarëve të Librit në Sham, kujtohen edhe më. Njeriu më i mirë pas Profetit është Ebu Bekri. Çdo lëvdatë, që përmendet në Kuran, përfshihet i pari në të. Është i pari që do të hyjë në xhenet nga ky ummet. Do të thirret nga të gjitha dyert e xhenetit. Thënia e Omerit për të: “Një natë dhe një ditë e Ebu Bekrit është më e mirë se sa Omeri dhe familja e tij”, ishte influencuar nga stili i Kuranit, ku në të gjejmë një larmi të mahnitshme, diferenca të habitshme, në paraqitje dhe një trajtim të suksesshëm të të gjitha kategorive njerëzore.

Sejid Kutbi thotë: “Ky ishte Kurani, ai që përballej me shpirtat e njerëzve në Mekë. Ai i zbuste ata, derisa i nënshtroheshin udhëheqjes se tij, të vetëdijshëm në këtë zgjedhje. Kurani u drejtohet këtyre shpirtave në mënyra të ndryshme e të habitshme... Ndonjëherë përballet me ta si një shtrëngatë e furishme, me faktet që shpalos dhe me forcën e një rrebeshi... Ndonjëherë si të jetë një fshikullime përvëluese, që u jep flakë ndjenjave, goditjen e së cilës nuk mund ta mbash e zjarrminë e se cilës nuk mund ta durosh. Ndonjëherë i ngjan një bashkëbisedimi dashamirës, të dashur e të ngrohtë, që gjallëron ndjenjat dhe ngazëllen zemrat... Ndonjëherë të kallë datën dhe të buçet frikshëm. Të hap sytë ndaj një rreziku, që kërcënon së afërmi. Ndonjëherë të shfaqet me të vërtetën e thjeshtë e të qartë, ku nuk të lë hapësirë shmangieje e as vend për debat... Ndonjëherë si shpresë rrezatuese dhe bujare, që të thërret e të pëshpërit... Ndonjëherë i depërton njeriut nëpër rrjedhat dhe labirintet e shpirtit, duke hedhur dritë mbi qenien e tij. Për të parë se ka ndodh brenda tij, për ta bërë t'i vije turp për një pjesë dhe për të urreyer një pjesë tjetër. Për ta mbajtur zgjuar për lëvizjet dhe reagimet, ndaj të cilave ishte i pavëmendshëm. Me qindra prekje, ngacmime, thirrje, pëshpëritje ndjen

ai që e lexon Kuranin. Ai i shkon pas asaj beteje të gjatë, atij mjekimi të ngadaltë dhe shikon se si Kurani ia doli të fitonte ndaj injorancës në ato shpirtra të pabindur dhe kryeneçe.”<sup>54</sup>

Pastaj foli Ebu Bekri. Ai së pari i shprehu falënderimin dhe lavdërimin e duhur Allahut, e pastaj tha: *“O njerëz! Ju më keni zgjedhur si liderin tuaj megjithëse unë s’jam më i mirë nga ju. Ndaj, kërkoj ndihmën dhe mbështetjen tuaj nëse veproj drejt, dhe të më ftoni në rrugën e duhur nëse shmangem nga ajo. Pa dyshim se drejtësia është një dhuratë e çmuar dhe padrejtësia një formë tradhtie. Me shpresën tek Allahu, më i dobëti nga ju do të jetë më i forti kur unë të mbroj të drejtat e tij. Po ashtu, më i forti nga ju do të jetë më i dobëti kur unë të korrigjoj gabimet e tij. Kini kujdes, askush nga ju nuk duhet të tërhiqet nga përpjekja në rrugën e Allahut. Kujtoni se kush ka neglizhuar në këtë çështje, ka merituar poshtërimin e Allahut. Allahu do të sjellë fatkeqësi të mëdha mbi atë popull ku imoraliteti është shpërndarë lirisht. Bindmuni mua për sa kohë unë i bindem Allahut. Nëse bëj ndonjë gabim në bindjen ndaj Allahut dhe të Dërguarit të tij, atëherë mos m’u bindni! Tash ngrihuni për namaz, Allahu ju mëshiroftë.”*<sup>55</sup>

Fjalimi i parë i Ebu Bekrit si halif i myslimanëve dhe si përgjegjësi kryesor për thirrjen islame pas Muhamedit a.s., ishte një moment shumë i rëndësishëm në historinë e Islamit. Në fjalimin e tij të parë si halif, Ebu Bekri adresoi të pranishmit, duke filluar me falënderimin për besimin dhe mbështetjen e tyre. Ai theksoi rëndësinë e unitetit dhe bashkëpunimit në mesin e myslimanëve dhe betimin e tij për të vazhduar rrugën e drejtë e për të mbrojtur Islamit. Ai gjithashtu u zotua për të përmbushur detyrat e tij si udhëheqës me drejtësi për të mirën dhe dobinë e komunitetit.

Fjalimi i Ebu Bekrit si halif shënoi fillimin e një periudhe të re në historinë e Islamit dhe tregoi për qëndrueshmërinë dhe zgjuarsinë e tij si udhëheqës. Ky fjalim u përcoll me respekt dhe përkushtim nga të pra-

<sup>54</sup> Sejid Kutb, *Fi dhilali'l kuran*, bot. 17, Darush'shuruk, v. 6, Kajro, 1992, f. 3692.

<sup>55</sup> Ibn Hisham, *Essiretun' ebevije*, Daru ihjai et'turath el arabi, botimi 1, Bejrut, 1995, v. 4, f. 318-319.

nishmit dhe u përhap gjerësisht në mesin e myslimanëve si një shenjë e fillimit të një epoke të re për postprofetike.<sup>56</sup>

Nuk u mjaftua vetëm me thirrjen teorike në islam, por në atë thirrje përfshiu tërësisht veten e tij, madje edhe vendosi të dhurojë tërë pasurinë. Atë ditë kur u bë mysliman, në shtëpinë e tij gjenden 40,000 dërhem. Ai i ndau të gjitha në rrugën e Allahut. Aishja r.a., tregon se Ebu Bekri kryesisht e bëri këtë, duke liruar robërit e sëmurë dhe të pafuqishëm. Kishte liruar nga skllavëria dhe kishte shpëtuar shtatë skllavë nga torturat dhe mundimet e rënda dhe jo njerëzore.<sup>57</sup> Në përpjekjet për shtrirjen dhe komunikimin e daves si dhe në afirmimin e së vërtetës, ndau çdo gjë që zotëronte. Omer b. Hatabi r.a., tregon një ngjarje interesante ku përmendet se shokët e të Dërguarit a.s. shtyheshin me njëri-tjetrin në fushën e veprave të mira dhe të veprave të sadakasë *"I Dërguari a.s. na urdhëroi që të japim sadaka në një kohë kur kisha pak para. Thashë me vete: 'Këtë ditë do t'ia kaloj Ebu Bekrit.' Unë i solla gjysmën e parave dhe i Dërguari a.s. më pyeti: 'Çfarë i ke lënë familjes?' Unë i thash: 'Një sasi të ngjashme.' Kurse Ebu Bekri e sollti krejt atë, që e kishte dhe i Dërguari a.s. e pyeti: 'Çfarë i ke lënë familjes?' Ai tha: 'Allahun dhe të Dërguarin e Tij.' Kështu unë fola me vete: 'Kurrë nuk do të garoj me juve përsëri.'*<sup>58</sup>

Nuk do habitemi kur citojmë se shumë autorë, që ndajnë mendimin se sebebu-nuzul (shkaku i zbritjes)<sup>59</sup> së ajeteve kuranore njëmend ishte për qëllim Ebu Bekri, për arsye të ndarjes së pasurisë në rrugën e Allahut xh.sh. Andaj Krijuesi ynë thotë: ***Ndërsa ai, që është më i devotshëm do të jetë larg tij. Ai, që e jep pasurinë e vet e pastrohet. E jo për ta shpërblyer ndokë, që i ka bërë mirë më parë. Por vetëm për të fituar***

<sup>56</sup> Abdulvehab Nexhar, *El hulefau errashidun*, Daru'l kalem, bot. i 4, Bejrut, 1993, f. 42.

<sup>57</sup> Ibn Asakir, *Es-Sujuti, Tarihu'l hulefai*, f. 36.

<sup>58</sup> Hadith sahih tek Davudi, nr. 1680, dhe Hadithi hasen sahih tek Tirmidhiu, nr. 3675.

<sup>59</sup> Ebu Hasen Ali Ahmed el-Vahidi, *Esbabu nuzuli'l kuran*, Daru'l kutub el ilmije, bot. 1, Bejrut, 1991, f. 479.

***kënaqësinë e Zotit të vet, më të lartit. Për Zotin, ai do të gëzojë atë kënaqësi!***<sup>60</sup>

Ai çdo ditë dëshmonte një karakter të fortë si mysliman dhe një stil jete domosdoshmërie edhe për predikuesit e vlerave të islamit. Njëherë Pejgamberi a.s. i pyeti të pranishmit: “Kush prej jush sot është gdhirë agjërueshëm?” – Unë, – tha Ebu Bekri. Kush prej jush sot ka përcjellë xhenaze? – Unë, – tha Ebu Bekri. Kush prej jush sot ka ushqyer ndonjë të varfër? – Unë, – tha Ebu Bekri. Kush prej jush sot ka vizituar ndonjë të sëmurë? – Unë, – tha Ebu Bekri. Ai që i bën të gjitha këto (brenda një dite) do të hyjë në Xhenet” -tha i Dërguari i Allahut.<sup>61</sup>

## **Tubimi i burimit të da'ves-Kuranit**

Ndër punët e tjera, që ndërmori Ebu Bekri r.a., ishin në plane afat gjata dhe afatmesme në shërbim direkt të predikimit të islamit (da've). Ai realizoi qëllime të mëdha. Arriti fitore madhështore dhe ditët e tij ishin të mbushura me begati, megjithëse ato ditë nuk zgjatën më shumë se dy vjet e tre muaj. Si punë më të rëndësishme do të mund të llogarisim: Nxjerrja e ushtrisë së Usame b. Zejd në betejën, që kishte caktuar Muhamedi a.s, pak para vdekjes së tij, luftimi i dezertorëve, grumbullimi i Kuranit në një mus'haf (libër) të vetëm, çlirimet e tokave të reja, etj.

Në këtë aspekt, Ebu Bekri kishte një rol vendimtar në procesin e mbledhjes së Kuranit në një volum të vetëm, si pjesë e përpjekjeve për të parandaluar humbjen ose deformimin e tekstit të shenjtë. Kjo mbledhje e Kuranit u bë një ngjarje e rëndësishme në historinë e Islamit dhe u realizua me ndihmën e shokëve të tij dhe të tjera figure kryesore në komunitetin e myslimanëve. Gjatë halifatit të Ebu Bekrit u paraqitën shumë sfida të rënda në fushën e thirrjes islame, por edhe myslimanë. Së pari Ebu Bekri arriti, që të shuaj çdo thirrje të rreme, që mundoheshin të paraqiteshin si të dërguar, si çështja e Musejleme Kedhabit. Po ashtu bëri thirrje

<sup>60</sup> El-Lejl, 17-21.

<sup>61</sup> Muslimi nr. 1028.

për kthimin e murtedve në Islam: Pas vdekjes së Profetit, disa arabë u kthyen në murted. Disa mohuan plotësisht thirrjen për t'u kthyer në Islam. Ndërsa, disa refuzuan të përmbushin disa detyrime si pagesa e zekatit. Vetëm banorët e dy xhamive në Mekë dhe në Medinë qëndruan besnikë ndaj thirrjes Islame. Për sojin e tyre (murtedëve) na ka lajmëruar kurani, duke na thënë: ***Beduinët thanë: “Ne kemi besuar!” Thuaj: “Ju nuk keni besuar ende, por thuani: ne jemi dorëzuar, e ende nuk po hyn besimi në zemrat tuaja. E nëse e respektoni Allahun dhe të dërguarin e Tij, Ai nuk ju pakëson asgjë nga veprat tuaja, se Allahu është shumë mëkatfalës, shumë mëshirues”***.<sup>62</sup>

Në këtë rrafsh u zhvillua lufta në Jemame (632 h) ndërmjet palës myslimane dhe të dezertorëve (murtedëve), ithtarë të Musejleme Kedhabit. Në këtë luftë ranë dëshmorë shtatëdhjetë hafizë të Kuranit dhe mendohet se u vranë 1.200 sahab, ndërsa nga murtedët, u vranë 20.000. Kjo situatë ishte jashtëzakonisht alarmuese për të ardhmen e kuadrove të thirrjes islame. Me këtë rast Omer b. Hatabi iu ankua Ebu Bekrit për këtë humbje, për të cilën edhe vetë halifi ndinte pikëllim dhe dhembje nga frika se humbja e një numri kaq të madh të hafizëve do të humbte diçka nga Kurani, andaj i propozoi ta tubojnë atë. Ebu Bekri shfaqti hezitim, por më vonë u pajtua me këtë mendim. Buhariu shënon: Zejdi thotë: “Pas luftës në Jemame më thirri Ebu Bekri. Kur hyra tek ai, aty kishte qenë ulur Omeri. Ebu Bekri më tha: Erdhi tek unë Omeri e më tha: “Lufta ka marrë përmasa të gjera me vrasjen e hafizëve, po kam frikë se lufta do të vazhdojë dhe në çdo vend do të humbim ende hafizë të tillë. Unë jam i mendimit që të urdhërosh të tubohet Kurani!” Unë i thashë: “Si të bëj atë, që nuk e bëri Pejgamberi?”- Omeri më tha: Kjo është me dobi!- Ma përsëriti disa herë derisa edhe mua m'u mbush mendja ashtu si Omerit!” Ti je i ri, je i zgjuar, tek ty nuk kemi dyshim, ti i shkrove shpalljen Pejgamberit, ti fillo dhe tuboje Kuranin!” Zejdi thotë: “Pasha Allahun, të më obligonte ta rrafshoja ndonjë kodër, për mua nuk do të ishte punë më e rëndë se sa atë, që më urdhëroi dhe i thashë: “Si do ta bëni një punë që

---

<sup>62</sup> El Huxhuratë, 14.

Pejgamberi a.s. nuk e bëri?” Ai më tha: Kjo është me dobi dhe duke më bindur, pranova dhe ia fillova ta tuboja Kuranin prej lëvoreve, prej rrasave, prej lëkurave dhe prej njerëzve, që i dinin përmendësh, derisa edhe ajetin e parafundit të sures Tevbe “*Ju erdhi i dërguar nga mesi juaj. Atij i vjen rëndë për vuajtjet tuaja. I brengosur për besimtarët, i butë dhe i mëshirshëm.*”<sup>63</sup> e gjeta te Huzejme b.Thabit el Ensariu!<sup>64</sup>

Usejd ibni Thabiti ishte më i dalluari prej të tjerëve. Kishte shkruar vahjin në prani të Pejgamberit. Ishte i fortë në besim. Ishte besnik. I denjë, i matur, i edukuar dhe shumë i zgjuar. Ai tubim dhe ai shkrim i saktë i tërë Kuranit u ruajt tek Ebu Bekri. E pas vdekjes së tij, tek Omeri dhe pas Omerit te Hafsaja, bashkëshorte e Pejgamberit, e bija e Omerit. Kurani në tërësi u shkrua dhe u ruajt në kujtesë gjatë kohës së Pejgamberit, por nuk u tubua në një vend, sepse: shpallja e Kuranit nuk kishte përfunduar, e nuk kishte se si të tubohej para se të kompletohej. Radhitja e sureve dhe e ajeteve nuk bëhej sipas zbritjes së tyre, sepse zbritën ajete në fund të shpalljes, ndërsa radhitja e tyre duhej bërë në suret e shpallura më herët. Koha prej zbritjes së fundit dhe ndërrimit jetë të Pejgamberit ishte shumë e shkurtër, prandaj nuk pati mundësi të tubohej.<sup>65</sup>

Sa i përket jetës familjare, ai ishte i sjellshëm dhe i kujdesshëm edhe në rrafshin familjar. Familja e tij kishte disa cilësi, që rrallë i posedonte ndonjë familje tjetër. Familja e tij kishte qenë shkaku i zbritjes së ajetit kuranor, që i lejonte myslimanët të merrnin tejemum kur nuk kishte ujë për abdes. Pas zbritjes së këtij ajeti, Usejd ibn Hudejri tha: “Pa dyshim, ky nuk është i vetmi bekim i ardhur mbi familjen e Ebu Bekrit”. Midis Sahabëve, familja e Ebu Bekrit ishte e vetmja, që kishte namin për katër breza myslimanësh. Kjo ishte arritur përmes Abdurrahmanit dhe Esmës.

---

<sup>63</sup> Et-Tevbe, 128.

<sup>64</sup> Hafidh Ahmed b. Akli b. Haxher el Askalani, *Fet’hul-Bari bi sherh Sahihu’l Buhari*, darur’rejan lit’turath, kapitulli i tefsirit, v. 6, bot. 2, Kajro, 1987, v. 6, f. 89.

<sup>65</sup> [https://www.alukah.net/books/files/book\\_9572/bookfile/quran\\_albany.pdf](https://www.alukah.net/books/files/book_9572/bookfile/quran_albany.pdf) (qasja 16.5.2024).

Gjatë jetës së tij, vazhdimisht dëshmoi kujdes shumë të shtuar në komunikimin me njerëzit, qoftë ata që i njihte, apo jo. Është një cilësi e rëndësishme për të pasur në kujdes gjatë thirrjes islame dhe për të treguar respekt ndaj të tjerëve. Shfaqte kujdes në komunikimin e fesë së Allahut dhe mësimëve profetike dhe veçohej me disa tipare në këtë drejtim, si:

*Dëgjonte me kujdes:* Për të kuptuar mendimet dhe ndjenjat e të tjerëve.

*Tregonte mirënjohje:* Tregonte vlerësim për kontributet dhe idetë e të tjerëve, duke i inkurajuar ata të ndajnë më shumë në të ardhmen.

*Zgjidhte mosmarrëveshjet me respekt:* Kur haste në mosmarrëveshje, zgjidhte ato me respekt dhe me qëllim për të arritur në një zgjidhje të përballeshme dhe të qëndrueshme për të gjithë.

*Ishte i qartë:* Komunikimi i qartë ndihmon në shmangien e ndërprerjeve dhe në sigurimin, që mesazhi i islamit të kuptohet drejt.

*Tregonte empati:* Pajtohej me ndjenjat dhe përvojat e të tjerëve, sepse, kështu ndihmon për të krijuar lidhje të fortë dhe në të kuptuarit më mirë të situatave.

*Respektonte pikëpamjet e të tjerëve:* Edhe nëse nuk pajtohej me pikëpamjet e tyre, respektimi i tyre është i rëndësishëm për një komunikim dhe thirrje (da've) të shëndetshëm.

*Nuk harronte të falënderohej:* Nëse dikush i ndihmonte ose i ofronte kohën e tij, falënderonte dhe e vlerësonte.

## Kalimi në amshim i thirrësit më të mirë

Ebu Bekri gjithashtu theksoi rëndësinë e përkushtimit të vazhdueshëm ndaj Islamit dhe mësimëve të Profetit: “O besimtarë, qëndroni të palëkundur në fenë tuaj dhe mos lejoni, që tundimet e kësaj bote t’ju largojnë nga rruga e drejtë. Mbani mend fjalët e Profetit dhe ndiqni shembullin e tij në çdo hap të jetës suaj. Kjo është rruga e suksesit dhe shpëtitimit. “Këto fjalime, që i theksuam e që shumë sosh për shkak të natyrës së punimit nuk mund t’i theksojmë, reflektojnë urtësinë dhe përkushtimin e Ebu Bekrit ndaj Islamit dhe komunitetit mysliman. Ai ishte një

udhëheqës që gjithmonë inkurajonte drejtësinë, devotshmërinë dhe unitetin mes myslimanëve. Në fund të jetës së tij, Ebu Bekri ishte sëmurë dhe kishte temperaturë dhe nga kjo gjendje rënkoj 15 ditë në shtrat dhe vdiq më 22 Xhumadel-Uhra të vitit 13 hixhri, ose 23 gusht 634.<sup>66</sup> Omeri r.a. ia fali namazin e xhenazes dhe u varros në krah të shokut të tij, Muhamedit a.s. Kokën ia vendosën paralel me supin e Profetit a.s., duke qenë kështu shoku i pandarë i tij si në jetë ashtu dhe në vdekje.

## Përfundim

Ebu Bekri është respektuar thellësisht nga besimtarët për kontributin e tij në komunikimin e Islamit (dave) dhe mbrojtjen e Islamit dhe për veprat e tyre të mëdha dhe qëndrueshmërinë në ndjekjen e misionit të Muhamedit a.s. Gjatë kësaj kohe, ai vazhdoi të tregonte përkushtimin e tij ndaj Islamit dhe detyrave të tij si halif. Ai u përpoq të siguronte një tranzicion të qetë të udhëheqjes për të mirën e myslimanëve. Përfundimi i jetës së Ebu Bekrit si thirrës islam ishte një periudhë e rëndësishme për historinë e hershme të Islamit. Para se të ndërronte jetë, Ebu Bekri dha mësim dhe këshilla të fundit për komunitetin. Nxiti myslimanët të vazhdonin të ndiqnin mësimet e Muhamedit a.s. dhe të qëndronin të bashkuar rreth thirrjes islame. Ai theksoi rëndësinë e drejtësisë, ndershmërisë dhe të përkushtimit ndaj fesë, andaj veprimet e tij si udhëheqës dhe thirrës islam kanë lënë një ndikim të thellë në historinë dhe kulturën islame. Ebu Bekri r.a. u varros pranë mikut dhe mësuesit të tij të dashur, Muhamedit a.s., në Xhaminë e Profetit në Medinë. Varrosja e tij afër Profetit a.s., simbolizonte lidhjen e tij të ngushtë me të dhe përkushtimin e tij të jetës ndaj thirrjes islame.

Ai u rrit në një mjedis shumë të rëndë e armiqësor nga kurejshët, që e luftuan thirrjen islame. Që në filltet e saj, shohim Ebu Bekrin, që kishte një imunitet, që ia dha Allahu dhe mbrojtje nga ato ndikime dhe nuk iu përul asnjë idhulli. Nuk konsumoi alkool dhe zotëronte moral të lartë,

---

<sup>66</sup> Abdulvehab Nexhar, *El hulefau errashidun*, Daru'l kalem, bot. i 4, Bejrut, 1993, f. 116.

gjë që edhe thirrësi në islam duhet të formojë një zonë imuniteti, që të mos ndikohet nga negativitetet dhe e mbanë timonin e objektivit të paluhatur. Nëse e ka imanin e qëndrueshëm dhe të palëkundur sikurse e kishte Ebu Bekri, do të arrinte të qëndronte i fortë dhe stabil në rrugën e thirrjes islame dhe i lehtësohen vështirësitë e jetës. Cilësitë e larta njerëzore, që i zotëronte Ebu Bekri r.a., në vetvete janë ishte pjesë e thirrjes islame. Pjesë e personalitetit të tij ishte sinqeriteti e modestia. Ishte model i mirë për t'u pasuar nga thirrësit, që të ofrohen me këtë thirrje tek Allahu xh.sh., dhe të ketë ndikim te masa.

Ai kishte një durim të hekurit, që i bëri ballë furtunave dhe presioneve psikologjike e torturave të ndryshme nga mekasit, por kjo bëri që kjo thirrje të tregohet e suksesshme, që duhet të ishte model pozitiv edhe për thirrësit e sotëm. Kishte një bagazh të madh të dijes dhe të kuptimit të fesë. Kjo çështje është jetike edhe për thirrësin që t'i vlerësojë gjërat drejt dhe mirë në peshën e ekuilibrit. Sikurse po ashtu kishte veti të urtësisë, butësisë, e të faljes. Kishte fuqi ndikimi të jashtëzakonshëm kur lexonte Kuranin fshehurazi dhe haptazi para mekasve dhe falej publikisht. Kjo bëri që shumë mekas të kalonin në islam. Ngjarjet i përjetonte me qetësi dhe jo nën presion, gjë që e dëshmon dhe rasti i vdekjes së Muhamedit a.s. kur me fuqinë e të folurit dhe të argumentimit, arriti t'i bind dhe të qetësojë masën e trazuar pas Muhamedit a.s. Por në këtë drejtim, edhe rasti i luftës ndaj murtedëve e menaxhoi jashtëzakonisht mirë dhe korri sukses që ishte një sprovë ndër më të rëndat në hilafatin e tij. Ai po ashtu gjatë thirrjes islame nuk u mërzi e as nuk u dorëzua, por vazhdoi në mision e thirrjes islame. Kjo duhet të jetë një forcë shtytëse edhe për thirrësit tanë. Tjetër cilësi, që duhet të pajiset thirrësi me të, sot, është edhe devotshmëria, asketizmi, në trimëri ndaj të vërtetës dhe ta shpreh atë e të vazhdojë tutje në rrugën e vërtetë të Islamit. Në fund mund të përfundojmë në këtë pjesë të artikullit për sahabiun e nderuar, Ebu Bekrin, se ai mbetet një kala e pamposhtur e thirrjes islame dhe model për të gjithë ata, që kanë marrë përgjegjësinë dhe amanetin e mesazhit hyjnor mbi supet e veta.



# Komentimi i Kuranit nga h. Sherif Ahmeti

Dr. Azmir Jusufi\*

## Abstrakt

Kurani, siç është e njohur, përfaqëson themelin e parë dhe fundamental të Sheriatit nga i cili burojnë mesazhet dhe mësimet gjithëpërfshirëse, rregullat juridike dhe të gjitha rregullat e jetës në Islam. Gjithashtu, ai është themeli i të gjitha shkencave të tjera Islame. Komentimi i mesazheve fisnike kuranore, është një nga fushat më të rëndësishme Islame. Kjo fushë gjithmonë ka tërhequr vëmendjen e shumë studiuesve islamë si në të kaluarën ashtu edhe sot. Mesazhet e Kuranit ishin, dhe si të tilla mbetën, burim themelor i mendimtarëve islamë. Prandaj, qëllimi i këtij punimi është të tregojë për komentimin e Kuranit në gjuhën shqipe nga dijetari i shquar kosovar, Sherif Ahmeti, si komentues i parë i komentimit komplet të Kuranit në shqip, për metodologjinë që përdori në komentimin e Kuranit, për komentimin e Kuranit në

---

\* Autori Dr. Azmir Jusufi ka mbaruar magistraturën dhe doktoratën në Fakultetin e Shkencave Islame në Sarajevë, lëmi i tefsirit. Është imam i dytë dhe mual-lim në xhaminë "Darusselam" -Arbana në Prizren, si dhe përkthyes dhe interpret gjyqësor. Punon në GC&DA Consulting. E-mail: azmir.gceda@gmail.com

frymën e kohës, për përdorimin e haditheve në komentimin e Kuranit, e veçanërisht në lidhje me “shkencat kuranore”.

**Fjalë kyçe:** komentimi; metodologjia; Sherif Ahmeti; shkencat kuranore; vlera e Kuranit.

## Abstract

The Quran, as is well known, represents the primary and fundamental foundation of Shariah from which stem comprehensive messages and teachings, legal rules, and all aspects of life in Islam. Additionally, it is the foundation of all other Islamic sciences. The commentary on the noble Quranic messages is one of the most important Islamic fields. This field has always attracted the attention of many Islamic scholars both in the past and today. The messages of the Quran were, and remain, a fundamental source for Islamic thinkers. Therefore, the purpose of this paper is to discuss the commentary of the Quran in the Albanian language by the distinguished Kosovar scholar, Sherif Ahmeti, as the first commentator of the complete Quran in Albanian, the methodology he used in his Quranic commentary, the interpretation of the Quran in the spirit of the times, the use of Hadiths in Quranic commentary, and particularly in relation to “Quranic sciences.”

**Keywords:** Commentary; methodology; Quranic sciences; Sherif Ahmeti; value of the Quran.

## Hyrje

Kurani është Fjalimi i Allahut xh.sh, i shpallur përmes engjëllit të shpalljes, Xhibrilit a.s., të Dërguarit të fundit të Allahut, Muhamedit a.s., dhe përmes tij si Dritë, Udhëzim, Shërim dhe Mëshirë për të gjithë njerëzimin përdërisa ka ditë e natë në këtë Gjithësi.

Për ta kuptuar këtë Kuran - Fjalimin e Allahut, është e nevojshme të depërtojmë në thellësitë dhe sekretet e tij dhe kështu të nxjerrim në dritë sekretet, urtësitë dhe xhevahiret e tij. Prandaj, komentimi i Kuranit është një nga aspektet më të rëndësishme të kuptimit të duhur të mesazheve dhe porosive kuranore për njerëzimin.

Në punim përgjithësisht do të bëhet fjalë për komentimin e Kuranit nga një prej figurave më të shquara të shqiptarët në Kosovë dhe më gjerë, Haxhi Sherif Ahmetin. Prandaj, para së gjithash, do të bëhet fjalë për nevojën dhe vlerën e komentimit të Kuranit dhe për Sherif Ahmetin, komentuesin e parë të Kuranit në gjuhën shqipe. Gjithashtu, në punim do të bëhet fjalë për metodologjinë e përdorur gjatë komentimit të Kuranit nga ky erudit midis popullit shqiptar; për komentimin e Kuranit në frymën e kohës dhe nevojave të njerëzve, dhe për përdorimin e hadithit gjatë komentimit të Kuranit, etj.

## Sherif Ahmeti, komentues i parë i Kuranit komplet në gjuhën shqipe

Ajo çka më së shumti e pasuron dhe e dallon përkthimin dhe komentimin e Kuranit të Sherif Ahmetit nga përkthimet e komentimet e tjera të deri atëherëshme të Kuranit në gjuhën shqipe, është komentimi dhe analiza nga fillimi i tekstit kuranor, duke filluar nga surja El-Fatiha, deri në fund të tekstit të Kuranit, d.m.th. surja En-Nas.

Sherif Ahmeti në interpretimin e ajeteve kuranore nuk ka përdorur fusnota; në vend të numrave është përdorur shenja e yllthit (\*), që shë-

non fundin e ajeteve për të cilat jepet komentimi i më pastajmë. Kohë pas kohe, sipas tematikës së një numri të ajeteve, ka shënuar një koment jo aq të gjerë, të bazuar në burimet, siç i quan ai vetë, më të “besueshme tradicionale”, sidomos kur ishte fjala për shkakun dhe motivin e shpalljes së një pjese të Kuranit.<sup>1</sup>

Sherif Ahmeti në punën e tij ishte frymëzuar nga autorë të mëparshëm, veçanërisht nga shkrimet e tyre, përkthimeve dhe fjalimeve të Ibrahim Dalliu e të tjerëve, dhe nga përkthyesit dhe komentuesit boshnjakë të Kuranit, kryesisht nga Husein Xhozo, e që e gjithë kjo i jepte inkurajim jo vetëm të hynte në punën e përkthimit të Kuranit në gjuhën shqipe, por edhe në komentimin e Fjalëve të Zotit xh.sh., Kuranit, një punë shumë të vështirë për autorët dhe intelektualët.

Edhe para Sherif Ahmetit, ulemaja e caktuar nga radha e shqiptarëve, kishte bërë përpjekje për të komentuar Kuranin dhe mesazhin e tij të bartin në gjuhën shqipe, siç ishte rasti i komentimit të Kuranit nga hafiz Ibrahim Dalliu dhe individë të tjerë. Megjithatë, i pari, i cili e ka komentuar dhe ka publikuar komentimin e kompletuar të Kuranit në gjuhën shqipe, ishte Sherif Ahmeti. Edhe pse komentimi i tij nuk ishte volumnoz, autori ka arritur që brenda kufijve të mundësisë dhe aftësive të tij intelektuale, të përcjellë mesazhin e Kuranit në gjuhën e popullit të tij.

## Metodologjia në komentimin e Kuranit nga H. Sherif Ahmeti

Myderriz Sherif Ahmeti nuk ishte thjesht vetëm përkthyes i ajeteve, por njëkohësisht ishte analizues dhe komentues i thellë i tyre. Asnjëherë, deri në momentet e vdekjes, nuk u nda nga studimet për Kuranin dhe mësimet e tij. Gjithë jetën ia kushtoi ndriçimit të Fjalës së Zotit xh.sh. U shkri mu si qiriri, për t'u bërë dritë të tjerëve, me të vetmin qëllim, që

---

<sup>1</sup> Xhabir Hamiti, H. Sherif Ahmeti – përkthyes dhe komentues i Kur'anit “, *Haxhi Sherif ef. Ahmeti – Jeta dhe vepra (1920-1998)*, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë, f. 61.

njerëzve, bashkëkombësve të tij, t'u trasonte rrugën e drejtë të fesë islame. Në punimet e tij të para për Kuranin, përqendrohej në tematika të ndryshme, të cilat ishin aktuale për kohën, rrethanat dhe ambientin, në të cilin jetonte dhe vepronte. Në krye të çdo punimi të tij, kryesisht zgjidhte një ajet kuranor në vend të titullit, nën të cilin sillte mendime, shpjegime, krahasime dhe analiza, shembuj ilustrues me një stil origjinal.<sup>2</sup> Ishte i vetëdijshëm se Fjala e Zotit, e përcjellë përmes Pejgamberit, e përmbledhur në një koleksion të quajtur Kuran, nuk ishte fjalë e rëndomtë, e cila mund të shqiptohej lehtë, mirëpo megjithatë, ai asnjëherë nuk hoqi dorë nga veprimtaria për të përkthyer, shpjeguar dhe analizuar fjalën e Librit të Zotit në gjuhën e tij amtare.<sup>3</sup> Për më shumë se tri dekada në vazhdimësi, dha kontribut të çmueshëm dhe të pakrahasueshëm në përkthimin dhe shpjegimin e pjesëve të Kuranit në kuadër të tematikave, të cilave u qasej në punimet e tij, e të cilat u publikuan në “Buletin” e “Takvim”, “Edukata Islame”, e më vonë në “Dituria Islame”, botime këto të Bashkësisë Islame të Kosovës.

Siç e kemi përmendur më lart, por edhe më poshtë në pjesën e fundit të këtij punimi, Sherif Ahmeti ishte në thelb tradicionalist dhe Kuranin e komentoi me metoda tradicionale. Ai, në rend të parë, Kuranin e komentonte me vetë Kuran, e cila është karakteristikë e komentuesve tradicional të Kuranit, e pas kësaj metode, vend të posaçëm në komentimin e tij zuri hadithi dhe syneti i Muhamedit a.s., e më pas edhe thëniet e sahabëve të shquar të këtij ymeti. Megjithatë, duke lexuar punimet e tij, mund të vërejmë se pak sa edhe u largua nga metodat tradicionale, duke hyrë dhe duke i dhënë edhe komente racionale fjalëve dhe ajeteve të caktuara. Kështu që e lidhi traditën me racionalen. E gjithë kjo si rezultat e në harmoni me nevojat e kohës, sepse, thotë se ka shumë ajete në Kuran që na tregojnë për vlerat, që ne duhet t'i japim logjikës.<sup>4</sup> Lidhur me këtë me-

---

<sup>2</sup> Ibid. f. 56.

<sup>3</sup> Ibid. f. 56.

<sup>4</sup> Sherif Ahmeti, “Komente i një verseti të Kuranit a.sh.”, Edukata Islame, nr. 24, Prishtinë, 1979, f. 3.

todë të fundit, veçanërisht në interpretimin e tij u mbështet në Tefsirin e er-Raziut dhe ez-Zamahsheriut, edhe pse ky i fundit nuk është përmendur askund, por, kjo mund të shihet te përkthimi dhe komentimi i tij i Kuranit.

Rreth metodave të komentimit të Kuranit, Sherif Ahmeti thotë: “Shpjegimi ose komentimi i asaj, të cilën Allahu nëpërmjet fjalës së vet e kërkon dhe e dëshiron prej krijesave, arrihet më së miri kur ndonjë pjesë e Kuranit shpjegohet me pjesën tjetër të tij, ose kur shpjegohet nga vetë Pejgamberi, ose kur ndonjë pjesë e tij shpjegohet nga sahabët e Pejgamberit. Shpjegimet e mëvonshme, të pabazuara në burimet e para, janë shpjegime racionale dhe individuale, andaj nuk kanë peshë të duhur.”<sup>5</sup>

Se Sherif Ahmeti, gjatë komentimit të Kuranit, e kishte përdorur Tefsirin e Fahu-Razit, në bazë tjerash, mund të kuptohet nga fjalët vijuese: “Sipas Fahrur Raziut (siç e quajti Fahrudin er-Raziun), e tërë kjo sure (mendohet për suren Fussilet), prej fillimit e deri në mbarim, është një periudhë, fjalitë e së cilës janë të lidhura njëra me tjetrën dhe kanë si tematikë Kurantin e shpallur prej Zotit...”<sup>6</sup>

Sherif Ahmeti, gjatë komentimit të Kuranit, kishte përdorur edhe komentimin e Kuranit nga Sejjid Kutbi, drejtpërdrejt ose me anë të tefsireve të tjera të Kuranit, siç mund të shihet nga komentimi i ajetit 28 të sures Muhamed, ku, duke komentuar këtë ajet, rreth kuptimit të fjalës أَحْبَطَ - përmend mendimin e Sejjid Kutbit, i cili thotë: “habeta” do të thotë “fyerje”. Kafsha, që kullotë barë të keq, fryhet dhe pëlçet, shkatërrohet, kështu janë edhe veprat e kafarëve, fryhen, duken të mëdha, por në fund zhduken.”<sup>7</sup>

---

<sup>5</sup> *Kur'ani-i, përkthim me komentim*, përktheu dhe komentoi: H. Sherif Ahmeti, Prishtinë, f. 23.

<sup>6</sup> *Ibid.*, f. 658.

<sup>7</sup> *Ibid.*, f. 703-704.

## Përdorimi i haditheve në komentimin dhe interpretimin e Kuranit

Në komentimin dhe interpretimin e tij të Kuranit, ka përdorur në masë të madhe hadithet e Muhamedit a.s. Këtu ne do të përmendim vetëm disa shembuj:

- 1) Në faqen 31 të përkthimit dhe të komentimit të Kuranit, në shpjegimin hyrës të sures el-Bakare, përmendet hadithi, të cilin e shënon Muslimi në *Sahihun* e tij: *"Mos i bëni shtëpitë tuaja varreza, shejtani ik prej asaj shtëpie në të cilën lexohet kaptina Bekare!"*<sup>8</sup>
- 2) Në faqen 53 të përkthimit dhe të komentimit të Kuranit, gjatë komentimit të ajetit 116 të sures el-Bekare, ku thuhet se pasuesit e Librit (Ehlul-kitab) i atribuuan Allahut xh.sh., fëmijë, Sherif Ahmeti e përmend hadithin kudsijj, të cilin e shënon Buhariu në *Sahihun* e tij, Zoti xh.sh., ka thënë: *"Njeriu trilloi gënjeshtria dhe fyerje ndaj Meje, trilloi gënjeshtër kur tha se Unë nuk kam fuqi ta ngjallë atë, e bëri fyerje kur për Mua tha se kam fëmijë."*<sup>9</sup>
- 3) Në faqen 60 të përkthimit dhe komentimit të Kuranit, gjatë komentimit të ajetit 153 të sures el-Bekare, në të cilin njerëzit janë duke u thirrur për "sabër - durim" - durim në sprovat, përmend hadithin të cilin e shënon Ahmedi dhe Tirmidhiu, dhe thotë: *"Për sabërlinjt e kemi edhe hadithin e Pejgamberit: "Kur ndonjë prindi i vdes evladi, Allahu u thotë melekëve: a ia morët shpirtin e fëmijës së robit Tim? Ata thonë: Po. Ai thotë: A ia morët pemën e zemrës? Ata thonë, po. Ai thotë: E çka tha ai robi Im? Ata thonë: Të falënderoi dhe tha se edhe ne do të vdesim e do të shkojmë te Zoti! Ai thotë: Ndërtoni për të një shtëpi në xhenet dhe vënia emrin "Shtëpia e lavdërimit!" (Ahmedi dhe Tirmidhiu)"*<sup>10</sup>

<sup>8</sup> Kur'an-i, *përkthim me komentim, përktheu dhe komento*: H. Sherif Ahmeti, *op. cit.*, f. 31.

<sup>9</sup> *Ibid.*, f. 53.

<sup>10</sup> *Ibid.* f. 60.

4) Në faqen 136 të përkthimit dhe komentimit të Kuranit, gjatë komentimit të ajetit 41 të sures en-Nisa', përmend hadithin të cilin e shënon Buhariu nga Ibn Mesudi r.a., i cili thotë: *“Më tha Pejgamberi më lexo Kuran”. I thashë: ta lexoj ty kur ai ty të zbriti? Po, tha: Kam dëshirë të dëgjoj prej tjetrit! I lexova kaptinën en-Nisa deri te ajeti 41 kur më tha: mjaft, e kur shikova, sytë e tij derdhnin lotë”*.<sup>11</sup>

Shembuj të këtillë në interpretimin e Kuranit të Sherif Ahmetit janë me dhjeta, dhe më e rëndësishmja, të gjitha këto hadithe të njohura si të vërteta dhe të regjistruara në koleksionet autentike të hadithit.<sup>12</sup>

## Ajetet dhe suret mekase e medinase

Rreth kësaj teme kanë shkruar edhe autorë, si, *El-Mekki, El-Izud-dini* dhe të tjerët. Njohja e kësaj teme qëndron në faktin se përmes asaj kup-tohet ajo, që është shpallur më vonë nga Kurani, e që mund të jetë ajeti abrogues ose ajeti specifikues –sipas mendimit të dijetarëve, të cilët kanë qëndrim se ajo, që është shpallur më vonë është e specifikuar në krahasim me atë, që është shpallur më herët.<sup>13</sup>

Ibn Nekibi në hyrje të tefsirit të tij thotë: *“Janë katër lloje të sureve të Kuranit: mekase, medinase, suret të cilat janë zbritur në Meke dhe në Medine dhe suret të cilat nuk janë zbritur në Mekke e as në Medine.”*<sup>14</sup>

Dijetarët islam, rreth kësaj çështjeje në kuptimin terminologjik, kanë tre mendime, megjithatë, mendimi më i përhapur është se pjesët mekase të Kuranit janë ato, që janë shpallur para hixhretit, kurse medinase, ato që janë shpallur pas hixhretit, pavarësisht të shpalljes së tyre, në Meke apo në Medinë.<sup>15</sup>

<sup>11</sup> Ibid. f. 136.

<sup>12</sup> Sherif Ahmeti kishte përmendur hadithe edhe gjatë komentimit të ajeteve kuranore edhe në këto faqe të përkthimit dhe komentimit të tij të Kuranit: f. 141, f. 16, f. 351, f. 456, f. 471, etj.

<sup>13</sup> Dželaluddin es-Sujuti, *ITQAN*, vëll. 1, përktheu: Doc. Dr Almir Fatić, Sarajevë, 2012, f. 47.

<sup>14</sup> Ibid. f. 48.

<sup>15</sup> Ibid f. 49.

Suret mekase, Sherif Ahmeti i shënoi: shpallur në Mekë, ndërsa ato medinase: shpallur në Medinë. Kështu, që bëri lëshim dhe gabim, sepse kufizoi shpalljen e Kuranit vetëm në Mekë dhe Medinë, ndërkohë që realiteti historik i shpalljes së Kuranit, siç kemi përmendur, e thotë të kundërtën e kësaj.<sup>16</sup>

## Ajetet muxhmel (المجمل) dhe mubejjen (المبين) / amm (العام) dhe hass (الخاص)

“Muxhmel” është ajeti, që përmban një fjalë shumë të rëndë dhe koncize, që nuk do të ishte e mundur për ta shpjeguar po të mos ishin ajetet e tjera të Kuranit, ose ndonjëherë edhe po të mos vihej hadithi në funksionin e *mubejjenit*. Shembull: fjala هلوعا do të shpjegohet nga vetë koncepti kuranor, me fjalët جزوعا dhe منوعا.<sup>17</sup> Kështu, ajetet 19-21 të sures *el-Mearixh*, së bashku formojnë një tërësi të qartë:

• إِنَّ الْإِنْسَانَ خُلِقَ هَلُوعًا • إِذَا مَسَّهُ الشَّرُّ جَزُوعًا • وَإِذَا مَسَّهُ الْخَيْرُ مَنُوعًا •

**“Është e vërtetë se njeriu është i prirur të jetë i padurueshëm.**

**Pse kur e godet ndonjë e keqe, ai ankohet së tepërmi. Ndërkaq, kur e gjen e mira, ai bëhet tepër koprrac.”** (El-Mearixh, 19-21)

Siç e shohim nga shembulli i mësipërm, “Mubejjen” është ajeti, që shpjegon ndonjë fjalë, siç është shihet në ajetin e mësipërm me fjalët: “منوعا” dhe “جزوعا”.

Fjala “amm” do të thotë e përgjithshme, në përgjithësi dhe në tefsir paraqet ajete kuranore, të cilat përfshijnë udhëzimet e përgjithshme, udhëzimet morale, etj. Në fakt, ka ajete kuranore, që kanë të bëjnë me të gjithë njerëzit, ose në të gjithë individët, në të cilët aludohet.<sup>18</sup> Për shembull shprehjet: O, njerëz (يا ايها الناس), të gjithë كل, së bashku جميع, etj.

<sup>16</sup> Emin Behrami, Qasje studimore rreth katër përkthimeve të Kuranit në gjuhën shqipe, Prishtinë, 2007, f. 157-160.

<sup>17</sup> Enes Karić, *Uvod u tefsirske znanosti*, op. cit., f. 140.

<sup>18</sup> Enes Karić, *Kako tumačiti Kur'an*, op. cit., f. 340.

Ajetet “*hass*”u referohen thënieve të veçanta, rreth vendeve të veçanta dhe specifike në Kuran. Një shembull të ajeteve të tilla, Subhi Salih e përmend ajetin: “*Dhe prej skajit më të largët të qytetit erdhi një njeri...*” (*Jasin, 20*).

## Shkaqet e zbritjes së Kuranit - (اسباب النزول)

Një zhanër i veçantë i literaturës tefsirore të Kuranit e përbëjnë edhe veprat dhe diskutimet mbi shkaqet e zbritjes së disa ajeteve të Kuranit (اسباب النزول). Veprën e parë të njohur në këtë fushë e ka shkruar *El-Vahidiu* (vdiq në v. 1075) me titullin *Kitabu esbabin-nuzuli* (e shtypur në Kajro, në v. 1315 h.). Më vonë, thuajse pas pesë shekujve të plotë, eruditi enciklopedik, Xhelaluddin es-Sujuti, e komplettoi këtë vepër të Vahidiut dhe shkroi një vepër të re, të quajtur *Lubabun – nukuli fi esbabin-nuzuli* (e shtypur kohëve të fundit në Kajro dhe Bejrut).<sup>19</sup>

Fjala arabe *sebeb* (shumësi *esbab*) d.m.th. arsyeja, motivi, kurse *marifetu esbabin-nuzul* është njohuri e shkaqeve të Shpalljes. Pra, njohja e ngjarjeve të veçanta dhe e rrethanave në histori, që janë të lidhura me shpalljen e disa pasazheve nga Kurani.<sup>20</sup>

Kur e komentonte Kuranin, Sherif Ahmeti i kishte parasysh shkaqet e zbritjes së ajeteve dhe të sureve, e që në vazhdim do të përmendim disa shembuj nga përkthimi dhe komentimi i tij i Kuranit, e të cilat janë me dhjeta:

- 1) Në faqen 73 të përkthimit dhe të komentimit të tij të Kuranit, për ajetin 217 të sures el-Bekare, e përmend edhe *sebebin* e zbritjes së tij, dhe thotë: “Abdullah b. Xhahshi me disa shokë e sulmon një karavan të idhujtarëve dhe e mbyl udhëheqësin, kurse dy të tjerë i zë rob, por duke menduar se është dita e fundit e Xhumadel-Ahir, kurse ajo kishte qenë dita e parë e muajit të shenjtë Rexheb. Armiqtë e përgojuan Muhamedin gjoja se besimtarët e tij nuk po i

<sup>19</sup> Enes Karić, *Uvod u tefsirske znanosti*, op. cit., f. 125.

<sup>20</sup> Ibid. f. 125.

respektojnë muajt e shenjtë, gjatë të cilëve lufta ishte ndaluar. Pejgamberi u brengos për këtë rast, por kur zbriti ky ajet, Zoti u shpjegoi myslimanëve për mëkatin e tyre dhe për mëkatet e idhujtarëve, që ishin shumë më të mëdha sepse: ata nuk lejonin vizitën në Qabe, i dëbonin myslimanët nga vendlindja, e provoqe mi i tyre kundër myslimanëve për t'i larguar prej fesë islame ishte më i rrezikshmi.”<sup>21</sup>

2) Në faqen 91 të përkthimit dhe të komentimit të tij të Kuranit, Sherif Ahmeti përmend shkakun – *sebebin* e zbritjes së sures Ali Imran dhe thotë: “Sipas mendimit të mufesirinëve, shkak i shpalljes së kësaj sureje ishte rasti i një dialogu, që u zhvillua ndërmjet Muhamedit dhe ndërmjet një grupi, përfaqësues të nesarëve të Nexhranit.”<sup>22</sup>

3) Në faqen 124 të përkthimit dhe të komentimit të tij të Kuranit, Sherif Ahmeti rreth shkakut – *sebebit* të zbritjes së ajetit 181 të sures Ali Imran thotë: “Kur qe zbritur ajeti i Kuranit: ...kush i hua zon Allahut një hua të mirë..., njëfarë prijësi fetar i jehudive, Fehas Azuaru i paska thënë Ebu Bekrit: Zoti qenka i varfër pasi po kërkon hua. Ebu Bekri i mëshon grusht në fytyrë dhe i thotë: sikur të mos ishte në fuqi marrëveshja për paqe ndërmjet nesh dhe jush, kisha për ta dredhur qafën. Jehudiu shkoi te Pejgamberi dhe u ankua kundër Ebu Bekrit. Pejgamberi e pyeti për sjelljen e tij. Ebu Bekri i tregoi se çka tha ai, por jehudiu e mohoi thënien, atëherë u shpall ky ajet: Allahu dëgjoi thëniet... dhe u vërtetua drejtësia e Ebu Bekrit.”<sup>23</sup>

Shembuj të tillë mbi shkaqet e Shpalljes të shënuar në komentimin e Kuranit nga Sherif Ahmeti, janë edhe shkaqet e zbritjes së ajeteve dhe sureve të Kuranit si në vijim: En-Nisa', 101, 105; El-Maide, 43, 50; El-

<sup>21</sup> *Kur'an-i, përkthim me komentim*, përktheu dhe komentoi: H. Sherif Ahmeti, *op. cit.*, f. 73.

<sup>22</sup> *Ibid.* f. 91.

<sup>23</sup> *Ibid.* f. 124.

En'am, 19; El-En'am, 118; Et-Tevbe: 1, 75; El-Isra', 29; El-Ahzab, 35; El-Huxhurat, 6; Surja El-Mearixh, etj.

## “Shkronjat misterioze” ose “fillimet e sureve” dhe ajetet “muhkem” dhe “muteshabih”

Në fillim të disa sureve të Kuranit, menjëherë pas *bismes*, gjenden të ashtu quajtur “fillimet e sureve” apo ajo çfarë është emërtuar në orientalizmin evropian si “shkronjat misterioze”. Në fakt, në librat e tefsirit në mënyrë të barabartë bëhet fjalë për tri emërtime dhe ato janë: a) *Fillimet e sureve* (فواتح السور); b) *shkronjat, të cilat shqiptohen plotësisht* (الحروف التهجي); c) *shkronjat e ndërprera* (الحروف المقطعات).

Kuptimi i këtyre shkronjave-simboleve hutoi të gjithë mufessirët nga kohët më të hershme. Nuk ka asnjë dëshmi se Pejgamberi a.s., bënte fjalë në lidhje me këto shkronja në asnjë nga thëniet e tija, dhe as që dikush nga sahabët e tij ta kenë pyetur për ndonjë sqarim.<sup>24</sup>

Në mesin e shumë *Hyrjeve në shkencat e tefsirit*, në të cilat bëhet fjalë rreth këtyre shkronjave, mund të veçojmë *Burhanin e Zerkeshiut* dhe *Itkanin e Sujutiut*. Zerkeshiu së pari fikson numrin e sureve në fillimet e të cilave gjejmë këto harfe dhe thotë se janë gjithsej njëzet e nëntë.<sup>25</sup>

Sherif Ahmeti, në fillim të sures el-Bekare, në faqen 31 të përkthimit dhe të komentimit të tij të Kuranit, thotë: “Sikurse disa kaptina të tjera, ashtu edhe kjo kaptinë fillon me këtë lloj germash, që përkujtojnë mre-kullinë e përsosur të Kuranit. Shkronjat e tilla në fillim të kaptinave, tër-heqin vëmendjen e lexuesit ose të dëgjuesit për përmbajtjen se ç'u kumtohet nga fjalët e Zotit xh.sh. Të këtij mendimi janë dijetarët më eminentë si Ibni Kethiri, Zamahsheri, Ibni Tejmije, etj. S'ka dyshim se në shpalljen e këtyre shkronjave, fshihet urtësia e madhe e Zotit, e megjithatë disa dijetarë shfaqën mendimin se shkronjat e këtilla janë sim-

<sup>24</sup> *Poruka Kur'ana, prijevod i komentar: Muhammed Asad*, El-Kalem, Sarajevë, 2004, f. 1023-1024.

<sup>25</sup> Enes Karić, *Uvod u tefsirske znanosti*, op. cit., f. 71.

bole të emrave, si: *elifi* simbolizon emrin Allah, *lami* Xhibril dhe *mimi* Muhamed.<sup>26</sup>

Sa i përket kuptimit të fillimit të sures *Ta-ha*, Sherif Ahmeti thotë: “Dy shkronjat e para, *Ta* dhe *Ha* janë sikurse edhe të tjerat në fillim të kaptinave, që sipas mendimit të një shumice dijetarësh, janë të pashpjegueshme – muteshabih. Sipas Ibni Abasit etj., do të thotë: “O njeri!” Ka mendime se aso shkronja janë emër i Zotit, emër i Pejgamberit, emër i kaptinës, ose është: “I lumi ai që ka gjetur rrugën e drejtë”, apo është “shkele tokën o Muhamed, etj.”<sup>27</sup>

Sa i përket kategorisë së ajeteve “muhkem” dhe “muteshabih”, t’i sqarojmë shkurtimisht këto terme. Ajeti kuranor nga surja Ali Imran, 7, jep një nga ndarjet e Kuranit, që i vuri Allahu xh.sh., në ajete, të cilat janë “të qarta” (*muhkemat*) dhe “të errëta – “të pa qarta” (*muteshabihat*). Sigurisht që, nuk thuhet se cilat janë ajete të kategorisë së parë e cilat të asaj të dytë, por vetëm thuhet se ajeteve të “errëta” kuptimin e di vetëm Allahu xh.sh.. Natyrisht, këtu Zamahsheri do të na kundërshtonte, sepse ai pas fjalës Allah e lexon lidhësen “ve” në kuptim *i* ose *a*, si një *lidhëse integrale*, e jo si një *lidhëse disjunktive*.<sup>28</sup> Kështu që, varet nga përkthyesi nëse do të ndjek në përkthimin e Kuranit mendimin e Zamahsheriut apo jo. Zamahsheri thotë: “Ka nga ata, që bëjnë pauzë pas fjalës (إِلَّا اللَّهُ) dhe fillojnë me fjalët: (وَالرَّاسِخُونَ فِي الْعِلْمِ يُثَبِّتُونَ), dhe interpretojnë se kuptimin e ajeteve të errëta Allahu i lë për dijen e Tij...”. Ne e dimë se Zamahsheri ishte *mu'tezil*, kurse *mu'tezilët* besojnë se kuptimin e ajeteve *muteshabih* i dinë edhe ata, që janë thelluar në shkencë.<sup>29</sup>

<sup>26</sup> *Kur'ani-i, përkthim me komentim*, përktheu dhe komento: H. Sherif Ahmeti, *op. cit.*, f. 32. Gjithashtu, Zerkeshiu transmeton thënien e Ibni Abbasit në të cilën thuhet se secili harf është marrë nga një emër i Zotit, qoftë i Lartësuar Ai. *Elif* nga Allah, *Lam* nga Larif, *Mim* nga Mexhid. (shih: Enes Karić: *Tefsir, op. cit.*, f. 99).

<sup>27</sup> *Ibid.*, f. 428.

<sup>28</sup> Enes Karić, *Kako tumačiti Kur'an*, *op. cit.*, f. 202.

<sup>29</sup> Për më shumë shih: Enes Karić, *Kako tumačiti Kur'an*, *op. cit.*, f. 261.

Sipas Musa Shadin Lashin, në ajete *muteshabih* bëjnë pjesë edhe ajetet, që flasin për Zotin dhe atributet e Tij (صفات الله), e për të cilat do të diskutohet më vonë.

Rreth ajeteve *muhkem* dhe *muteshabih*, Sherif Ahmeti në përkthimin dhe në komentimin e tij të Kuranit, duke komentuar ajetin e shtatë të sures Ali Imran, thotë: “Në përgjithësi, ajetet e Kuranit kanë kuptim të qartë, por ka disa që kuptimi i tyre nuk është krejt i qartë, siç janë simbolet në fillim të disa kapitave, etj. Ajetet e tilla quhen muteshabih, që do të thotë: nuk është i qartë qëllimi nga se thuhet në mënyrë të përgjithshme...”<sup>30</sup> Ajetin e sipërpërmendur të sures Ali Imran, ajeti 7, Sherif Ahmeti e përktheu kështu: “*...Po, pos Allahut askush nuk e di domethënien e tyre të saktë. Dijetarët e pajisur me dituri thonë...*” (Ali Imran, 7).<sup>31</sup> Nga përkthimi i këtij ajeti, shihet se Sherif Ahmeti nuk e ka ndjekur mendimin e ez-Zamahsheriut rreth çështjes së përkthimit dhe të interpretimit të këtij ajeti.

## Ajetet abroguese (përjashtuese)

### dhe të abroguara (të përjashtuara) – (الناسخ والمنسوخ)

Çdo hyrje në shkencën e tefsirit bën fjalë për çështjen e rëndësishme të tefsirit – ajetet “nasih” dhe “mensuh”. Në fillim, duhet të theksohet se janë shumë autorë, që aktualisht refuzojnë çdo ide për ekzistimin e ajeteve të abroguara - të përjashtuara (منسوخ) dhe abroguese – përjashtuese (ناسخ) në Kuran. Në thelb të kësaj problematike qëndron ajeti 106 i sures el-Bekare:

مَا نَنْسَخْ مِنْ آيَةٍ أَوْ نُنسِهَا نَأْتِ بِخَيْرٍ مِنْهَا أَوْ مِثْلَهَا

**“Ne nuk abrogojmë (pezullojmë) asnjë nga argumentet tona, apo ta hedhim në harresë e të mos sjellim edhe më të dobishëm se ai, ose të ngjashëm me të...”** (El-Bekare, 106).

<sup>30</sup> Kur'an-i, përkthim me komentim, përktheu dhe komentoi: Sherif Ahmeti, *op. cit.*, f. 93.

<sup>31</sup> Ibid. f. 93.

Fjala *nes'h* (abrogim) është formuar nga *neseha*, që do të thotë: abrogim, përjashtim, revokim. Në kuptimin terminologjik, *nes'h* është një akt me të cilin shfuqizohet ndonjë dispozitë e shariatit me ndonjë dispozitë tjetër, i cili përmban një dispozitë në kundërshtim me rregulloren e mëparshme.<sup>32</sup>

Zerkeshiu në vëllimin e dytë të *Burhanit*, përmend edhe për abrogimin në Kuran dhe thotë se shumë klasikë për këtë kanë shkruar libra të veçantë. Ai gjithashtu pohon se imamët në tefsir kanë rënë dakord se askujt nuk i është lejuar që të komentojë Kuran pa njohjen e ajeteve abroguese dhe të abroguara. Kuptimi i vërtetë i *nes'hit* Lashini e sheh në qëllimin e Zotit për t'iu lehtësuar njerëzve.<sup>33</sup>

Sa i përket abrogimit në Kuran, studiuesit islam kanë mendime të ndryshme. Ebu Muslim el-Isfahani thotë se është shumë e vështirë, pothuajse e pamundur, për të folur për abrogimin në Kuran. Të tjerët pohojnë se abrogimi në Kuran është i mundur. Disa e teprojnë. Xhelaluddin es-Sujuti përkrahu qëndrimin e mesëm, dhe beson se në Kuran ka rreth njëzet ajete të abroguara.<sup>34</sup>

Sherif Ahmeti, në përkthimin dhe në komentimin e tij të Kuranit, thotë: “Abrogimi ose pezullimi i një dispozite me një tjetër quhet “nes'-hun”. Shumica e dijetarëve islam janë të mendimit se në Kuran ka abrogim të dispozitave, të civateve. Disa të tjerë nuk pranojnë mundësinë e pezullimit të ndonjë dispozite a teksti të Kuranit, duke pretenduar se bëhet fjalë për pezullimin e dispozitave në shpalljet e mëparshme.”<sup>35</sup>

Sherif Ahmeti ishte i mendimit se nuk kishte abrogim në Kuran. Në faqen 323 të përkthimit dhe të komentimit të Kuranit, thotë: “Shumica e dijetarëve islam janë të mendimit se pati abrogim - *nes'h* në Kuran. Disa

<sup>32</sup> Jusuf Ramić, *Tefsir – historija i metodologija*, FIN, Sarajevë, 2001, f. 37.

<sup>33</sup> Enes Karić, *Uvod u tefsirske znanosti*, op. cit., f. 145-146.

<sup>34</sup> Jusuf Ramić, *Tefsir – historija i metodologija*, op. cit., f. 37.

<sup>35</sup> *Kur'an-i, përkthim me komentim: përktheu dhe komentoj*: H. Sherif Ahmeti, op. cit., f. 52.

të tjerë, të cilët edhe unë i përkrah, janë të mendimit se nuk ka pasur as nuk duhet të jetë bërë ndonjë zëvendësim. Allahu e di më së miri!”<sup>36</sup>

## Përfundimi

Nga e gjitha e përmendur në punim, mund të përfundohet si vijon:

- Punimi në përgjithësi jep pasqyrë për kontributin e Sherif Ahmetit në fushën e komentimit të Kuranit në gjuhën shqipe, se:
- Sherif Ahmeti la pas veprimtarinë e shkruar në fushën e komentimit të Kuranit në gjuhën shqipe në revistat islame në Kosovë, siç janë: “Takvim”, “Edukata Islame” dhe “Dituria Islame”;
- Komentimi i Kuranit nga Ai ishte në frymën e nevojave të njerëzve dhe të kohës në të cilat jetoi dhe veproi;
- Përkthimi dhe komentimi i tij flat qartë që ai i studioi mirë “shkenecat kuranore”, në literaturën e tefsirit të njohur si “Ulumu-l-Kuran”. Bazaur në këtë përkthim dhe komentim të tij, mund të konkludohet që,
- Komentimi i Kuranit është nevojë e myslimanëve në të gjithë botën, se:
  - a) është një fushë dhe problematikë e rëndësishme, por edhe shumë e ndishme,
  - b) nëpërmjet komentimit të gabuar dhe jo të saktë, e vërteta dhe mesazhi kuranor shtrembërohet.
  - c) shumë njerëz, nën ndikimin e komentimeve të pakualifikuara të Kuranit, kanë devijuar nga mesazhet e vërteta të Kuranit dhe persona të tillë nuk çojnë vetëm veten e tyre, por edhe të tjerët në një përfundim katastrofik;
- Ekzistojnë kushte të paracaktuara për ata, që dëshirojnë të merren me komentimin e Kuranit, kështu që nuk mund të merret çdokush me këtë degë themelore të shkencave islame;

---

<sup>36</sup> Ibid., f. 377.

# Koncepti i Vahjit (Shpalljes) në këndvështrimin islam dhe në atë perëndimor

Prof. Ass. Dr. Valmire Batatina- Krasniqi\*

## Abstrakt

Koncepti i Vahjit është një ndër temat fundamentale në Islam, ngase në vete ngërthen themelin e njohjes së fjalës së Allahut të Madhërishëm. Në kuptimin e përgjithshëm ajo paraqet mesazhin hyjnor, që Zoti ua kumtoi të dërguarëve të Tij të përzgjedhur nga njerëzit dhe formën e këtij kumtimi. Trajtimi i kësaj tematike nga këndvështrimi tefsiror, brenda kornizës së integritetit të Kuranit fisnik dhe kuptimit të saj gjuhësor, pa dyshim që është e një rëndësie të veçantë për të vënë në pah kuptimin e vërtetë të vahjit. Koncepti i vahjit padyshim që zgjoi vëmendjen e shumë studiuesve islam dhe të tjerë dhe për të, u nxorën përkufizime, trajtime dhe qëndrime të ndryshme. Nga ky këndvështrim në këtë studim do të sillen njohuri mbi kuptimin tefsiro-kuranor të kon-

\* Prof. Ass. Dr. Valmire Batatina-Krasniqi është ligjëruese në Fakultetin e Studimeve Islame në Prishtinë në lëminë e tefsirit. Masterin e ka përfunduar në fushën e tefsirit në Institutin e Shkencave Sociale të Universitetit Uludağ në Bursa, e edhe doktoraturën e përfundoi në të njëjtin Universitet dhe në të njëjtën fushë.

*E-mail:* valosabat@hotmail.com

ceptit të vahjit, përkufizimet, përmbajta, mënyrat e shpalljes dhe qëndrimet e dijetarëve islam dhe të autorëve perëndimor.

**Fjalët kyçe:** Vahj; Islam; Kuran; Perëndimor; Tefsir.

## Abstract

The concept of Wahy is among the fundamental topics in Islam because it encompasses the foundation of the knowledge of the Word of the Glorious Allah. In its general sense, it represents the divine message that God communicated to His chosen messengers from among humans and the form of this communication. The treatment of this topic from the perspective of Tafsir, within the framework of the integrity of the Noble Quran and its linguistic meaning, is undoubtedly of particular importance in highlighting the true meaning of Wahy. The concept of Wahy has undoubtedly drawn the attention of many Islamic scholars and others, leading to various definitions, treatments, and perspectives regarding it. From this viewpoint, this study will provide insights into the Tafsir-Quranic understanding of the concept of Wahy, including the definitions, content, methods of revelation, and the stances of Islamic scholars and Western authors concerning it.

**Keywords:** Wahy; Islam; Quran; Western; Tafsir.

## Hyrje

Zoti i madhërisëm krijoi njeriun nga një përzierje e bashkëdyzuar dhe e vendosi në tokë. E ngriti në një vend të lartë në mesin e të gjitha krijesave, duke e dalluar me mendje/logjikë. Më pas, me urtësinë dhe mëshirën e Tij, për t'i informuar për urdhrat dhe ndalesat e Tij, u dërgoi peygamberë (resulë apo nebijë). Këto porosi të dërguara përmes peygamberëve në literaturën islame janë të njohura me nocionin “vahj”.

Vahj, që do të thotë të informosh fshehurazi ose shpejt, të flasësh, të frymëzosh, të aludosh, të tregosh etj., e që sipas mësimëve kuranore, tradita e shpalljes së saj në forma të ndryshme, nisi me Ademin a.s (qenia e parë njerëzore, gjithashtu peygamberi i parë, që mori shpalljen), dhe vazhdoi deri te zbritja e Kuranit të shenjtë, Muhamedit a.s.. Me këtë akt të zbritjes së Kuranit të shenjtë, përfundoi aktiviteti i dërgimit të “vahjit” që ndryshoi rrjedhën e historisë. Andaj në mesin e temave të ndërlidhura me Kuranin, më e rëndësishmja është tema e shpalljes hyjnore. Pasi të qartësohen e të shqyrtohen temat e këtilla, nuk ka dyshim se të kuptuarit e mësimëve Kuranore do të jetë një proces shumë më i lehtë dhe më i saktë.

Nisur nga kjo, në këtë studim është përfshirë analiza semantike e konceptit të vahjit/shpalljes. Më pas, është bërë një vlerësim në lidhje me kuptimin e vahjit në aspektin e përgjithshëm. Pastaj është shqyrtuar edhe roli dhe përmbajtja e shpalljes dhe është qartësuar qasja e dijetarëve islam dhe e autorëve perëndimor për të.

### 1. Nocioni “Vahj”

Në gjuhën arabe shprehja “vahj” është përdorur në trajta dhe në kuptime të ndryshme. Përderisa dijetari el-Halil b. Ahmed (v.175/791) mendon se fjala “vahj” në trajtën e foljes “vaha” në gjuhën arabe përdoret në kuptim të “shkrimit”,<sup>1</sup> Ibn Durejd (v.321/933) thekson se kjo shprehje nënkupton mesazhin e Zotit, i cili realizohet në dy forma, përmes lajmit

---

<sup>1</sup> El-Halil b. Ahmed, *Kitabu'l-Ajn*, Daru'l-Kutubi'l-Ilmije, Bejrut, 2003, v. 4, f. 354.

dhe të frymëzimit.<sup>2</sup> Ibn Farisi (v.395/1004) në librin e tij thekson se ky nocion në trajten “vaha” përmban kuptimin e fjalës së fshehtë apo të shprehjes në mënyrë të fshehur. Bazuar në këtë kuptim, fjala “vahj” paraqet një “trajtesë apo lajm”.<sup>3</sup> Ndërsa el-Xhevheri (v. 400/1009) thekson se shprehja “vahj” në kuptimin e përgjithshëm leksikor mund të jetë “shkrim, trajtesë, lajm, dhe fjalë e fshehtë.” Arabët, kur duan të shprehin të folurit e një individi me një tjetër individ në mënyrë të fshehtë, formë të cilën nuk mund ta kuptojnë të tjerët, e përdorin pikërisht fjalën “vahj” dhe thonë: “i bëri vahj”, pra ia përcolli porosinë në një mënyrë, që nuk e kupton kush.<sup>4</sup> Mukatil b. Sulejman (v.150/767) në trajtimin e kësaj shprehjeje sqaron se “vahj” mund të ketë kuptimin e “zbritjes së relevatës te Pejgamberi a.s. përmes Xhibrilit, frymëzimit shpirtor, trajtesës, urdhëresave dhe fjalëve.”<sup>5</sup> Gjuhëtari i shquar Ragib el-Isfahani (V/XI), lidhur me kuptimin leksikor të shprehjes “vahj” sqaron se është emër, që përdoret për një “porosi, që përcillet shpejt dhe duke bërë shenjë.”<sup>6</sup> Në këtë kontekst, lehtë mund të thuhet se shpallja është “mesazh/njohuri, i transmetuar shpejt dhe fshehurazi”.

## 2. Kuptimi i “vahjit” në Kuran

Kur kihet parasysh kuptimi i konceptit të vahjit në Kuranin fisnik, vëhet në pah fakti se ai nënkupton mesazhin apo njohurinë, që Zoti i Madhërishëm përcolli te krijesat e Tij. Në ajete të ndryshme kuranore përmendet se Zoti i dërgoi vahj qiellit,<sup>7</sup> njeriut,<sup>8</sup> bletës<sup>9</sup> dhe tokës.<sup>10</sup> Sipas

<sup>2</sup> Ebu Bekr Muhammed b. Husejn Ibn Durejd, *Xhemheratu'l-Luga*, Daru'l-Ilmi'l Melajin, Bejrut, 1987, v. 1, f. 231.

<sup>3</sup> Ibn Faris, *Mekajisu'l-Luga*, Daru'l-Fikr, Bejrut, 1979, v. 6, f. 93.

<sup>4</sup> El-Xhevheri, *Taxhu'l-Luga ve Sihahu'l-Arabijje*, Daru'l-Ilmi'l-Melajin, Kahire, 1956, v. 6, f. 2519-2520.

<sup>5</sup> Mukatil b. Sulejman, *el-Vuxhuh ve'n-Nedhair*, Merkezu Xhuma el-Maxhid li'thThekafe ve't-Turath, Dubai, 2006, f. 177-178.

<sup>6</sup> Er-Ragib el-Isfahani, *el-Mufredat fi Garibi'l-Kur'an*, Daru'l-Marife, Bejrut, 1984, f. 515-516.

<sup>7</sup> Fussilet, 12.

dijetarit të shquar ed-Damegani (v. 478/1085) shprehja vahj në Kuran përmban këto kuptime:<sup>11</sup>

a. *Shpallja hyjnore, që u zbritet pejgamberëve* - Ky lloj i shpalljes është i veçantë vetëm për pejgamberët. U jepet nga Zoti i Madhërishëm vetëm atyre, që i ka përzgjedhur Ai, siç shihet në ajetin vijues:

إِنَّا أَوْحَيْنَا إِلَيْكَ كَمَا أَوْحَيْنَا إِلَى نُوحٍ وَالنَّبِيِّنَ مِنْ بَعْدِهِ

*“Ne të kemi shpallur ty sikurse i patëm shpallur Nuhut dhe pejgamberëve pas tij.”* (Nisa, 4/163) Në këtë kuptim, fjala *vahj* është përdorur në Kuran rreth shtatëdhjetë herë.

b. *Frymëzim në zemër* - Çdo njeri, në jetën e tij ndien frymëzime, burimi i të cilave është i panjohur për të, por që jo rrallë herë e ndihmojnë në tejkalimin e sfidave apo në vendimmarrje. Këto frymëzime, të cilat janë të veçanta për njeriun, janë tejet të rëndësishme dhe bëhen një dritë udhëzimi, që e shpëtojnë nga vështërsitë e jetës. Fjala *vahj* është përdorur për t’i emërtuar edhe këto frymëzime, që i vijnë në ndihmë njeriut. Edhe nënës së profetit Musa a.s, përderisa ishte në një çast pavendosmërie të madhe, Zoti i dërgoi një frymëzim në zemër, me të cilin do të shpëtonte jetën foshnjës së saj. Këtë fenomen, Kurani e ka quajtur gjithashtu *vahj*, siç përmendet në ajetin vijues:

وَأَوْحَيْنَا إِلَىٰ أُمِّ مُوسَىٰ أَنْ أَرْضِعِيهِ ۖ فَإِذَا خِفْتِ عَلَيْهِ فَأَلْقِيهِ فِي الْيَمِّ وَلَا تَخَافِي  
وَلَا تَحْزَنِي ۗ إِنَّا رَأَوْنَاهُ إِذْ نَكَحَتْ لَهَا لَمَّا رَأَتْهُ وَجَاعِلُوهُ مِنَ الْمُرْسَلِينَ

*“Ne e frymëzuam nënën e Musait: t’i japë atij gjë, e kur të kesh frikë për të, atëherë hidhe atë në lumë, e mos u frikëso, as mos u pikëllo, se Ne do ta kthejmë ty, atë dhe do ta bëjmë atë nga të dërguarit.”*<sup>12</sup>

<sup>8</sup> Kasas, 7.

<sup>9</sup> Nahl, 68.

<sup>10</sup> Zilzal, 5.

<sup>11</sup> Husejn b. Muhammed Damegani, *El-Vuxhuh ve’n-Nedhair*, Daru’l-Ilmi’l-Melajin, Beirut, 2010, f. 287.

<sup>12</sup> Kasas, 7.

Përkundër këtij frymëzimi, që ka për funksion udhëzimin e individit për veprime të mira, djalli përdor pikërisht frymëzimin, për t'i larguar njerëzit nga rruga e drejtë dhe për t'i çuar drejt mëkatit. Për këto tundime djallëzore, Kurani e ka përdorur pikërisht fjalën vahj ku thuhet:

وَإِنَّ الشَّيْطَانَ لِيَؤُخِّنَ إِلَىٰ أَوْلِيَآئِهِمْ لِيُجَدِّلُوهُمْ ۗ

**“Djallëzitë i nxisin (frymëzonin) miqtë e vet, që t’ju polemizojnë juve.”<sup>13</sup>**

c. *Shenjë e fshehtë* – të folur me shenja. Në këtë kontekst është përdorur në ajetin vijues:

فَخَرَجَ عَلَىٰ قَوْمِهِ مِنَ الْمِحْرَابِ فَأَوْحَىٰ إِلَيْهِمْ أَنْ سَبِّحُوا بُكْرَةً وَعَشِيًّا

**“Dhe ai doli prej faltores para popullit të vet dhe iu dha shenjë adhuronit (Allahun) mëngjes e mbrëmje.” (Merjem, 19/11)**

d. *Udhëzim intuitiv-instinktiv* - nënkupton udhëzimin natyror, të cilin e posedon çdo krijesë, qoftë njëri, bimë apo kafshë, madje edhe krijesat jo të gjalla, përmes të cilës, ato e sigurojnë vazhdimësinë e tyre. Ky lloj udhëzimi në Kurandin fisnik përmendet si vahj:

وَأَوْحَىٰ رَبُّكَ إِلَى النَّحْلِ أَنْ اتَّخِذِي مِنَ الْجِبَالِ بُيُوتًا وَمِنَ الشَّجَرِ وَمِمَّا يَعْرِشُونَ

**“Zoti yt i dha instinkt bletës: “Ndërto shtëpi nëpër kodra (male), nëpër drunj (pemë) dhe nëpër kulmet, që ata (njerëzit) i ndërtojnë.”<sup>14</sup>**

e. *Urdhër, fjalë* - Me këtë nënkuptohet urdhëri, që Zoti i Madhërisëm u jep krijesave të Tij. Në këtë kontekst në ajetin vijues thuhet:

وَأَوْحَىٰ فِي كُلِّ سَمَاءٍ أَمْرَهَا

**“Dhe secilit qiell i caktoi (urdhëroi) atë që i nevojitej.”<sup>15</sup>**

<sup>13</sup> En’am, 121.

<sup>14</sup> Nahl, 68.

<sup>15</sup> Fussilet, 12.

يَوْمَئِذٍ تُحَدِّثُ أَخْبَارَهَا بِأَنَّ رَبَّكَ أَوْحَىٰ لَهَا

*“Atë ditë ajo i rrëfen tregimet e veta, ngase Zoti yt e ka urdhëruar atë.”<sup>16</sup>*

Ashtu siç përmendëm edhe më lartë, shprehja vahj në Kuran përmëban dhe është përdorur në trajta dhe kuptime të ndryshme. Nga e gjithë kjo nënkuptohet se jo gjithësecili ka aftësinë për ta pranuar shpalljen hyjnore. Nga njerëzit, janë peygamberët, ata të cilët, me dëshirën dhe vullnetin e Zotit, duke poseduar përsosuritë potenciale të tyre dhe duke i përforcuar ato, kanë ardhur në një pozitë të tillë të pranimit të shpalljes. Ndërsa Zurkani në përkufizimin e vahjit shprehet se ajo është përcjellje e udhëzimeve dhe e urdhrave të Zotit xh.sh tek robërit e Tij, përmes peygamberëve (të përzgjedhurve të Tij) në një formë të shpejtë dhe të fshehur, ashtu siç ata nuk janë mësuar me të.<sup>17</sup> Të gjithë të frymëzuarit e kuptojnë, se është udhëzim prej Zotit. Prandaj, në zbatimin e detyrës me të cilën udhëzohen, nuk shprehin kurrfarë luhatshmërie, por të vendosur e zbatojnë. Fjala vjen, Ibrahim deshi të therrte të birin e tij. Nëna e Musait e hodhi Musanë kur ishte foshnje në lumë, Musai i ra me shkop detit dhe u fut në të, etj. Kur është fjala për frymëzimin e gjallesave të tjera, si të bletës, etj., aty ka të bëjë me një lloj instinkti të tyre, e kur është fjala për gjërat e ngurta, si toka, qielli etj., atëherë vahji ka të bëjë me gjendjen e tyre.

### 3. Përmbajtja e Vahjit

Kur flitet për vahjin në mendimin islam, pa dyshim që në rradhë të parë hyn Kurani Fisnik. Sipas mësimeve kuranore, i dërguari i parë i Zotit është vetë njeriu i parë, Ademi a.s. Më vonë, Zoti i Madhërisëm u shpalli urdhrat dhe ndalesat e tij, Nuhut a.s. dhe peygamberëve të tjerë,

<sup>16</sup> Zelzeleh, 4-5.

<sup>17</sup> Muhammed, Ez-Zurkani, *Menahilu'l-Irfan fi Ulumi'l-Kur'an*, Daru Ihjai Kutubi'l-Arabi, Kajro, 1980, v. 1, f. 63.

dhe në fund, Ai i dërgoi shpallje edhe Muhamedit a.s., duke e plotësuar kështu misionin e peygamberisë. Për këtë çështje në Kuran thuhet:

مَا كَانَ مُحَمَّدٌ أَبَا أَحَدٍ مِّن رِّجَالِكُمْ وَلَكِن رَّسُولَ اللَّهِ وَخَاتَمَ النَّبِيِّينَ وَكَانَ اللَّهُ بِكُلِّ شَيْءٍ عَلِيمًا

***“Muhamedi nuk ka qenë babai i asnjërit prej burrave tuaj, por ai ishte i Dërguari i Allahut dhe vulë e të gjithë peygamberëve, e Allahu është i Gjithëdijshtëm për çdo send.”***<sup>18</sup>

Në Kuranin fisnik, të dhënat për natyrën dhe cilësinë e shpalljeve të dërguara peygamberëve të kaluar janë më të pakta. Megjithatë, gjejmë njohuri të hollësishme rreth shpalljes së fundit, atë të peygamberit Muhamded a.s. Aty përmendet se shpallja e fundit, Kurani, është i ruajtur dhe gjendet në pllakën e njohur me emrin “Leuhi Mahfudh: “Ai është Kuran i famshëm. Në një pllakë të ruajtur mirë (në Levhi Mahfudh).”<sup>19</sup> se është i dërguar nga Zoti dhe se do të ruhet nga Ai: “Ne me madhërinë Tonë e shpallëm Kuranin dhe Ne gjithsesi jemi mbrojtës të tij.”<sup>20</sup> i zbritur përmes engjëllit Xhibril: “S’ka dyshim, se ai (Kurani) është thënie e të dërguarit fisnik (që e pranoi prej Zotit), që është i fortë dhe që ka vend të lartë te Zoti i Arshit, që është i respektuar atje (në mesin e engjëjve) dhe besnik!”<sup>21</sup> tek i dërguari i fundit, vula e të gjithë peygamberëve, Muhammedi a.s.: “Ty ta zbritëm Kuranin, që t’u shpjegosh njerëzve atë që iu është shpallur atyre, me shpresë se do ta studiojnë (Kuranin).”<sup>22</sup> etj.

Vahji, nisi me njeriun e parë, Ademin a.s. Pastaj, vazhdoi të përcillej te peygamberët e Zotit, duke iu përshtatur shekujve, niveleve të njerëzve dhe nevojave sociale e kulturore të kohës. Nëse nuk do të ishin këto nevoja të ndryshme përgjatë historisë njerëzore, programi, i cili gjendej tek Ademi a.s., do të vazhdonte deri në Kiamet. Kështu që zbriti Kurani, i

<sup>18</sup> El Ahzabë, 40

<sup>19</sup> Buruxhë, 21-22.

<sup>20</sup> Hixhr, 9.

<sup>21</sup> Tekvir, 19-21.

<sup>22</sup> Nahl, 44.

cili konsiderohet si shpallja e fundit dhe më e plotë, që Allahu i ka dhënë njerëzimit. Ai konfirmoi, plotësoi dhe korrigjoi shpalljet e mëparshme, duke përfshirë Teuratin, Zeburin dhe Inxhilin. Ritorcoi mesazhin bazë të këtyre shpalljeve, që është besimi në një Zot të vetëm, udhëzimi moral dhe shpëtimi. Ai konsiderohet si një shpallje e paprekur dhe autentike, që rikthen mesazhin origjinal të shpalljeve të mëparshme dhe është udhëzim për të gjithë njerëzit dhe për të gjitha kohët. Ndërsa shpalljet e mëparshme ishin të kufizuara në popuj dhe në periudha të caktuara. Pra, Kurani përfshin mësimet dhe udhëzime, që mbulojnë të gjitha aspektet e jetës njerëzore, përfshirë ato shpirtërore, morale, sociale dhe ligjore. Ai shërben si një përmbledhje e plotë dhe përfundimtare e udhëzimeve hyjnore.

#### 4. Mënyrat e vahjit te Pejgamberët

Siç bën të ditur Kurani, Zoti i Madhërishëm i drejtohet pejgamberëve të Tij në tre forma: me shpallje të drejtpërdrejt, pas perdes (shpallja zanore) dhe nëpërmjet engjëllit. Lidhur me këtë çështje thuhet:

وَمَا كَانَ لِمَشْرِ أَنْ يُكَلِّمَهُ اللَّهُ إِلَّا وَحْيًا أَوْ مِنْ وَرَائِي حِجَابٍ أَوْ يُرْسِلَ رَسُولًا  
فِيُوحِي بِإِذْنِهِ مَا يَشَاءُ إِنَّهُ عَلِيمٌ حَكِيمٌ

*“Nuk ka asnjë njeri që t’i ketë folur Allahu ndryshe, vetëm se me anë të frymëzimit, ose pas ndonjë perdeje, ose t’i dërgojë të dërguar (melek), e ai t’i shpallë me lejen e Tij atë, që do Ai. Vërtet, Ai është më i Larti, më i Urti.”<sup>23</sup>*

Gjatë interpretimit të ajetit në fjalë, Imam Maturidiu (v. 333/944)<sup>24</sup> thekson se shpallja e drejtpërdrejt ka për qëllim frymëzimin apo ëndërrën. Vahji i ardhur në formën e frymëzimit të fjalës së Zotit xh.sh në zemrën e pejgamberit, ka qenë forma më e vështirë e ardhjes së vahjit. Dhe kjo përmendet në transmetime, ndër to: *“Shpirti i Shenjtë (Ruhu’l-Kudus)*

<sup>23</sup> Shura, 51.

<sup>24</sup> Maturidi, *Te’vilatu Ehli’s-Sunne*, Daru’l-Marife, Beirut, 1971, v. 4, f. 417.

fryen në zemrën time.”<sup>25</sup> Po ashtu në një hadith të transmetuar nga Aishja r.a.thuhet: “Vahji i ardhur të Dërguarit të Allahut pati filluar me ëndrra besnike, që i pati parë në gjumë. Çdo ëndërr, që shihte, i vërtetohej në mënyrë të njëjtë si drita e mëngjesit.”<sup>26</sup> Shpallja pas perdes nënkupton shpalljen, që e dëgjon vetëm peygamberi në formë të drejtpërdrejt nëpërmjet një zëri dhe askush tjetër, natyrën e të cilit e di vetëm Zoti. Kjo është forma, në të cilën foli Zoti i Madhërishëm me peygamberin Musa a.s., në mal dhe me Muhamedin a.s., gjatë miraxhit. Në Kuran thuhet: “*Musait i foli Allahu me fjalë.*”<sup>27</sup> Dhe mënyra e tretë e shpalljes së përmendur në ajet nënkupton shpalljen nëpërmjet engjëllit, i cili u përcjell peygamberëve porositë e lartësuara, që i pranon nga Zoti i Madhërishëm. Në lidhje me këtë në Kuran thuhet:

وَإِنَّهُ لَتَنْزِيلُ رَبِّ الْعَالَمِينَ نَزَلَ بِهِ الرُّوحُ الْأَمِينُ عَلَى قَلْبِكَ لِتَكُونَ مِنَ الْمُنذِرِينَ

**“E edhe ai (Kurani) është shpallje (zbritje) e Zotit të botëve. Atë e solli shpirti besnik (Xhibrili), (e solli) në zemrën tënde për të qenë ti prej atyre, që tërheqin vërejtjen.”**<sup>28</sup>

## Koncepti i vahjit në Islam dhe tek disa autorë perëndimor

Në mendimin islam dhe në shkollat akaidologjike, të cilat janë bazë e këtij sistemi me argumente racionale/akl dhe të transmetuara /nakl, shihet se koncepti i vahjit nuk është shqyrtuar në atë shkallë sa është folur në burimet klasike të tefsirit dhe nuk ka njohuri shpjeguese rreth natyrës së saj. Dijetarët islam e përceptuan atë si një burim njohurish dhe e rradhiten në kontekstin e atributit të të folurit të Zotit xh.sh. Pavarësisht

<sup>25</sup> Sujuti, *el-Itkan fi Ulumi'l-Kur'an*, Daru'l-Kutubi'l-Ilmije, Bejrut, 1971, f. 70.

<sup>26</sup> Buhari, *Sahih'l-Buhari*, v. I, no: 3.

<sup>27</sup> Nisa, 164.

<sup>28</sup> Shuaraë, 192-194.

se cilit drejtim akaidologjik i përkisnin, të gjithë pohuan ekzistencën e vahjit, që nënkupton procesin e përcjelljes së porosive të Zotit te njerëzit. Në këtë kuptim, vahji pranohet jo vetëm në teori, por edhe në botë-kuptimin ekzistencial.<sup>29</sup> Ndoshta kjo është arsyeja, që dijetarët kelamist nuk shfaqën shumë divergjenca rreth shpalljes dhe çështja u vlerësua dhe u trajtua në fushën e shkencës së tefsirit.

### a. Vahji në këndvështrimin islam

Dijetarët selef,<sup>30</sup> të cilët pas vdekjes së Pejgamberit a.s. deklaruan se ishin pasues të sahabëve dhe të tabiinëve dhe pranuan parimet e përcaktuara në Kuran, pa i interpretuar ato, ndryshe nga shkollat e tjera akaidologjike, nuk sjellin një mendim të detajuar mbi vahjin, duke u mjaftuar vetëm me kuptimin e jashtëm të ajeteve dhe duke e trajtuar atë, mbi konceptin e të folurit të Zotit.<sup>31</sup> Sipas tyre, Allahu është folës. Ai ishte folës edhe para se të krijohet çdo krijesë edhe para se të kishte dikush, që fliste. Edhe kur të gjithë folësit të zhduken, Ai do të vazhdojë të jetë. Vetë cilësia e të folurit është një atribut i Vetëvetes së Tij.<sup>32</sup> Fakti, që Zoti i foli Musait a.s. pa ndonjë ndërmjetës, pas perdes, tregon se cilësia e fjalës së Tij është e lidhur drejtpërdrejt me Esencën e Tij.<sup>33</sup>

Dy përfaqësues të mëdhenj të Ehli-Sunnetit Esh'ariu dhe Maturidiu, gjithashtu shqyrtojnë çështjen e vahjit në kontekstin e atributit dhe debatit rreth krijimit të Kuranit. Sipas tyre cilësitë e Zotit të Madhërisëm janë të përjetshme. Në këtë rradhë hyn edhe të folurit e Zotit si një atribut i Tij. Duke sjellë argumente nga vetë Kurani dhe argumente të tjera

---

<sup>29</sup> Maturidi, vepër e citur, v. 7, f. 123; v. 8, f. 142-143; Er-Razi, Fahrud-din, *Mefatihul-Gajb*, Daru'l-Fikr, Bejrut, 1981, v. 3, f. 508; v. 19, f. 481; Zemahsheri, *Keshshaf*, Mektebu'l-Ubejkan, Riad, 1998, v. 1, f. 582.

<sup>30</sup> Ibn Kudame, Muvaffakuddin, Lumatu'l-Itikad, Stamboll, 1993, f. 13.

<sup>31</sup> Abdullah b. Muslim ed-Dineveri, *Te'vilu Muhtelifu'l-Hadith*, Bejrut, Daru'l-Fikr, 1976, f. 3-7.

<sup>32</sup> Othman b. Seid Darimi, *er-Red ale'l-Xhehmijje*, Skenderijje, 1971, f. 324.

<sup>33</sup> Muhamed Tahanevi, *Keshshafu Istilahatı Funun*, Daru'l-Kutubu'l-Ilmijje, Bejrut, 1998, v. 2, f. 159.

racionale, ata argumentuan edhe faktin se Kurani nuk është i krijuar, por është fjalë e Allahut dhe atribut i përjetshëm i Tij.<sup>34</sup> Imam Maturidiu, duke vënë në pah kuptimet etimologjike të vahjit të përmendur në Kur'an, sjell dhe strukturën e tij teologjik. Ai po ashtu thekson se vahji, i cili i erdhi nënës së Musait a.s. apo edhe Merjemes, mund të jetë i njëjtë me vahjin, që i është shpallur pejgamberëve. Megjithatë, sipas tij, marrja e këtij lloji të vahjit nuk nënkupton se ato janë të dërguara të Zotit të Madhërishëm. Ngase është e mundur, që ato ta kenë marrë këtë lloj vahji pa u dërguar në detyrë me misionin e të dërguarit. Me këto shpjegime, Maturidiu shprehet se ekziston një komunikim/vahj, që mund të quhet frymëzim/ilham ose ndonjë formë tjetër, në mes të Zotit dhe njeriut, pa ndërmjetësimin e ndonjë pejgamberi. Megjithatë, duke mos vënë në diskutim vlerën epistemologjike të frymëzimit, vë në pah faktin se frymëzimi/ ilham nuk mund të jetë burim i njohurive për të gjithë.<sup>35</sup>

Prandaj, në këtë kontekst, vahji që i ngarkon njeriut detyrën e të qenët profet, quhet vahji i pejgamberisë. Në këtë kuptim, pa dyshim që vahji, që i është shpallur Muhamedit a.s është Kurani Fisnik dhe sheriat, që i është dhënë bashkë me të. Po ashtu edhe pejgamberëve para tij përveç librave i janë dhënë lajmërimet dhe shariat.<sup>36</sup> Në lidhje me këtë në Kur'anin Fisnik thuhet:

وَالَّذِينَ يُؤْمِنُونَ بِمَا أُنزِلَ إِلَيْكَ وَمَا أُنزِلَ مِنْ قَبْلِكَ وَبِالْآخِرَةِ هُمْ يُوقِنُونَ

*“Dhe ata, të cilët besojnë në atë që t’u është zbritur ty, dhe në atë që është zbritur para teje dhe që janë të bindur plotësisht për botën tjetër.”<sup>37</sup>*

Nga e gjithë kjo shihet se imam Maturidiu, shpalljen, që i zbriti Muhamedit a.s. nuk kufizon vetëm me Kur'anin Fisnik. Madje edhe pse gjatë interpretimit të ajeteve kuranore bën ndarjen e saj në “shpallje metlu”

<sup>34</sup> Razi, vepër e cituar, v. 27, f. 188.

<sup>35</sup> Maturidi, vepër e cituar, v. 1, f. 32.

<sup>36</sup> Po aty.

<sup>37</sup> El Bekare, 4.

dhe “gajri metlu” ai shpreh se vahji i zbritur Muhamedit a.s është tre lloje:<sup>38</sup> a) Kurani, i cili i zbriti atij në formë të dukshme. b) Bejani/sqarimi, i cili përcakton, sqaron njerëzve të drejtat e peygamberëve, të drejtat e Zotit xh.sh ndaj tyre dhe të drejtat e tyre ndaj njëri-tjetrit nëpërmjet fjalëve të Xhibrilit ose “në një mënyrë tjetër që dëshiron Ai”. c) Frymëzimi (ilham) dhe kuptimi vahjit (ifham). Në këtë kontekst në Kuran thuhet:

إِنَّا أَنْزَلْنَا إِلَيْكَ الْكِتَابَ بِالْحَقِّ لِتَحْكُمَ بَيْنَ النَّاسِ بِمَا أَرَاكَ اللَّهُ

*“Ne të zbritëm ty librin me plot të vërteta, që të gjykosh mes njerëzve me atë që të mësoi Allahu.”<sup>39</sup>*

Mufesiri er-Razi (v.606/1210) në lidhje me vahjin potencon se nuk ka dyshim, që burimi i vahjit, kushtimisht dërguesi i saj është Zoti i Madhërishëm. Këtë e dëshmojnë dhe shumë ajete kuranore, ku Ai ia atribon Vetës burimin<sup>40</sup> dhe aktin e dërgimit<sup>41</sup> të saj. Pas daljes nga burimi, adresimi i parë i vahjit janë peygamberët. Peygamberët gjithashtu, duke qenë të dërguar, nuk janë pika përfundimtare e shpalljes, por janë kumtues të saj tek njerëzit. Megjithatë, duke qenë se peygamberët dhe njerëzit, të cilëve u përcillet/adresohet shpallja janë në të njëjtin nivel, bazuar në dallimet e tyre ontologjike, mund të thuhet se peygamberët janë në pikën e fundit të rrjedhjes vertikale të vahjit. Kurse në vijën horizontale të saj, ata janë në pikën fillestare të rrjedhës horizontale. Transmetimi i vahjit nga Zoti i Madhërishëm te peygamberi i Tij, bëhet përmes engjëllit Xhibril.<sup>42</sup> Me fjalë të tjera, Zoti i Plotëfuqishëm bart dhe përcjell porositë/librat e Tij tek të dërguarit përmes engjëjve. Mirëpo siç mund të kemi vahj

<sup>38</sup> Maturidi, vepër e cituar, v. 13, f. 251.

<sup>39</sup> En-Nisa, 105.

<sup>40</sup> Gafir, 15; Muzzemmil, 5.

<sup>41</sup> Nisa, 163; Junus, 2; Jusuf, 3; Shura, 3, 7, 13.

<sup>42</sup> Fahrudin er-Razi, vepër e cituar, v. 28, f. 282.

nëpërmjet engjëllit Xhibril, mund të kemi dhe vahj në mënyrë të drejt-përdrejt (kumtim në zemrën e peygamberit).<sup>43</sup>

Dijetarët e shkollës Mute'zile<sup>44</sup> po ashtu shprehin ekzistencën e procesit të vahjit, duke e sqaruar në një këndvështrim më ndryshe nga vija e ehl-i sunnetit. Sipas tyre, vahji është i krijuar si nga ana kuptimore (mana) po ashtu dhe tekstore (lafdh). Zoti i Madhërishëm krijoi fjalën në pllakën e ashtuquajtur Leuh-i Mahfudh dhe nga aty përmes melekut Xhibril, i cili e transmeton nga kujtesa e tij, i është përcjellë të dërguarve. Vahji i tillë i është shpallur Muhamedit dhe të gjithë peygamberëve të tjerë. Vahji i transmetuar te peygamberi për nga aspekti tekstor edhe pse ndryshon nga fjala, të cilën e ka krijuar Zoti, përsëri mbetet si fjalë e Tij.<sup>45</sup> Zemahsheri (v. 538/1144) në interpretimin e ajetit kuranor: **“Nuk ka asnjë njeri që t’i ketë folur Allahu ndryshe, vetëm se me anë të frymëzimit, ose pas ndonjë perdeje, ose t’i dërgojë të dërguar (melek), e ai t’i shpallë me lejen e Tij atë që do Ai.**<sup>46</sup> thekson se nuk i drejtohet Zoti i Madhërishëm njeriut, përveç se në tri forma: e para, me anë të frymëzimit- që mund të jetë ngulitja fjalësore në zemër apo gjatë gjumit, ashtu siç ishte frymëzuar nëna e Musait apo Ibrahim a.s. për flijimin e të birit; e dyta, pas ndonjë perdeje-që realizohet me anë të dëgjimit të zërit pa e parë Folësin, ashtu siç kishte ndodhur me Musain a.s.; e treta: me dërgimin e një të dërguari, i cili i kumton mesazhin e Zotit te peygamberi.<sup>47</sup>

<sup>43</sup> Fahrudin Razi, vepër e cituar v. 19, f. 220; Në interpretimin e ajetit 192-194 të kaptinës Shuara, Razi ashtu e thekson faktin se mund të kemi dhe shpallje direkte pa ndërmjetësimin e engjëllit Xhibril. Shiko: Razi, vepër e cituar, v. 24, f. 195.

<sup>44</sup> Fraksion, i cili fillimin e tij e ka kah përfundimi i sundimit Emevij, ndërsa lulëzimi i këtij grupimi mer hov në sundimin Abasit. Baza e tyre në kuptimin e akides ka qenë thjesht, logjika, duke u ndikuar nga filozofia greke dhe indiane, të cilat e shenjtërojnë logjikën. Pra janë një prej fraksioneve-drejtimeve islame, që në komentimin e shumë çështjeve akaidologjike i dhanë prioritet mendjes, duke e lënë Shpalljen (Vahjin) në plan të dytë. Ky ishte shkaku kryesor, që çoi deri te devijimi i tyre, duke u larguar nga akideja e ehl-i Sunnetit.

<sup>45</sup> Kadi Abdulxhebbar, el-Mugni fi Ebvabi’t-Tevhid ve’l-Adl, Kajro, 1965, v. 7, f. 79.

<sup>46</sup> Shura, 51.

<sup>47</sup> Zemahsheri, vepër e cituar, v. 5, f. 420-421.

Ndërsa te shiitët<sup>48</sup> vahji është një proces i komunikimit në mes të Zotit dhe të dërguarve të Tij. Në aspektin ekzistencial-shkencor, ky komunikim mund të realizohet edhe me imamët e denjë, ngase ata janë përfaqësuesit e pejgamberëve dhe njerëz të pa gabuar. Por, dallimi i vetëm në mes të vahjit, i cili u shpallet pejgamberëve dhe imamëve, është për faktin se pejgamberët marrin vahjin nga engjëlli, duke dëgjuar dhe shikuar atë, ndërsa imamët vetëm, duke dëgjuar. Ëndrrat e imamëve po ashtu janë të vërteta sikurse ato të pejgamberëve, sepse Zoti i Madhërisëm imamët i ka ruajtur nga ëndrrat e liga dhe të turbullta.<sup>49</sup>

Në traditën sufiste, vahji është një fenomen, që humb veçoritë e tij si eksternaliteti, objektiviteti dhe verbaliteti, duke u shndërruar kështu në një proces, në të cilin gjallërohen të gjitha fuqitë shpirtërore të njeriut. Në këtë traditë, vahji nuk është i pavarur nga burimi i jashtëm dhe ai gojor/verbal. Pra, vahji/ilhami, (frymëzimi) i cili përfshin një pasqyrim të një fuqie të fshehur potencialisht në vetën e njeriut, është një proces, i cili gjendet në zemrën e njeriut dhe shfaqet tërësisht në natyrën e tij.<sup>50</sup> Ibnu'l-Arabi (v.638/1240) në lidhje me vahjin thekson se ajo ngjason me dritën, që përshkon errësirën dhe ndriçon botën dhe është tre llojesh: vahji i shfaqur në zemër, dëgjimor dhe vizual. Ai, këtë proces e përshkruan, duke vënë në pah faktin, se vahji fillimisht shfaqet në zemër, pastaj vazhdon të përhapet drejt shqisave të njeriut. Shkalla e dytë e vahjit është ajo e dëgjimit, e cila tërheq vëmendjen, duke rritur kështu edhe me shumë ndikimin e tij përtej shqisave të dëgjimit drejt atyre të pamurit/vizuale. Dhe pejgamberët në këtë mënyrë mund të shohin ata, të cilët u sjellin vahjin.<sup>51</sup> Në lidhje me këtë në Kuran thuhet:

---

<sup>48</sup> Grup i devijuar, i cili origjinën e ka në ndarjen e hershme në lidhje me pasuesin e Muhamedit a.s. dhe udhëheqësin pas tij. Për shiitët, udhëheqësi i tyre i parë, duhet të jetë Aliu.

<sup>49</sup> Muhammed b. Jakub Kulejni, *Usuli'l-Kafi*, Tehran, Daru'l-Kitabi'l-Islamijje, 1383, v. 1, f. 27; Tusi, Ebu Xhafer Muhammed b. Husejn, *et-Tibjan fi Tefsiri'l-Kur'an*, Nexhef, 1957, v. 6, f. 320.

<sup>50</sup> el-Muhasibi, Haris, *Risaletu'l-Mustershidin*, Siri, 1988, f. 78.

<sup>51</sup> Gazali, *Tehafetu'l Felasife*, Klasik, Stamboll, 2005, f. 40.

فَأَوْحَىٰ إِلَىٰ عَبْدِهِ مَا أَوْحَىٰ مَا كَذَبَ الْفُؤَادُ مَا رَأَىٰ

**“Dhe i shpalli robit të Tij atë që ia shpalli. Zemra nuk mohoi atë që pa”.**<sup>52</sup>

Vahji te filozofët myslimanë si Farabiu (v.339/950), në një formë të detyrueshme si pasojë e filozofisë së tij, trajtohet në fushën e dijës dhe në atë të filozofisë politike. Ndërsa, te mendimet e Ibn Sinas (v.428/1037) çështja e vahjit shqyrtohet në aspektin e mbrojtjes kundër tezave, që inkurajojnë mohimin e peygamberisë, duke sjellë argumente logjike, ajete kuranore dhe hadithe profetike. Për të dy mendimtarët, doktrina e vahjit përbëhet nga tre elemente themelore: intelekti i veprueshëm, shpirti njerëzor dhe aftësia e imagjinatës. Lidhja midis këtyre tre elementeve sjell në pah njëkohësisht dijen e peygamberit, që mori shpalljen dhe përmbajtjen e mesazhit të dhënë nga Zoti Fuqiplotë.<sup>53</sup>

Divergjencat në mes të filozofëve islam rrjedhin nga përpjekja e shqyrtimit të konceptit të vahjit në traditën islame përmes një këndvështrimi racionalist siç është shembulli i Farabiut dhe Ibn Sinas, ndërsa qëndrimet të cilat janë në kundërshti me traditën islame rreth mënyrës së shpalljes së vahjit dhe rolin e peygamberit a.s., kryesisht janë pikëpamjet e mendimtarëve myslimanë si Fazlurrahman (1919-1988) dhe Nasr Hamid Ebu Zejd (1943-2010). Në këtë kontekst, imam Gazaliu (v.505/1111), i mbështetur në argumente sheriatike hodhi poshtë ontologjinë ose metafizikën rationale të zhvilluar nga filozofë si Farabi dhe Ibn Sina, duke pohuar se burimi ose subjekti i vahjit nuk është intelekti aktiv siç pretenojnë filozofët, por është vetë Zoti i Lartësuar.<sup>54</sup>

<sup>52</sup> Nexhm, 10-11.

<sup>53</sup> Farabi, *Ideal Devlet (el-Medinetu'l-Fazile)*, përktheu në Turqisht: Ahmet Arslan, Ankara: Vadi, 1997, f. 88; Ibn Sina, *Avicenna's De Anima*, New York : Oxford University Press, 1970, f. 235.

<sup>54</sup> Gazali, *Tehafetu'l Felasife*, Klasik, Stamboll, 2005, f. 40.

## b. Vahji në Këndvështrimin e autorëve perëndimorë

Aq sa ishte temë shqyrtimi në mesin e shkollave islame dhe të komentatorëve të ndryshëm të Kuranit, çështja e vahjit ishte po aq edhe temë diskutimi në teologjinë perëndimore. Edhe pse në fetë Ibrahimike<sup>55</sup> bëhen diskutime të ndryshme rreth kësaj çështjeje, një pikë e përbashkët në të gjitha është pranimi i tij si fenomen themelor i pamohueshëm dhe parësor.<sup>56</sup>

Në traditën e mendimtarëve perëndimorë ndër përkufizimet e shumta, që i bëhen vahjit, më gjithëpërfshirës është ai, se vahji nënkupton njohurinë, që Zoti ia transmeton njeriut në lidhje me Vetën e Tij apo iraden/vullnetin e Tij<sup>57</sup>, ose shpjegimi dhe komunikimi i hyjnore të njeriut.<sup>58</sup> Sa i përket probabilitetit të ndodhjes së procesit të vahjit, ata, duke sjellë argumente logjike në lidhje me të, njëkohësisht vënë në pah ekzistencën e Zotit. Sepse të gjitha argumentet, që flasin për ekzistencën e një Zotit, që është i Drejtë, i Gjithëfuqishëm dhe ruan rendin në botë, njëkohësisht mund të konsiderohen si argumente, që prania e Tij të krijesat realizohet përmes vahjit. Me fjalë të tjera, sipas tyre, ashtu siç është e mundur të ekzistojë Zoti, ashtu është e mundur, që ky Zot të dërgojë edhe vahjin. Prandaj çështja e vahjit nuk mund të trajtohet ndryshe, përveçse në kuadër të ekzistencës së Zotit, pra të një besimi teist.<sup>59</sup> Megjithatë, jo të gjithë janë të pajtimit për ekzistencën e vahjit. Te përfaqësuesit e doktrinës së deizmit<sup>60</sup> dhe panteizmit<sup>61</sup> nuk ka vend për konceptin e vahjit.

---

<sup>55</sup> Islam, Judaizëm, Krishterizëm.

<sup>56</sup> Watt, Montgomery, *Islamic Revelation in the Modern World*: Oxford University Press, New York 1995, f. 24.

<sup>57</sup> Shusterman, Abraham, "Revelation", *The Universal Jewish Encyclopedia* (ed. Isaac Landman), New York, 1969, v. 9, f. 147.

<sup>58</sup> Edwin Lewis, "Revelation", *Harper's Bible Dictionary*, New York: 1973, f. 613.

<sup>59</sup> Gabriel Moran, *Theology of Revelation*, London, 1966, f. 102.

<sup>60</sup> Deizëm ose Deizmi është doktrinë filozofike, që Zotin e konsideron krijuesin e parë të botës, por që pranon se, pas krijimit, bota zhvillohet sipas ligjeve të veta.

<sup>61</sup> Panteizëm është doktrinë, që njëjtëson hyjnoren me gjithësinë dhe dukuritë e saj.

Nisur nga këto njohuri në teologjinë perëndimore ekzsitojnë dy koncepte të vahjit. Njëri prej tyre është “modeli i përqendruar në urdhra” me të cilin nënkuptohet Zoti, që komunikon disa të vërteta në formë të porosive dhe të urdhrave. E dyta, koncepti i kuptuar si Zoti, i cili shfaq “vetveten” në hyjninë e Isës. Ky mund të njihet edhe si “modeli i vahjit në njeri/personal”.<sup>62</sup> Montgomery Wat thekson se në vitet e fundit, një nga trendet kryesore të mendimit perëndimor është se vahji është një veprimtari e Zotit. Në procesin e vahjit, Zoti paraqet dhe shfaq veten e Tij. Ndërsa dijetarët islam nuk janë thelluar për të diskutuar një mënyrë të këtillë të vahjit, ngase në traditën islame koncepti i vahjit është i qartë dhe aspak i panjohur. Sipas mësimave islame, Zoti i shpalli vahjin dhe dërgoi Muhamedin peygamber te populli i Mekës, ashtu siç kishte dërguar peygamberë te popujt e mëhershëm. Po ashtu ai thekson se me kalimin e kohës, detyra e Muhamedit u zgjerua jashtë funksionit të një thirrësi si nikoqir dhe peygamber i Zotit, duke u detyruar të menaxhojë punët e myslimanëve. Prandaj, nisur nga këtu, sipas Montgomery Wat, roli i Muhamedit dhe veprimtaria e tij mund të konsiderohet si veprimtari e Zotit. Prandaj, mendimi modern për konceptin e vahjit në perëndim është i ngjashëm me konceptin islam për vahjin.<sup>63</sup>

Pretendimi i Watit në lidhje me vahjin nuk mund të jetë qëndrim i saktë, ngase në këndvështrimin islam vahji/Kurani është fjalë e Zotit xh.sh e pastër nga çdo e metë, pa asnjë kundërshti. Sa i përket konceptit të vahjit në të cilin Zoti shfaq vetën, që përmend Wati, libri i cili është dokumenti historik i ngjarjes së paraqitjes (mishërimit) të Zotit te Isa është historik dhe nuk është i pastër nga gabimet.

Nisur nga këto njohuri, vahji në Islam i referohet porosive dhe procesit e dërgimit të këtyre porosive nga Zoti te peygamberët e Tij. Kuptimi i dytë i tij është rezultati i njohurive të njerëzve rreth Zotit, peygamberëve dhe çështjeve të tjera hyjnore. Sipas William Muir (1819-1905) në Is-

---

<sup>62</sup> Smith, *The Meaning and End of Religion, A New Approach to the Religious Traditions of Mankind*, The Macmillan Company, New York, 1963, f. 173.

<sup>63</sup> Watt, *vepër e cituar*, f. 25-26.

lam, Kurani është elementi bazë i politikës, shkencës, moralit dhe i të gjitha çështjeve fetare. Në këndvështrimin historik të gjithë peygamberët kanë marrë porositë hyjnore nga Zoti Krijues, thelbi i të cilit është i njëjtë, por vetëm disa çështje praktike kanë pësuar ndryshim.<sup>64</sup>

## Përfundim

Në mendimin islam vahji nënkupton komunikimin, që Zoti i Madhërishtëm zhvillon me robërit e Tij, apo fenomenin e përcjelljes së porositve të Zotit, që ndërlidhen me përparimin njerëzor në tokë në periudha të caktuara të historisë. Nisur nga kjo, vahji, natyrën e të cilit e di më së miri Zoti i Lartësuar mund të përkufizohet si komunikim ndërmejet Zotit dhe peygamberëve të Tij.

Në Kuranin Fisnik, Zoti i Madhërishtëm përmend mënyrat e këtij komunikimi si vahj i drejtpërdrejt dhe përmes engjëllit Xhibril. Njashtu theksohet që në fenomenin e vahjit, roli i peygamberit është tejet i rëndësishëm, ngase ai është kanali mes qenies njerëzore dhe Zotit Krijues. Peygamberi merr shpalljen/vahjin nga Zoti dhe pastaj e transmeton atë te njerëzit. Ky vahj mund të jetë në formë të udhëzimeve, urdhrave, ose mesazheve të tjera, të cilat njerëzit duhet t'i ndjekin për të arritur qëllimin e Krijimit të tyre, pra njohjen e Zotit Krijues dhe të urdhrave të Tij.

Vlen të theksohet se është e mundur që edhe disa njerëz përveç peygamberëve të frymëzohen/ të marrin ilham. Megjithatë, do të ishte e pasaktë ta konsideronim këtë si vahj. Ngase vahji është një fenomen i veçantë për peygamberët. Gjithashtu është e mundur, që edhe peygamberët të frymëzohen/ të marrin ilham. Por frymëzimi, që u vjen atyre, është i llojit të vahjit. Ashtu siç ka një ndryshim të madh midis ëndrrës së parë nga një person i zakonshëm dhe ëndrrës së parë nga peygamberi (Sadik Ru'ja) në aspektin e shprehjes së njohurive të sakta, ka gjithashtu një

---

<sup>64</sup> Muhammed Mustafa el-Azami, *The History of the Quranic Text From Revelation to Compilation: A Comparative Study with The Old and New Testaments*, Leicester, UK Islamic Academy, 2003, f. 41.

ndryshim midis frymëzimit, që i vjen peygamberit dhe frymëzimit, që u shfaqet njerëzve të rëndomtë. Pretendimi se njerëzit e zakonshëm mund të marrin vahj, do të thotë se disa njerëz, që e pranojnë veten si peygamberë në jetën shoqërore dhe e bëjnë veten të njohur si të tillë, hapin derën e keqpërdorimit të ndjenjave fetare të besimtarëve, ngase misioni i shpalljes dhe i peygamberisë ka përfunduar me vulën e të gjithë peygamberëve, Muhamedin a.s.

Duke qenë se në literaturën islame, tema e vahjit është shqyrtuar kryesisht nga fusha e tefsirit, është vlerësuar si një temë e shkencës së tefsirit. Tefsirologët e trajtuan këtë temë në kontekst të diskutimeve mbi cilësinë e Fjalës së Zotit dhe të çështjeve mbi Kuranin. Kurse, shkollat sufiste dhe shiite kanë përkufizuar vahjin në këndvështrimin e ilhamit. Në literaturën perëndimore shohim se vahji nuk është një koncept edhe aq i qartë, ngase e gjithë kjo ndërlidhet me pozitën e peygamberit në procesin e vahjit. Përderisa në islam, peygamberi është vetëm bartës i porosive të Zotit të Lartësuar te njerëzit, në qëndrimet e autorëve perëndimor shohim se ai fillimisht ishte peygamber, më vonë u shndërrua në bir të Zotit apo fjala e Tij, madje madje përvetësoi hyjninë dhe kështu ishte vetë vahji. Për të kuptuar vahjin në mënyrë më të drejtë, është e rëndësishme që ky fenomen metafizik të trajtohet në përgjithësi brenda fushës së Fjalës së Zotit të Lartësuar dhe të kuptohet në kontekstin e cilësive të Fjalës dhe Krijimit të Tij.

# Metodologjia e shkrimit të hadithit në librin El Athar të Imam Muhamed Ibën El Hasan Esh Shejbanit

---

Dr. Muhamed Stublla\*

## Abstrakt

Kemi përzgjedhur të paraqesim këtë studim, për librin El Athar të Imam Muhamed Ibën El Hasanit, sepse është nevojë jetike njohja e literaturës së shekujve të parë të Islamit. Njohja e burimeve shkencore të hadithit, e veçanërisht burimet, të cilat kryesisht trajtojnë temat e jurisprudencës islame. Figura e Imam Muhamed Ibën El Hasanit është dashur të jetë shumë e njohur, megjithatë, kam përmbledhur biografinë e tij, pasi që mendimet e tyre dhe trashëgimia e transmetimeve, që sjellin në literaturën e tyre, është e pazëvendësueshme. Ky studim është autorial, është rezultat i leximit dhe i analizës së secilit transmetim, andaj, kemi paraqitur transmetimet nga Muhamedi a.s., sahabët dhe tabiinët. Studimi përfshin numrin e kapitujve, temat e tyre, transmetimet

---

\* Autori Dr. Muhamed Stublla ka mbaruar studimet master në Universitetin El Islamie El Alemie në fushën e hadithit dhe në tjetrin master në fushën e fikhut hanefi po në të njëjtin Universitet. Kurse doktoratën në University of Jordan në fushën e Hadithit. Është profesor në Medresenë e Mesme Alauddin në Prishtinë.

*E-mail:* stubllamuhamed20@gmail.com

dhe atribuimi i tyre nga autorët e atyre transmetimeve, pastaj i kemi krahasuar mes vete. Vlen të theksohet, se, kemi përcaktuar disa nga kriteret, që autori i librit kishte në konsideratë gjatë shkrimit të transmetimeve. Studimi përfundon me disa rezultate.

**Fjalët kyçe:** Pejgamberi a.s.; transmetime; sahabët; tabiinët; Imam Muhamedi.

## Abstract

We have chosen to present this study on the book Al-Athar by Imam Muhammad Ibn Al-Hasan Al-Shaybani due to the vital need to understand the literature of the early centuries of Islam, particularly the scholarly sources of hadith that primarily address topics of Islamic jurisprudence. The figure of Imam Muhammad Ibn Al-Hasan should be well-known; however, I have compiled his biography as his thoughts and the heritage of the transmissions they bring to their literature are irreplaceable. This study is original, resulting from the reading and analysis of each transmission. Therefore, we have presented transmissions from Muhammad (Peace be upon him), the Companions, and the Followers. This study includes the number of chapters, their topics, the transmissions, and their attribution to the authors of those transmissions. We have also compared them with each other. It is worth noting that we have specified some of the criteria the author of the book considered while writing the transmissions. This study concludes with several results.

**Keywords:** Prophet Muhammad (pbup); transmissions; Companions; Followers; Imam Muhammad.

### **Rëndësia e studimit të kësaj teme shfaqet përmes këtyre njohurive:**

Njohja me librin dhe autorin e tij, veçanërisht pasi që autori është dijetar, literatura e të cilit është pranë nesh dhe ky libër është një nga librat e parë të hadithit;

Kuptimi i metodologjisë së autorit në këtë libër, kështu përfitimi bëhet më i lehtë;

si dhe:

Njohja e kushteve apo e kriterëve në libër, të përfituara nga studimi i librit.

## **Rezume për autorin dhe përshkrim për librin El Athar**

Analizat e veprave të dijetarëve, që ishin afër kohës së Pejgamberit a.s., janë me rëndësi të pazëvendësueshme, andaj, kronologjia studiuuese e temave të kësaj natyre, determinon që fillimisht të sjellim një rezume të shkurtër për autorin dhe veprën, e cila është objekt studimi.

### **1.1. Jeta dhe veprimtaria e Imam Muhamed Ibën El Hasan Esh Shejbanit**

Emri i Dijetarit të mirënjohur, autorit të librit El Athar është: Muhamed Ibën El Hasan Ibën Ferkad Esh Shejbani.<sup>1</sup> Familja Esh Shejbani, është me prejardhje të pastër arabe.<sup>2</sup> Vendlindja e Muhamed Ibën El Hasan Esh Shejbanit është Vasiti.<sup>3</sup> Ka lindur në fund të vitit (131 h.) ose në fillim të vitit (132 h.), dhe ka vdekur (189 h.).<sup>4</sup> Numri i madh i mësuesve

<sup>1</sup> Ibën Ebi Hatim, Abdurrahman Er Rrazi, *El Xherh ve Et Tadil*, Dar Ihja Et Turath El Arabij, Bejrut, 1952, v. 7, f. 227.

<sup>2</sup> Muhamed Ibën Zehid, El Kevtherij, *Bulug El Amani fi Sirat El Imam Muhame Ibën El Hasan Esh Shejbani*, (Egjipt: El Mektebetu El Ezherjuetu Li Turath) f. 4.

<sup>3</sup> Muhamed Ibën El Hasan Esh Shejbani, *El Athar*, recensor: Ebu El Vefa El Afgani, (Bejrut: Dar El Kutub El Ilmije 'kopje nga botimi i Indis nga Lexhnetu Ihja El Mearif En Numanije Bihajdar Abad Ed Deken') 1/27.

<sup>4</sup> Ahmed Ibën Alij El Hatib Bagdadi, *Terih Bagdad*, reconsult: Beshar Avad Maruf, Dar El Garb El Ilsamij, Bejrut, 2002, v. 2, f. 561.

dhe i nxënësve të tij është treguesi më i mirë për nivelin e tij të lartë me dituri.

**Mësuesit e Imam Muhamed Ibën El Hasanit:** Ai ka mësuar te një numër i madh i dijetarëve të njohur në trashëgiminë islame. Prej tyre veçojmë: Imam El Adhamin, Ebu Hanife En Nuëmani; i cili ishte mësuesi më i njohur i tij, fuqia shkencore e të cilit ndikoi, që ai të jetë dijetari më me ndikim te Imam Muhamedi, Jakup Ibën Ibrahim i njohur si: El Kadi Ebu Jusuf, i cili ishte mësuesi i dytë i Imam Muhamedit, Imam Malik Ibën Enesi, te i cili mësoi tri vite e disa muaj, dhe si rezultat i kësaj, ai është ndër transmetuesit më të njohur të librit të Imam Malikut, El Muvasat, Miësar Ibën Kedami, Sufjan Eth Thevriju, Abdullah Ibën Mubarak, etj.<sup>5</sup>

Ndër nxënësit e dijetarit, Muhamed Ibën El Hasanit veçojmë: Nxënësi më i njohur i tij është: Muhamed Ibën Idris Esh Shafiju - Imam Shafiu-, i cili nuk e kishte vlerësuar e lavdëruar askënd më shumë sesa Imam Muhamedin, Esed Ibën Furat, Isa Ibën Eban, Muhamed Ibën Es Semaë, Ebu Hafs El Kebir, Ibën Meiini, Ibën Mukatil,<sup>6</sup> etj.

**Shkrimet e Imam Muhamed Ibën El Hasan Esh Shejbanit:** Shkrimet e Imam Muhamedit janë të shumta dhe tepër të rëndësishme. Dijetarët, librat e tij i kanë ndarë në këto kategori:

1. Librat, dhahir er rrvaje ose muëtemedeh (bazike dhe të qarta, saktësia e të cilave është e pa diskutuar), të cilat janë shkruar dhe transmetuar në prezencën e shumë dijetarëve. Këto janë librat bazë përmes së cilave janë transmetuar qëndrimet e tre imamëve qëndror të medhhebit hanefi, me zinxhir transmetimi mutevatir, transmetuar përmes grupeve të dijetarëve, saktësia e të cilave nuk kontestohet, këto libra janë: El Asel, quhet edhe El Mebsut, është botuar shumë herë, së fundi, në Bejrut nga shtëpia botuese Ibën

<sup>5</sup> Ibën Ebi Hatim, *El Xherh ve Et Tadil*, v. 7, f. 227, si dhe Ibën Haxheri, *Lisan El Mizan*, recenoi: Deiratu El Muarrif En Nidhamije, Muesestu El Ealemij li El Matbuat, Bejrut, 1971, v. 5, f. 121.

<sup>6</sup> El Hatib Bagdadi, *Terih Bagdad*, v. 2, f. 561.

Hazem. El Xhamia Es Sagir, Bejrut, botoi Shtëpia Botuese Alim El Kutub. El Xhamia El Kebir, Egjipt, botoi Qendra, Tabatu El Emir. Es Sijer El Kebir, Bejrut, Shtëpia Botuese El Kutub El Ilmije.<sup>7</sup> Ez Zijadat ose Sherh li Ez Zijadat, Bejrut, Shtëpia Botuese El Alim El Kutub, 2013. Emrat e librave të tij i gjen edhe te libri: Isad El Mufti Ala Sherh Ukud Rresm El Mufti,<sup>8</sup> i dijetarit të mirënjohur, Ibën Abidini.

2. Librat gajr dhahir err rrivaje ose En Nevadir (jo bazike apo të pa shfaqura, saktësia e të cilave është e diskutuar): këta libra nuk transmetohen përmes rrugëve mutevatir apo meshhur, saktësia transmetuese e të cilave nuk është sikurse e grupit të parë. Ndër këto libra mund të potencojmë: El Harunijat, El Xhurxhenijat, Err Rrukijat,<sup>9</sup> El Iktisab fi Err Rizk El Mustetab,<sup>10</sup> El Kejsanijat,<sup>11</sup> El Amali,<sup>12</sup> Nevadir Sijam,<sup>13</sup> etj.

- Kurse librat, të cilat trajtohen si libra të hadithit, dhe të cilat mendojmë se duhet trajtuar sikurse të njohurat apo të paktën në mes Dhahir Er Rrivajeh apo El Mutevatir dhe En Nevadir ose El Ehad, janë: El Muvata e Imam Malikut, të cilën e transmeton Imam Muhamedi, ndër botimet e këtij libri është botimi në Bejrut, Shtëpia Botuese El Mektebetu El Ilmije; dhe Damask, Dar El Kalem etj. El Athar, e cila u botua disa herë, p.sh.: Bejrut, botoi Dar El Kutub El Ilmije. El Huxheh Ala Ehl El Medineh, Bejrut,

<sup>7</sup> Në literaturë përmendet, Es Sijer El Kebir dhe Es Sagir, por pas analizës rezulton se është i njëjti libër.

<sup>8</sup> Ibën Abidin, Muhamed Emin Ibën Omer Ed Dimeshkij El Hanefij, *Isad El Mufti Ala Sherh Ukud Rresm El Mufti*, recensoi: Prof. Dr. Sallah Ebu El Haxh, Dar El Beshar El Islamije, Bejrut, 2018, f. 314.

<sup>9</sup> Shih referencën paraprake, i përmend Ibën Abidin, por nuk e di që janë të botuara.

<sup>10</sup> Suhejl Zekar, Recensues dhe botuar në Damask nga Abdulhadi Hurasani, 1400 h. dhe botuar, Dar Kutub El Ilmije, Bejrut, 2018.

<sup>11</sup> Ibën Haxher, *El Athar bi Marefeti Ruvah*, recensoi: Kesravij Hasan, Dar El Kutub El Ilmije, Bejrut, 1993, f. 27.

<sup>12</sup> E ka botuar një pjesë të saj, Daira El Mearif El Uthmanije në Indi, 1360 h.

<sup>13</sup> E përmend Ibën Haxheri në El Athar bi Marifetu Ruvah, f. 27.

botoi, Alim El Kutub, e në të cilin libër gjinden 1264 transmetime.

- **Veprimtaria e Muhamed Ibën El Hasanit:** Në trashëgiminë kryesore të veprimtarisë së bujshme të dijetarit të mirënjohur Muhamed Ibën El Hasanit, janë veprat e tij të shkruara. Imam Muhamedi, pos që ishte nxënës i zellshëm, ishte edhe mësues i dalluar, dhe shumë bindës. Dijetari i mirënjohur, Muhamed Ibën El Hasani, ishte emëruar gjykatës i qytetit të Err Rrikas, nga e cila pozitë u lirua, për t'u emëruar më pastaj gjykatës i gjykatësve apo kryetar i gjykatës në Kalifatin Islam, në të cilën pozitë edhe vdes.<sup>14</sup> Halifi, Harun Err Rrashidi, së bashku me Muhamed Ibën El Hasanin ishin në një vizitë në qytetin Err Rrajit. Aty vdes dhe varroset Kryetari i Gjykatës, dijetari i mirënjohur, Muhamed Ibën El Hasani. Me atë rast, Kalifi Harun Err Rrashidi kishte thënë: E varrosa fikhun në Err Rraji.<sup>15</sup>

## 1.2. Përshkrim i librit El Athar

El Athar, në aspektin gjuhësor do të thotë: gjurmë, mbetje apo shenjat e gjërave paraprake,<sup>16</sup> që nënkupton, transmetimet e Muhamed Ibën El Hasanit nga mësuesit apo të paraardhësve të tij. Në aspektin terminologjik të Hadithit, shumica e dijetarëve Islam me shprehjen El Athar kanë synuar atë, që synohet me fjalën Hadith, e që është kuptuar sinonim i Hadithit. Ibën Haxheri r.a., ka thënë: Transmetimet nga Muhamedi a.s. dhe sahabet quhen El Athar.<sup>17</sup> Përdorimi i termit El Athar në konotacion të Hadithit, e dëshmon materia e librave të dijetarëve të Hadithit, si p.sh.: Sherh Mushkil El Athar i Dijetarit, Juristit e Hadithologut, Ebu

<sup>14</sup> El Hatib, *Terih Bagdat*, v. 2, f. 561.

<sup>15</sup> El Hatib, *Terih Bagdat*, v. 2, f. 561.

<sup>16</sup> Ahmed Er Rrazi, Ibën Faris, *Muxhmel El Lugah*, recensoi: Zuhejr Abdul Hasen Sulltan Muesesetu Er Rusaleh, Bejrut, 1986, v. 1, f. 86.

<sup>17</sup> Ibën Haxher, Ebu El Fadel, Ahmed Ibën Alij, *En Nuket Ala Kitab Ibën Sallah*, recensoi: Rabia Ibën El Hadi, Imadetu El Bahth El Ilmij BilXhamiatu El Islamiye, Arabia Saudite 1998, v. 1, f. 513.

Xhafer Et Tahavit, në të cilin libër përfshihen hadithet nga Pejgamberi a.s., Merfuaë dhe sahabët, Mevkufeh, por nuk përjashtohen as Maktua-tet, tekste nga tabiinët. Dëshmi konkrete se shprehja El Athar, nuk përkufizon një kategori të caktuar të transmetimeve, por përfshin të gjitha llojet e tyre, është libri për të cilin po flasim. Nga kjo, nuk tentojmë të përjashtojmë debatin apo mendimin e dijetarëve të Horasanit, të cilët transmetimet nga sahabët i kanë quajtur me shprehjen El Athar. Nëse kanë thënë, ka ardhur në El Athar, qëllimi i tyre është nga sahabët, e jo nga Pejgamberi a.s..<sup>18</sup>

**Libri El Athar**, autor i të cilit është dijetari i mirënjohur, Muhamed Ibën El Hasani, gjenden hadithe nga Pejgamberi a.s., sahabët dhe nxënësit e tyre, tabiinët. Sipas hulumtimit tonë, nuk gjejmë ndonjë mendim, që ky libër të jetë quajtur me emërtime të tjera.

Libri, El Athar, është i ndarë në njëzetegjashtë (26) kapituj, el kutub, të cilët përmbajnë treqindegjashtë (306) tema, el ebvab. Në numërimin tonë, numri i transmetimeve është nëntëqindetëdhjetedy (982). Autori, Imam Muhamed Ibën El Hasani, materien e librit e trajton si vijon: Kapitujt përbëjnë shumë tema, p.sh.: Kapitulli i namazit përbëhet prej dyzetegjashtë (46) tema, el ebvab, ndër ato, p.sh.: “Mevakit Es Salah”<sup>19</sup> Kohët e namazit. Pas përshkrimit të temës, sjell transmetimet nga hadithet, që burojnë nga Pejgamberi a.s., sahabët apo edhe tabiinët. Mirëpo, kjo nuk është ndonjë renditje e sistemuar. Mund që të vijnë vetëm transmetime nga sahabët, apo vetëm nga tabiinët-nxënësit e tyre. Jo rrallë herë, në një temë gjejmë vetëm transmetime nga sahabët apo nga tabiinët, por edhe kombinime të tjera.

Muhamed Ibën El Hasani, pas transmetimev, tregon mendimin e Imam El Eadhamit, Ebu Hanife En Nuëmanit, por ndonjëherë edhe të dijetarëve të tjerë. Dijetari, Muhamed Ibën El Hasani, përgjithësisht pa-

<sup>18</sup> Uthman Ibën Abdurrahman Ibën Sallah, *Martifetu Envaë Ulum El Hadith*, recensoi: Dr. Nuridin Iter, (Siri, Dar El Fiker dhe Bejrut, Dar El Fiker, 1976), v. 1, f. 46. Ky libër është i njohur me emërin: *Mukadimetu Ibën Es Sallah*.

<sup>19</sup> Muhamed ibën El Hasen Esh Shejbani, *El Athar*, v. 1, f. 136.

son mendimin e dijetarëve të që janë cekur më lart. Mirëpo, duke qenë dijetar i kalibrit të ngjashëm, jo rrallëherë shfaq qëndrimin e vet, i cili nuk dakordohet me qëndrimet e tyre. Edhe pse ndonjëherë, pajtimi apo kundërshtimi i qëndrimeve në mes tyre është i pjesshëm. Dijetari i shquar, Muhamed Ibë El Hasani r.a., shpjegon kuptimin e fjalëve, shprehjeve, por edhe të transmetimeve. Përmes komenteve paraqet normat juridike të përfituara nga transmetimet. Ky libër është shumë i pasur, prandaj është botuar disa herë, recensurat më të njohura janë nga: Halid El Avad, botuar nga “Vakfijetu El Muzejnij...”, Kuvajt, 2011. Dhe nga Prof. e Dr. Ahmed Isë El Misraviju, botuar nga “Dar Es Selam...”, Egjipt, 2012. Ne në këtë punim u jemi referuar botimit të fundit.

## Njohja e metodologjisë së librit

Studiues të shumtë të kohës sonë, analizojnë apo studiojnë metodologjitë e autorëve të shekujve të parë të Islamit. Këto studime bëhen edhe më të veçanta kur bëhet fjalë për autorët dhe themeluesit e shkencave përkatëse. Andaj, metodologjinë e librit do ta ndajmë në tri pjesë:

### 2.1. Hadithet, që transmetohen nga Muhamedi a.s., në librin El Athar

Me hadithet, që i atribuohen Muhamedit a.s., synohet çdo fjalë, veç për, pëlqim apo cilësi, që i dedikohet Muhamedit a.s., pavarësisht formës dhe saktësisë së tyre. Ndryshe, hadithet, që i atribuohen Muhamedit a.s., quhen Merfuatëh. Për të vërtetuar saktësinë e këtyre atribimeve, duhet të kalohen edhe shumë filtrat të studimit, të përcaktuara nga shkenca e hadithit.<sup>20</sup>

Prej njëzetegjastë (26) kapitujve –el kutub-, në njëzetekatër kemi hadithe merfuaë, dy (2) prej tyre nuk e kanë asnjë hadith merfuaë.

---

<sup>20</sup> Ibën Es Sallah, Uthman Ibën Abdurrahman, *Mearifetu Envaë Ulum El Hadith*, nijfet si ‘Mukadimetu Ibën Es Sallah’, recensoi: Nuridin Itër, Dar El Fiker El Asir dhe Siri, Dar El Fiker, Bejrut, 1986, v. 1, f. 45.

Transmetimet që i atribuohen Pejgamberit a.s, janë të shpërndara në njëqindedy (102) tema -el ebvab-. Thënë ndyshe, vetëm në 1/3 ose rreth 33% e temave gjejmë hadithe merfuaë. Nga kjo kuptojmë se në dyqindekatër (204) tema -el ebvab-, nuk gjendet asnjë hadith merfuaë, respektivisht në 2/3 ose 67 % e temave.

Numri i haditheve merfuaë arrinë në njëqindedyzetegjashtë (146) hadithe. Ndër këto hadithe merfuaë, që vijnë nga Muhamedi a.s., gjashtëdhjetë (60) janë murselate -të thënit e tabiiut ka thënë Pejgamberi a.s....,- dhe katër belagate -thënia e autorit apo ndonjë dijetari: ‘na është ardhur neve’ nga filani...-, tetëdhjetedy (82) prej tyre transmetohen me varg të transmetimi nga Pejgamberi a.s.. Sahabët që transmetuan më së shumti hadithe nga Pejgamberi a.s., në librin El Athar, janë: 1. Ajshia r.a. -bashkëshortja e Pejgamberit a.s.- 10 hadithe, 2. Omer Ibën El Hatabi 7 hadithe, 3. Abdullah Ibën Omeri 7 hadithe, etj. Gjithsej në këtë libër kanë transmetuar dyzetetre sahabi (43) nga Muhamedi a.s.. Ndërsa murselatet dhe belagatet transmetohen nga njëzeteshtatë (27) tabiinj. Tre tabiinët më të njohur, që transmetuan hadithe nga Pejgamberi a.s., janë: 1.Tabiiu më i dituri i kohës së tij, Imam Ibrahim En Nahiju<sup>21</sup> me 20 murselate, 2. Tabiiu, dijetari i shquar, El Hejthem Ibën Ebu El Hejthem<sup>22</sup> 5 murselate dhe 3. Tabiiu i njohur, dijetari dhe komentuesi i diturisë, Imam Muxhahidi<sup>23</sup> me 3 murselate. Shembull i transmetimit të haditheve merfuaë në librin El Athar: Muhamed Ibën El Hasani thotë: Na ka rrëfyer Ebu Hanifja, i cili ka thënë, na ka treguar Nafiu nga Ibën Omeri r.a., i cili thotë: “Në vitin e betejes së Hajberit, Pejgamberi a.s. ka ndaluar ngrënien e mishit të gomarit shtëpiak dhe martesat e përkohshme, -as atëherë- ne nuk

<sup>21</sup> Ibrahim Ibën Jezid En Nahij, vdiq 96 h. Shih, Ibën Sead, Muhamed Ibën Sead, *Et Tabekat El Kubra*, recensoi: Ihsan Abasi, Dar Sadir, Bejrut, 1968, v. 6, f. 270-284.

<sup>22</sup> Ibën Ebi Hatim Er Rrazi, Abdurrahman Ibën Muhamed, *El Xherh ve Et Tadi*, Dar Ihja Et Turath El Arabij, Bejrut, 1952, v. 9, f. 80-81.

<sup>23</sup> Muxhaid Ibë Xheber El Muahzumi 102 h. Shih, Ahmed Ibën Abdullah, El Ixhlj, *Terih Eth Thikat*, Dar El Baz Linesher ve Et Tevzjij, Siri, 1984, v. 1, f. 420.

ishim të pandershëm”.<sup>24</sup> Pra, sikurse ishte e paramenduar, dijetari i mirënjohur, juristi i përgjithshëm Muhamed Ibën El Hasani, ishte dijetar edhe në hadithet e Pejgmaberit a.s.. Ai njipte mirë hadithet dhe rrugën transmetuese të haditheve sipas formës transmetuese të kohës së tij.

## 2.2. Hadithet që transmetohen nga sahabët

Çdo gjë, që transmetohet nga Muhamedi a.s. quhet merfuaë. Ndërsa çdo gjë, që transmetohet nga sahabët quhet mevkuf. Burimi i autorësisë së transmetimeve mevkuf janë sahabët, edhe nëse nuk është vërtetuar rruga e transmetimit nga ata.<sup>25</sup> Ekziston një dakordim i përgjithshëm, që me shprehjen El Athar në radhë të parë synohen transmetimet nga sahabët. Mirëpo, kjo nuk do të thotë që përjashtohen transmetimet nga Pejgamberi a.s... Ndoshta mund të thuhet që kur një tekst emërohet me titullin, El Athar, kjo tregon për numrin e madh të transmetimeve të sahabëve në atë tekst. Transmetimet, që i atribuohen sahabëve kanë një shtrirje më të theksuar në librin El Athar. Nga treqindegjashtë tema -el ebvab-, në njëqindpesëdhjetetë (153) kemi hadithe nga sahabët, respektivisht 50% e titujve janë të shërbyera nga hadithet, që transmetohen nga sahabët. Këto tema janë në njëzetekatër (24) kapituj, prej njëzetegjashtë (26) sa janë gjithsej. Numri i haditheve të transmetuara nga sahabët, mevkufatet, është treqindekatër (304) hadithe. Nëse krahasohet numri i temave, që përbëjnë hadithe nga Pejgamberi a.s., dhe të haditheve nga sahabët, kuptojmë që hadithet e sahabëve, janë pesëdhjetenjë (51) tema më shumë sesa që janë hadithet merfuaë. Ndërsa numri i haditheve nga

<sup>24</sup> Muhamed Ibën El Hasen, Esh Shejbani *El Athar*, nr. 436, hadith i sakt, 1/446. Hadithi transmetohet edhe prej sahabinjëve të tjerë, dhe thuajse në të gjitha koleksionet e hadithit, si p.sh.: El Buhari, Muhamed Ibën Ismail, *El Xhamië El Musned Es Sahih El Muh-tesar Min Umur Rasulilahi s.a.v.s. ve Sunenihi ve Ejamihi*, recenoi: Muhamed Ibën Zuhejr Ibën Naser, (Damask, Dar Tuk En Nexhah, 1422 h.), nr. 4216, v. 5, f. 135. Muslimi, Ibën Hxhah Ibën Muslim El Kushejrij, *El Xhemie Es Sahih*, recenoi: Muhamed Fuad Abdul Baki, (Bejrut, Dar Ihjae Et Turath El Arabij, 1955), nr. 407, v. 2, f. 1027, etj.

<sup>25</sup> Ibën Es Sallah, *Mukadimet Ibën Es Sallah*, f. 1, f. 46.

sahabët r.a., është për njëqindpesëdhjetetë (158) më shumë sesa hadithet nga Pejgamberi a.s..

Duke pasur në konsideratë, që dominojnë hadithet me tematikë juridike dhe numrit të shumë transmetimeve nga sahabët, kjo tregon rëndësinë dhe fuqinë argumentuese të fjalëve dhe të veprave të tyre. Duke përjashtuar mundësinë, që, sahabët të flasin apo të veprojnë qëllimisht kundër haditheve apo të kuptimit të tyre, kjo do të thotë se, në një kuptim apo tjetër, fjalët dhe veprat e tyre ose janë hadith i Pejgamberit a.s., ose janë kuptim nga mësimet e Pejgamberit a.s.. Pra, kuptimi i sahabëve, duhet të jetë prioritet, i pranuar dhe më meritori për pasim.

Të gjitha këto transmetime janë të transmetuara nga njëzetënëntë (29) sahabinjë. Sahabinjët, mendimet dhe veprimet e të cilëve dominuan, janë: 1. Abdullah Ibën Mesudi r.a., shtatëdhjetepesë (75) transmetime, 2. Omer Ibën El Hatabi r.a., gjashtëdhjetekatër (64), 3. Alij Ibën Ebu Talibi r.a., tridhjetetë (38), Abdullah Ibën Omeri r.a., njëzetetë (28), dhe Ajshia r.a. shtatëmbëdhjetë (17) transmetime. Fuqinë argumentuese të këtyre transmetimeve e bën edhe më me vlerë niveli shkencor apo kompetenca e këtyre sahabinjëve. Sahabët e potencuar janë shoqëruarit e pandashëm dhe më të dashurit e Muhamed a.s., prandaj ata kanë përparësi pranë dhe për pasimin e Pejgamberit a.s. Shembull i transmetimeve të sahabëve në librin *El Athar: Muhamed Ibën El Hasan Esh Shejbani* thotë: Na ka rrëfyer Ebu Hanifja, i cili thotë: na ka treguar Jahja Ibën Amër Ibën Selemeh nga babai i tij -Amër Ibën Selemeh-, nga Ibën Mesudi r.a., se ka thënë: “Kush prej juve i ka lexuar tri ajetet e fundit të sures Bekareh në mbrëmje, ka vepruar shumë mirë dhe ka shtuar zbukurimin e asaj nate”.<sup>26</sup> Ky hadith është transmetuar nga sahabiu i njohur, Abdullah Ibën Mesudi r.a..

---

<sup>26</sup> Muhamed Ibën El Hasan Esh Shejbani,, *El Athar*, nr. 270, hadith i saktë, v.1, fq. 298. Shih: Ebu Jusuf Jakub Ibën Ibrahim, *El Athar*, recenoi: Ebu El Vefa EL Afgani, (Bejrut, Dar El Kutub El Ilmijeh, nr. 316, v. 1, f. 63. Et Taberij, Sulejman Ibën Ahmed, *El Muëxham El Kebir*, recenoi: Hamdi Ibën Abdulmexhid, (Kajro, Mektebeh Ibën Tejmije, bot. i dytë, 1994), nr. 8671, v.9, f. 136.

### 2.3. Transmetimet nga tabiinët

Gjithashtu, në literaturën El Athar, gjejmë shumë transmetime nga tabiinët. Andaj, çdo transmetim që vjen nga tabiinët, prej falëve dhe vep-rave të tyre, quhet El Maktuaë.<sup>27</sup> Transmetimet nga Pejgamberi a.s. dhe sahabët, fillojnë të marrin formë të një shkence të konsoliduar dhe të shkruar në gjeneratën e tabiinëve. Pra, transmetimet e tyre janë të rëndësishë së veçantë, sepse ato janë në kohën e artë dhe të bekuar me dëshminë e Muhamedit a.s.. Kjo gjeneratë është e dyta për nga rëndësia për transmetimin e islamit të mirëfilltë.

Si rezultat i kësaj rëndësie të pa zëvendësueshme, transmetimet nga tabiinët zënë një hapësirë dominuese në librin El Athar të dijetarit të mirënjohur, Imam Muhamed Ibën El Hasanit. Numri i temave, që përmbajnë transmetime nga tabiinët është: dyqindetridhjetedy (232), vetëm pesëdhjetekatër (54) tema nuk kanë asnjë transmetim nga tabiinët. Numri i haditheve maktuaë, nga tabiinët në librin El Athar është pesëqindetridhjetedy (532) transmetime. Nga këto transmetime, dijetarëve tabiinë u atribuohen njëzetënëntë (29). Tre tabiinët nga të cilët është numri më i madh i transmetimeve janë: 1. Dijetari, juristi, asketi i njohur, zotëria i tabiinëve, Imam Ibrahim En Nahiju 96 h., nga i cili transmetohen katër-qindepesëdhjetë (450) transmetime, 2. Gjykatësi i shumë pushteteve dhe juristi i njohur, asketi dhe tabiiu, që jetoi në kohën e Pejgamberit a.s., por nuk e takoi atë, Imam Shurejhi Ibën El Harith 87 h.<sup>28</sup>, pesëmbëdhjetë (15) transmetime, dhe hadithologu, juristi i njohur, simboli i diturisë, Imam Amir Esh Shabiju 104 h.<sup>29</sup>, nga i cili transmetohen tetë (8) transmetime.

Shembull i transmetimit të hadithit maktuaë, nga tabiinët: Muhamed Ibën El Hasani thotë: “Na ka rrëfyer Ebu Hanifja nga Hamadi, nga Ibrahim -En Nahiju- se ka thënë: “Nëse ke fjetur, duke qenë ulur, në këmbë,

<sup>27</sup> Ibën Es Sallah, *Mukadimet Ibën Es Sallah*, v. 1, f. 47.

<sup>28</sup> Ali Ibën Ebu El Keram, Ibën El Ethir, *Esed El Gabeh Fi Mearifetu Es Sahabeh*, recensoi: Ali Muhamed Muavid Adil Ahmed, Dar El Kutub El Ilmije, Bejrut, 1996, v. 2, f. 624.

<sup>29</sup> Ibën Sead, *Et Tabekat El Kubra*, v. 6, f.246-256.

në ruku, në sexhde, hipur mbi kafshë, nuk obligohesh të marrësh abdes”.<sup>30</sup> Sigurisht nëse para të fjeturit apo të koturit nga gjumi, ke qenë me abdes, dyshimi që nga të koturit e prish abdesin, nuk është arsye, që obligon të merret prapë abdes. Këto gjendje ose janë nën kontroll, pasi që ky gjumë në ruku, sexhde apo në kafshë nuk mund të jetë gjumë i thellë, ose nuk paramendohet që natyrshëm, pa ndonjë presion të organizmit, i cili është në të kotur, të mund të lirohen gazra apo diç që e prish abdesin.

E veçanta e haditheve maktuaë në këtë libër është se, ato kanë një shtrirje për njëqindpesëdhjetë (150) tema më shumë se hadithet merfuaë, dhe për rreth njëqind (100) tema më shumë sesa hadithet maevkufeh, nga sahabët r.a..

Ndërsa, numri i haditheve maktuaë, nga tabiinët krahas numrit të haditheve merfuaë, që i atribuohen Pejgamberit a.s., është më i madh për treqindetëdhjetegjashtë (386) më shumë. Ndërsa, kur krahasohet me numrin e transmetimeve nga sahabët, numri i transmetimeve nga tabiinët është më i madh për dyqindnjëzetetë (228) hadithe.

Nga kjo skemë apo pasqyrë e detajuar e transmetimeve në librin *El Athar*, kuptojmë kapacitetin, njohurinë e autorit për transmetimet, diturinë e thellë të Imam Muhamedit për hadithet e Pejgamberit a.s.. Njëkohësisht kjo skemë tregonë për kujdesin e madh të Imam Muhamedit, që të përfitohet nga sahabët dhe qëndrimet, kuptimet e tyre. Ndërsa, kujdesi i veçantë i kushtonte edhe transmetuesëve nga nxënësit e sahabëve, tabiinëve, veçanërisht nga kryeimamët dhe juristët e kohës së tyre, të cilët nuk janë vetëm transmetues, por zotërojnë kompetencë për gjykimin, shpjegimin dhe formën e përfitimit nga kuptimi i haditheve.

Numër kaq i madh i transmetimeve nga zotëria i tabiinëve, dijetari i dalluar, Ibrahim En Nahiju r.a., është treguesi më i mirë për diturinë dhe ndikimin e tij në shkencat islame. Njëkohësisht, kjo tregon metodologjinë e juristit të përgjithshëm, dijetarit të shquar, Muhamed Ibën El Hasa-

---

<sup>30</sup> Muhamed Ibën El Hasen, Esh Shejbani, *El Athar*, nr. 168, v. 1, f. 215. Transmetim i saktë.

nit, se në mendësinë e tij ishte pasimi i dijetarëve të këtij niveli. Mirëpo, duke qenë Imam Muhamedi, një nga dijetarët e nivelit, që i ngjante diturisë së tyre, ai ishte kompetent që edhe vetë të transmetonte, trajtonte e vlerësonte hadithet. Andaj, nganjëherë edhe qëndrimet e tij janë më ndryshe. Megjithatë, zakonisht qëndrimet e tij janë përzgjedhje e qëndrimeve të dijetarëve të tjerë. Imam Muhamedi në masë të madhe pasoi dijetarët paraprak. Ai ishte ndër figurat qendrore të medhhebit hanefi. Pasimi i madh i dijetarëve paraprak tregon se Imam Muhamedi, përcolli dhe kontribuoi në zhvillimin e shkencës, posaçërisht sipas rregullave të medhhebit Hanefi, i cili kishte filluar konsolidimin që nga sahabët, por në kohën e Muhamed Ibën El Hasanit kishte marrë formën e një shkence të konsoliduar. Përmes studimit të metodologjisë së trajtimit të transmetimeve nga tabiinët, paraqesim metodologjinë e kuptimit të hadithit nga tabiinet, që më pastaj rezultoi së shkruari në kohën e tabi tabiinëve.

## Kushtet e autorit në librin El Athar

Prej studimeve më delikate, por edhe të rëndësishme në studimin e metodologjive të autorëve në librat e tyre është nxjerrja e kushteve apo kriterëve, që ka pasur në ndërdijen e vet, autori. Kjo është e vështirë, sepse ai vetë nuk i ka përmendur ato kriterë. Studimi ynë është në shërbim të përcaktimit të këtyre kriterëve.

### 1.1. Kriteret e autorit në hadithet që transmetohen nga Muhamedi a.s..

Kriteret apo parimet e Imam Muhamedit në transmetimin e haditheve në librin El Athar, të kuptuara gjatë transmetimit të haditheve merfuaë janë:

- a. Çdo hadith që transmetohet nga Pejgamberi a.s., të përcillet përmes rrugës transmetuese me varg të transmetimit ose përmes atributimit nga tabiinët se Pejgamberi a.s. ka thënë, vepruar, pëlqyer, etj.

- b. Hadithet mursel -thënja e tabiiut, Pejgamberi a.s. ka thënë...- trajtohet dhe argumentohet me të, sikurse me hadithe me varg të transmetimit të panderprerë. Numri i madh i murselateve, tregon për rëndësinë dhe fuqinë argumentuese të tyre, nga 146 hadithe, që transmetohen nga Pejgamberi a.s., 60 janë murselate.
- c. Të gjitha transmetimet, pavarësisht formës dhe vargut të tij, janë transmetuar për t'u argumentuar në temat përkatëse, edhe pse vargu i tyre mund të jetë i ndërprerë. Kjo tregon se në kriterin e Imam Muhamedit, të gjitha transmetimet në librin *El Athar* janë të vlefshme për argumentim. Jo detyrimisht, ndërprerja në vargun e transmetimit do të thotë dobësim i tekstit të hadithit. Dijetarët e kalibrit të Imam Muhamedit, argumentohen me hadithe, duke u bazuar edhe në kriteret e tjera përcjellëse dhe përforcuese, të cilat janë të shumta dhe të ndryshme.

## 1.2. Kriteret e autorit në hadithet që i transmetohen nga sahabët

Kriteret e transmetimeve në librin *El Athar* nga sahabët, të përfituara nga ky studim janë:

- a. Të gjitha transmetimet e tyre të transmetohen me varg transmetimi apo të atribuohen deri te autori i fjalës apo veprës. Shembull, transmetimi nga Ibën Mesudi, potencuar më lartë, në 2.2.
- b. Në rast të mendimeve kundërthënëse mes tyre, përzgjedh në mes të mendimeve të tyre. Ndër format e përzgjedhjes së transmetimeve: Veprimi i Omerit r.a., “është më i dashur për neve sesa ai i Ibën Mesudit r.a.”<sup>31</sup> Ka përzgjedhur mendimin e Omerit r.a..
- c. Në pozicionet argumentuese mund të përmend emra të sahabinjëve, që kanë qëndrim të njëjtë për argumentim, pa përmendur vargun transmetues.

---

<sup>31</sup> Muhamed Ibën El Hasani Esh Shejbani, *El Athar*, nr. 96, v. 1, f. 163.

- d. Argumentohet me transmetimet e sahabëve ashtu sikurse edhe me hadithe merfuaë. Nuk vërehet ndonjë dallim në trajtimin e haditheve merfuaë dhe mevkufeh. Në bazë të studimit tonë, Imam Muhamedi transmetimet nga sahabët i sheh si përmbledhje apo qëndrimet e fundit të Muhamedit a.s.. Andaj, numri i haditheve nga sahabët dyfishohet, krahas haditheve, që i transmetohen drejtpërsëdrejti nga Muhamedi a.s..

### 1.3. Kriteret në transmetimet nga tabiinët

Ndërsa kriteret e transmetimit nga tabiinët mund t'i përmbledhim si në vijim:

- a. Hadithet maktuah, nga tabiinët transmetohen me varg të transmetimit sikurse hadithet muerfuaë dhe mevkufeh, ashtu siç u theksua transmetimi i Imam Ibrahimit, shih 2.3.
- b. Të gjithë transmetimet nga tabiinët janë nga imamët, juristët dhe dijetarë të dalluar, të cilët posedonin kompetencë dhe meritonin pasimin e dijetarëve më eminentë botëror. Dominojnë transmetimet e Imam Ibrahim En Nahijut, por edhe transmetimet e tjera ishin nga imam të dalluar, figura, që ishin dhe mbetën referencë e dijetarëve të botës islame, si p.sh.: Alkameh Ibën Kajs, Muxhahid Ibën Xheber, Seid Ibën Xhubejr, El Hasen El Basriu, Mesruk Ibën El Exhdeaë, Sejid Ibën El Musejibi etj...
- c. Imam Muhamed, në rast të kundërthënieve në mesin e tabiinëve kishte kriter përzgjedhjen e mendimeve të tyre. Sjellim si shembull përzgjedhjen e mendimit të Imam Esh Shabijut, krahas mendimit të Imam Ibrahim En Nahijut për formën e daljes nga namazi individual, për t'ju bashkuar namazit me xhemat, Imam Muhamedi thotë: "Mendimi i Esh Shabijut është më i dashur për neve".<sup>32</sup> Edhe pse zotëria i tabiinëve, Imam Ibrahim En Nahiju ishte refereca e tij kryesore, Imam Muhamedi e përzgjedh mendimin e Imam Esh

<sup>32</sup> Muhamed Ibën El Hasani Esh Shejbani, *El Athar*, nr. 126, v. 1, f. 186.

Shabiut. Kjo tregon transparencën dhe pasimin e të vërtetës. Ai ishte larg fanatizmit, që i atribuohet pasuesve apo përfaqësuesve të medhhebeve, edhe pse kjo është normale nga hoxha i dijetarëve, Imam Muhamedi r.a..

## Përfundim

Prej rezultateve apo dobive të këtij studimi mund të veçojmë:

- Studimi i literaturës së vjetër, të shekujve të parë të islamit, shfaqë vlerën dhe diturinë e dijetarëve të asaj kohe dhe kontributit të tyre. Përfitohet nga mësimet e Pejgamberit a.s., sahabëve dhe tabiinëve, prej literaturës origjinale, nga dora e parë.
- Përmes këtyre studimeve shfaqet kujdesi dhe kontributi i dijetarëve për ruajtjen, përfitimin dhe transmetimin e mësimave nga Muhamedi a.s., sahabët dhe tabiinët.
- Paraqitja e mendimeve dhe e veprave të sahabëve konsiderohet përmbledhje e praktikimit të mësimave pejgamberike, andaj edhe janë referencë argumentuese.
- Mësimet e tabiinëve janë transmetur nga figurat më të larta shkencore të tyre, mësimet e të cilëve, në gjeneratën vijuese, morën formë të konsoliduar shkencore të shkruar.
- Kushtet dhe forma e transmetimit, të tri gjeneratave të para janë të përafërta, fokusohen te figurat përfaqësuese shkencore, të sahabëve dhe të tabiinëve.
- Kërkohet dhe propozojmë, që, të studiohen murselatet, fuqia argumentuese e këtyre transmetimeve të Imam Muhamedi, pasi që ai është njëri nga figurat kryesore dhe konsoliduese të medhhebit Hanefi.



# Veshja e mëndafshit mes të ndaluarës dhe të lejuarës

Prof. Ass. Dr. Ilmije Kuçi\*

---

## Abstrakt

Zoti i Madhëruar u ka dhënë begati të shumta dhe të mëdha bijve të Ademit, duke përfshirë edhe begatinë e veshjes, që Zoti i Madhëruar ia ka nënshtuar njeriut për ta mbrojtur nga të nxehtit dhe nga të ftohtit, si dhe për të qenë stoli dhe petk i mbulimit të trupit të tij, në përputhje me thënien e të Madhëruarit: ***“O bijtë e Ademit, Ne krijuam për ju petk, që ju mbulon vendturpësinë dhe petk zbukurues”***<sup>1</sup>. Prandaj, njeriu duhet ta ruajë begatinë, që i ka dhënë Zoti i Madhëruar dhe t'i respektojë rregullat ligjore në të. Legjislacioni Islam ka lejuar që burrat dhe gratë të zbukurohen, veçanërisht me veshje, por njëkohësisht ka bërë edhe disa kufizime, duke përfshirë ndalimin e disa llojeve të veshjeve si për burrat ashtu edhe për gratë, ndërsa disa vetëm për burrat, në përkushtim ndaj Zotit të Madhëruar. Ai i lejoi disa gjëra dhe i ndaloi disa gjëra të tjera, jo për t'i kufizuar njerëzit, por për t'u përmbaj-

---

\* Autorja Prof. Ass. Dr. Ilmije Kuçi studimet e masterit i ka përfunduar në Jordani, Universiteti “El-Ulumi'l Islamiye El-alemije”, kurse doktoratën në Universiteti El-Ulumi'l Islamiye El-alemije”, poashtu në Jordani. Është profesorësh e fikhut në Fakultetin e Studimeve Islame në Prishtinë. E-mail: ilmijekuqi1@gmail.com

<sup>1</sup> El Araf, 26.

tur kufijve dhe rregullit në univers. Kjo, sepse Zoti i Lartmadhëruar është i Urtë në urdhrat dhe ndalesat e Tij. Ai nuk urdhëron përveç asaj, që është në interes të njeriut dhe nuk ndalon përveç asaj që është e dëmshme për të, ku urtësia e këtyre urdhëresave dhe e ndalesave mund t'i shfaqet krijesave të Tij dhe mund të mos i shfaqet. Prandaj, çështja e veshjes në Islam, qoftë për burrat apo gratë, është një nga çështjet e rëndësishme në Legjislacionit Islam, andaj dhe juristët i kanë kushtuar vëmendje të veçantë kësaj çështjeje dhe kanë përcaktuar kapituj të veçantë për rregullat e saj.

**Fjalë kyqe:** mëndafshi; e lejuara; ndalimi; stoli; legjislacioni islam.

## Abstract

The Almighty God has bestowed numerous profound blessings upon the children of Adam, including the gift of clothing, which He has provided for human beings to protect them from heat and cold, as well as to serve as adornment and a means to cover their bodies. This aligns with the statement of the Almighty: “O children of Adam, We have created for you garments to cover your shame and as an adornment.” Consequently, individuals are obliged to safeguard this blessing granted by the Almighty and adhere to the legal stipulations associated with it. Islamic legislation permits men and women to enhance their appearance, particularly through attire, while simultaneously establishing certain boundaries. These include prohibitions on specific types of clothing for both men and women, and some restrictions unique to men, as an expression of devotion to the Almighty. The allowances and prohibitions are not intended to impose limitations but to observe the harmony and regulations within the universe. This is because the Almighty, in His wisdom,

commands only what is beneficial for humankind and forbids only what may bring harm, with the wisdom behind these directives sometimes evident to His creations and, at other times, hidden. Therefore, the subject of clothing in Islam, for both men and women, holds a significant place within Islamic legislation. Jurists have thus devoted special attention to this matter and have dedicated distinct chapters to its regulations.

**Keywords:** silk; permissible; prohibition; adornment; Islamic legislation.

## Dispozita e veshjes se mëndafshit

Kur flasim për rrobën e mëndafsh të, flasim për mëndafsh të paperzier dhe mëndafsh të përzier me diçka tjetër dhe se ajo mund të vishet, e mund të përdoret, duke mos u veshur. Prandaj, ne do të flasim për secilën për to, veç e veç.

### Një: Rroba e endur me mëndafsh të pastër.

Veshja e rrobës, që komplet është prej mëndafshi dhe nuk është e përzier me diçka tjetër, është e ndaluar për burra të vishet jashtë luftës, unanimisht, si dhe gjatë luftës sipas Imamit.<sup>2</sup> Këtë e argumentojmë me hadithin, të cilin e transmeton Ebu Musa el-Esharij r.a., se Pejgamberi a.s. ka thënë:

---

<sup>2</sup> Sipas dy nxënësve të tij lejohet, për shkak se veshja e mëndafshit në rast lufte është një domosdoshmëri, sepse personi ka nevojë të shmangë dëmtimin e armës nga vetvetja, ndërsa mëndafshi e shmangë më së miri, si dhe për shkak se kjo u shkakton frikë armikut për shkak të shkëlqimit të tij, prandaj dhe është lejuar për shkak të domosdoshmërisë. Shih: el-Bedai, 5/131; el-Hidajeh, 4/366; el-Muhit, 5/342; el-Ihtijar, 4/158; et-Tebjijn, 6/15; el-Bahr, 8/216, etj.

Ky mospajtim është nëse rroba është e trashë dhe me të arrihet të mbrohet nga armiku në luftë. Mirëpo, nëse rroba është e hollë dhe nuk shkakton frikë armikut, nuk lejohet unanimisht, për shkak të mungesës së dobisë. Shih: el-Ihtijar, 4/158; el-Xhevhere, 2/281; Mexhma el-Enhur nga “*el-Minh*”, 2/535; ed-Durr el-Muhtar ve hashijetuhu, 6/357, etj.

أَجَلٌ الذَّهَبُ وَالْحَرِيرُ لِإِنَاثِ أُمَّتِي، وَحَرَمٌ عَلَيَّ ذِكُورَهَا

“Ari dhe mëndafshi janë lejuar për femrat e umetit tim, ndërsa janë ndaluar për meshkujt e tij”<sup>3</sup>.

Ky hadith sqaron ndalimin e arit dhe të mëndafshit, qoftë përmes stolisjes apo veshjes, për burrat dhe jo për gratë, sepse veshja e mëndafshit për gratë lejohet në çfarëdo forme qoftë, për shkak haditheve të shumta, të përmendura në lidhje me të.

Ndalueshmërinë e mëndafshit e dëshmon edhe hadithi, të cilin e transmeton Ibën Zubejri dhe Ebu Umame r.a. se Pejgamberi a.s. ka thënë:

مَنْ لَبَسَ الْحَرِيرَ فِي الدُّنْيَا لَمْ يَلْبَسْهُ فِي الْآخِرَةِ

“Kush vesh mëndafsh në këtë botë, nuk do ta veshë atë në ahiret”<sup>4</sup>.

Ky hadith është një paralajmërim për burrat, që të mos veshin mëndafsh në këtë botë, pasi hadithi e bën të qartë, se kushdo që vesh mëndafsh në këtë botë, nuk do të mund ta veshë atë në ahiret, gjë që tregon se në çfarë mase burrat janë të ndaluar të veshin mëndafsh.

Kjo transmetohet edhe nga Umeri, Aliu, Muavije ibën Ebi Sufjani, Ukbetu ibën Amiri, Enesi, Hudhejfe, Umu Hani, Abdullah inën Amri, Imran ibën Husajni, Xhabiri, Ebu Rejhane, Ibën Umeri dhe Bera' ibën Azibi r.a., Enes ibën Maliku, Museleme ibën Mahledi, Ukbe ibën Amir el-Xhuhenij dhe Ebu Hurejre r.a.<sup>5</sup>

Këto hadithe, për ndalimin e veshjes së mëndafshit, kanë ardhur të pakufizuara, duke mos bërë dallim midis gjendjes së luftës dhe asaj në gjendjeje paqeje, prandaj dhe mbesin të përgjithshme.

Ndërsa sa i përket domosdoshmërisë së veshjes së rrobës së mëndafshit gjatë luftës, kjo mund të mënjanohet me veshjen e rrobës së përzier, domethënë duke veshur atë rrobë, që në formë horizontale është e endur me mëndafsh, ndërsa në formë vertikale është e endur me diçka tjetër,

<sup>3</sup> Ahmedi, nr: 19503, 32/259, Shejh Shuajbi thotë: “Hadithi është sahih me rrugët tjera të tij”; et-Tirmidhi, nr: 1720, 3/269, dhe thotë: “Hadithi është i mirë sahih”; Sunen el-Kubra i Nesaiut, nr: 9387, 8/358; Sunen el-Kubra i Bejhekiut, nr: 4220, 2/596.

<sup>4</sup> el-Buhari, nr: 5833, 7/150; Muslimi, nr: 2074, 3/1646.

<sup>5</sup> et-Tirmidhi, 3/269; Nexhahu el-Karij, 1/2049.

për shkak se mbrojtja e dëmtimit të armëve dhe frikësimi i armikut arrihet me të, andaj nuk është e nevojshme veshja së rrobës prej mëndafshit të pastër, sepse ndalueshmëria nuk bie përveçse në rast nevojshmërie, e këtu nuk ka nevojë, sepse ajo mënjanohet me përzierje.<sup>6</sup>

Në ndalueshmërinë e veshjes së rrobës së papërzier të mëndafshit, nuk ka dallim në mes të moshërriturit dhe të voglit, pasi që ai është mashkull, sepse Pejgamberi a.s. ndalueshmërinë e ka lidhur me gjininë mashkullore, e kjo përfshinë edhe të vegjlit e gjinisë mashkullore.<sup>7</sup> Vetëm nëse personi, që ka veshur është i vogël, atëherë mëkati bie mbi atë, që ia ka veshur atij, jo mbi të voglin, sepse fëmija nuk është prej atyre, që është i ngarkuar me obligime.<sup>8</sup>

## Rastet në të cilat është e lejuar për burrat të veshin mëndafsh

Feja Islame ka ardhur të sigurojë një jetë të denjë njeriut, në të cilën mund të jetojë në paqe, kështu që ka disa përjashtime në çdo rregull të fesë, që lehtësojnë rregullin. Prandaj, është e mundur, që burrat të veshin mëndafsh, por kjo bëhet sipas nevojës. Edhe në këtë çështje nga ndalueshmëria e veshjes së rrobës së mëndafshit të papërzier me diçka tjetër, bënë përjashtim paraqitja e nevojës së veshjes së saj,<sup>9</sup> si për shembull, kur njeriu ka zgjeben apo vuan nga kruajtja e lëkurës dhe nuk gjenë rrobë tjetër për t'u veshur veç mëndafshit, në këtë rast nuk është e ndaluar.<sup>10</sup> Transmetohet nga Enesi r.a., i cili thotë:

---

<sup>6</sup> Tuhfetu el-Fukaha, 3/341; el-Bedai, 5/131; el-Hidajeh, 4/366; et-Tebjin, 6/15; el-Binajeh, 12/102-103; e-Bahr, 8/216, etj.

<sup>7</sup> el-Bedai, 5/131; Mirkatu el-Mefatih, 7/2779.

<sup>8</sup> Tuhfetu el-Fukaha, 3/341-342; el-Bedai, 5/131; el-Ihtijar, 4/159; et-Tebjin, 6/16; Mirkatu el-Mefatih, 7/2779, etj.

<sup>9</sup> el-Muhit, 5/341.

<sup>10</sup> el-Bahr nga "et-Tatarhanijeh", 8/216.

أَنَّ النَّبِيَّ ﷺ رَحَّصَ لِعَبْدِ الرَّحْمَنِ بْنِ عَوْفٍ وَالزُّبَيْرِ، فِي قَمِيصٍ مِنْ حَرِيرٍ مِنْ حِكَّةٍ  
كَانَتْ بَيْنَهُمَا

*“Pejgamberi a.s. ia lehtësoi Abddurrahman ibën Avfit dhe Zubejrit (veshjen e) këmishën e mëndafshit, për shkak të kruarjes, që e kishte”.*<sup>11</sup>

Gjithashtu, nga ndalueshmëria e veshjes së rrobës së mëndafshit të papërzier me diçka tjetër, për burra, bënë përjashtim ajo, që është në madhësi të katër gishtërinjve të gjerësisë së rrobës.<sup>12</sup> Nëse janë në vende të ndryshme të rrobës, ato nuk mbledhen. Me përjashtim në qoftë se një rresht i tij është mëndafsh dhe një rresht është diçka tjetër, sa që i tëri shihet si mëndafsh. Por, nëse ato vende të qëndisura apo të endura me mëndafsh,<sup>13</sup> nuk e arrin secila në vete sasinë e katër gishtërinjve, lejohet veshja e asaj rrobe, edhe nëse e tejkalon këtë sasi në rast se bashkohen, përdërisa nuk shihet i gjithi si mëndafsh.<sup>14</sup>

Se kjo madhësi, është e falur apo lejohet, e argumenton hadithi, të cilin e transmeton Umeri r.a., i cili thotë:

نَهَى رَسُولُ اللَّهِ ﷺ عَنْ لُبْسِ الْحَرِيرِ إِلَّا مَوْضِعَ أَصْبُعَيْنِ أَوْ ثَلَاثَةٍ أَوْ أَرْبَعَةٍ

*“I Dërguari i Allahut a.s. e ndaloi veshjen e mëndafshit, përveç në sasi të dy apo tre apo katër gishtave”.*<sup>15</sup>

Ky hadith sqaron kufirin e lejuar, që burrat të veshin mëndafsh, pasi madhësia e mëndafshit në veshjet e burrave nuk duhet të kalojë katër gishta.

Këtë e dëshmon gjithashtu edhe hadithi, të cilin e transmeton Esma bint Ebi Bekr r.a., e cila thotë:

<sup>11</sup> el-Buhari, nr: 2919, 4/42.

<sup>12</sup> et-Tebjîn, 6/14; el-Bahr, 8/215; Mexhma el-Enhur, 2/533; el-Hedijetu el-Alajjeh, fq. 275; ed-Durr el-Muhtar, 6/351, etj.

<sup>13</sup> Në gjuhën arabe quhet kazun, që është mëndafshi ashtu siç është nxjerr nga fshikëza dhe më pas nga ai bëhet mëndafshi natyral. Mu'xhem el-Lugati el-Arabijeh, 3/1809.

<sup>14</sup> el-Hedijetu el-Alajjeh, fq. 275; ed-Durr el-Muhtar ve hashijetuhu, 6/352 dhe 6/357, etj.

<sup>15</sup> Muslimi, nr. 2069, 3/1643.

هَذِهِ جُبَّةُ رَسُولِ اللَّهِ ﷺ، فَأَحْرَجَتْ إِلَيَّ جُبَّةً طَيَّالِسَةً كِسْرَوَانِيَّةً لَهَا لَبَنَةٌ دِيْبَاجٍ  
وَفُرْجِيهَا مَكْفُوفَيْنِ بِالْدِّيْبَاجِ، فَقَالَتْ: هَذِهِ كَانَتْ عِنْدَ عَائِشَةَ ﷺ حَتَّى فُيْضَتْ،  
فَلَمَّا فُيْضَتْ قَبِضْتُهَا، وَكَانَ النَّبِيُّ ﷺ يَلْبَسُهَا فَنَحْنُ نَعْسِلُهَا لِلْمَرْضَى نَسْتَشْفِي بِهَا  
“Kjo është rroba e të Dërguarit të Zotit a.s.. Ajo ma nxori një xhybe  
të leshtë të zezë nga Persia, e cila kishte një copë të mëndafshit dhe  
dy të çarat e saj (një përpara dhe një prapa) ishin të qepura me më-  
ndafsh. Ajo (transmetuesja) tha: Kjo ishte tek Aisheja r.a., derisa  
vdiq. Kur ajo vdiq unë e kapa atë. Pejgamberi a.s. e vishte atë. Ne e  
lanim atë, që të sëmurët të shërohen me të”<sup>16</sup>

Prandaj, mund të themi se është e lejuar, ajo që qepet skajeve të më-  
ngëve nga mëndafshi dhe ajo, që vendoset në jakën e xhybes, e cila qu-  
het kupollë, gjithashtu pulla dhe vrima e saj, skajet e çallmës, rripi i hollë  
i pantallonave,<sup>17</sup> ajo që është në shpatullat e abajes dhe në shpinën e saj,  
ajo që është në skajet e pëlhurës së hollë prej pambuku, që përdoret për  
mbështjelljen e çallmës ose si mbulesë për kokën ose fytyrën, pavarësi-  
sht se a është punë me gjilpërë ose thurje, dhe ajo që vendoset në skajet  
e çallmës, e gjithë kjo është e lejuar nëse është katër gishta e gjerë.<sup>18</sup> Gji-  
thashtu, rroba e endur me ar është e lejuar nëse është në këtë sasi, do-

<sup>16</sup> Muslimi, nr: 2069, 3/1641.

<sup>17</sup> El-Haskefi, në ed-Durr el-Muhtar, 6/353, e saktëson ndalueshmërinë e rripit të mëndaf-  
shit të pantallonave. Gjithashtu, Zejnudin err-Rrazi, në Tuhfetu el-Muluk, fq. 228, ecë  
sipas mendimit të ndalueshmërisë.

Mirëpo, Ibën Abidini, në Redu el-Muhtar ala ed-Durr, 6/354, shton: “Në “*el-Fetava et-  
Tatarhanijeh*” thuhet se kjo nuk është e ndaluar, sepse ai nuk vishet vetëm. Gjithashtu,  
në korrektimin e “*el-Xhami es-Sagir*” të disa korrektoreve kanë thënë se nuk ka asgjë  
të keqe në rripin e pantallonave për burra sipas mendimit të Ebu Hanifes, ndërsa Sadru  
esh-Shehid e ka përmendur se kjo është e ndaluar tek dy nxënësit e tij”. Gjithashtu,  
Shejh Zadeh, në Mexham el-Enhur, 2/534, thotë: “Në “*el-Fetava es-Sugra*”, “*edh-Dhehi-  
ra*” dhe “*Sherh el-Kuduri*” thuhet se nuk është i ndaluar rripi prej mëndafshi, sipas Ima-  
mit, ndërsa sipas Ebu Jusufit është i ndaluar”. Poashtu, Ibën Nuxhejmi, në el-Bahr,  
8/216, ecë sipas mendimit të lejueshmërisë.

<sup>18</sup> Redu el-Muhtar ala ed-Durr, 6/352.

methënë në madhësi të katër gishtave, përndryshe nëse është më shumë se kaq është e ndaluar për burra.<sup>19</sup>

### Dy: Rroba e endur me mëndafsh në formë vertikale, ndërsa me diçka tjetër në formë horizontale.

Veshja e asaj rrobe, që në formë vertikale është e endur me mëndafsh, ndërsa në formë horizontale është e endur me diçka tjetër, si pambuku, liri dhe leshi, është e lejuar të vishet në të gjitha rastet<sup>20</sup> unanimisht,<sup>21</sup> qoftë ajo e mbizotëruar apo mbizotëruese apo e barabartë me mëndafshin.<sup>22</sup> Kjo, për shkak se rroba bëhet rrobë me anë të endjes në formë horizontale. Sepse, rroba bëhet rrobë përmes endjes. Ndërsa, endja përbëhet prej endjes në formë horizontale dhe asaj vertikale, e endja e fundit vjen në formën horizontale, kështu që, nëse endja në formë horizontale është mëndafsh, atëherë i tëri konsiderohet mëndafsh.<sup>23</sup>

Me fjalë të tjera, rroba nuk bëhet rrobë pa endjen në formë horizontale, edhe atë vertikale, kështu që shkak është në të dyja anët, prandaj në konsideratë merret ajo, që duket, jo ajo që është e fshehur.<sup>24</sup> Si dhe për shkak të transmetimeve. Prej tyre: Transmetohet nga Ibën Abasi r.a. i cili thotë:

«إِنَّمَا نَهَى رَسُولُ اللَّهِ ﷺ عَنِ ثَوْبِ الْمُصَمَّتِ مِنَ الْحَرِيرِ، فَأَمَّا الْعَلَمُ وَسَدَى الثَّوْبِ فَلَا بَأْسَ بِهِ»، وفي رواية: «إِنَّمَا نَهَى النَّبِيُّ ﷺ عَنِ الثَّوْبِ الْحَرِيرِ الْمُصَمَّتِ، فَأَمَّا الثَّوْبُ الَّذِي سَدَاهُ حَرِيرٌ لَيْسَ بِحَرِيرٍ مُصَمَّتٍ، فَلَا تَرَى بِهِ بَأْسًا»

<sup>19</sup> et-Tebjin, 6/14; Mexhma el-Enhur nga “*et-Tenvir*”, 2/534; el-Hedijetu el-Alaijeh, fq. 275; ed-Durr el-Muhtar, 6/352, etj.

<sup>20</sup> El-Hidajeh, 4/366; el-Inajeh, 10/20; Fet’hu el-Kadir, 10/20; el-Bahr, 8/216; ed-Durr el-Muhtar ve hashijetuhu, 6/356; el-Lubab fi sherhi el-Kitab, 4/158, etj.

<sup>21</sup> Tuhfetu el-Fukaha, 3/341; el-Muhit, 5/341; el-Ihtijar, 4/158, etj.

<sup>22</sup> Mexhma el-Enhur, 2/535; Redu el-Muhtar ala ed-Durr, 6/356; el-Hedijetu el-Alaijeh, f. 277.

<sup>23</sup> El-Bedai, 5/131; el-Muhit, 5/341.

<sup>24</sup> Et-Tebjin, 6/15; el-Bahr, 8/216.

*“I Dërguari i Zotit e ndaloi rrobën e pastër<sup>25</sup> prej mëndafshi. Ama sa i përket të qëndisurës<sup>26</sup> dhe asaj në formë vertikale të rrobës, nuk ka asgjë të keqe në të”.<sup>27</sup> Në një transmetim tjetër: “Pejgamberi a.s. e ndaloi rrobën e pastër të mëndafshit. Ndërsa sa i përket rrobës, që është e qepur në formë vertikale me mëndafsh, ajo nuk është mëndafsh i pastër, kështu që nuk shohim asgjë të keqe në të”.<sup>28</sup>*

**Tre: Rroba e endur me mëndafsh në formë horizontale, ndërsa me diçka tjetër në formë vertikale.**

Kjo formë është e kundërta e të dytës, e që është: veshja e asaj rrobe, që në formë horizontale është e endur me mëndafsh, ndërsa në formë vertikale është e endur me diçka tjetër, si pambuku, liri dhe leshi. Kjo formë është e lejuar unanimisht të vishet vetëm në luftë, për shkak të domosdoshmërisë, e që është futja e frikës në sytë e armikut me shkëlqimin e tij dhe mbrojtjen nga sulmet e armëve. Ndërsa, jashtë luftës nuk ka nevojë për të, prandaj është e ndaluar.<sup>29</sup>

## Dispozita e përdorimi të mëndafshit

Dijetarët nuk u kufizuan në shpjegimin e dispozitës së veshjes së mëndafshit për burrat, por ata përfshinë edhe dispozitën e përdorimit të tij, e detajuan dhe e sqaruan atë.

<sup>25</sup> Që i tëri është mëndafsh dhe nuk është i përzier me pambuk apo diçka tjetër.

<sup>26</sup> E qëndisura është në sasi të katër gishtërinjve.

<sup>27</sup> Ebu Davudi, nr: 4055, 4/50; Sunen el-Kubra i Bejhekiut, nr: 4211, 2/594. Ibën Mulekkini, në Tuhfetu el-Muhtaxh, 1/537, thotë: “E transmeton Ahmedi dhe Ebu Davudi me sened të saktë”.

<sup>28</sup> Ahmed, nr: 2951, 5/109, Shejh Shuajbi thotë: “Hadithi është sahih”; Sunen el-Kubra i Bejhekiut, nr: 6087, 3/384.

<sup>29</sup> Tuhfetu el-Fukaha, 3/341; el-Muhit, 5/341; el-Ihtijar, 4/158; el-Inajeh, 10/20; Fet’hu el-Kadir, 10/20; el-Bahr, 8/216; el-Lubab fi sherhi el-Kitab, 4/158, etj.

Sa i përket përdorimit të mëndafshit për jastëk, shtroje dhe fjetje në to, qilima ose të ngjashme, kjo është e lejuar për burra,<sup>30</sup> ashtu siç është e lejuar edhe për gra.

Nuk është i ndaluar çarçafi i dyshekëve,<sup>31</sup> perdja e derës dhe dritares,<sup>32</sup> peri i tespiheve prej mëndafshi, kapësja e çelësave për rrobe të trupit, mbështjellësja e rrobave,<sup>33</sup> ajo që mbulon enët dhe të ngjashme, në të cilat ka përfitim pa veshje të tyre apo që i ngjan veshjes.<sup>34</sup>

Nuk ndalohet falja në sixhaden e mëndafshit, sepse e ndaluar për burra është veshja, qoftë ajo edhe në formë formale, siç është jorgani, ndërsa përfitimi në forma të tjera nuk është i ndaluar.

Qesja e mëndafshit e Kur'anit, është e ndaluar nëse mbahet në qafë, jo nëse lihet e varur në shtëpi. Qesja e mëndafshit e dërhëmëve, është e ndaluar nëse mbahet e varur në qafë, jo në xhep.<sup>35</sup>

Kjo është kështu sipas mendimit të Imamit.<sup>36</sup> Ndërsa, sipas mendimit të Imam Ebu Jusufit dhe Imam Muhamedit, përdorimi i mëndafshit në këto forma është i ndaluar, për shkak të haditheve të përgjithshme të ndalueshmërisë së mëndafshit, sepse ato përfshijnë veshjen, mbështetjen dhe shtrojen. Si dhe hadithi, të cilin e transmeton Hudhejfe r.a, i cili thotë:

<sup>30</sup> El-hidajeh, 4/366; el-Ihtijar, 4/158; et-Tebjin, 6/14; Mexhma el-Enhur, 2/534; el-Hedijetu el-Alajeh, fq. 276; ed-Durr el-Muhtar ve hashijetuhu, 6/355; Mirkatu el-Mefatih, 7/2768, etj.

<sup>31</sup> ed-Durrer el-Mubaha, f. 125.

<sup>32</sup> El-Ihtijar, 4/158; Hashijetu esh-Shilbi ala et-Tebjin, 6/14; el-Inajeh, 12/99; Mexhma el-Enhur, 2/534, etj.

<sup>33</sup> El-Hedijetu el-Alajeh, f. 276; Redu el-Muhtar ala ed-Durr, 6/354; ed-Durrer el-Mubaha, fq. 124, etj.

<sup>34</sup> Redu el-Muhtar ala ed-Durr, 6/354.

<sup>35</sup> el-Hedijetu el-Alajeh, fq. 276; Redu el-Muhtar ala ed-Durr, 6/354; ed-Durrer el-Mubaha, fq. 124, etj.

<sup>36</sup> Këtë e lejojnë edhe Ibën el-Maxhishun el-Maliki, disa Shafii, Abdulaziz ibën Seleme dhe biri i tij Abdulmeliku. Umdetu el-Karij, 22/14; Nexhahu el-Karij, 1/20443.

نَهَانَا النَّبِيُّ ﷺ أَنْ نَشْرَبَ فِي آيَةِ الْفِضَّةِ وَالذَّهَبِ وَأَنْ نَأْكُلَ فِيهَا، وَعَنْ لُبْسِ  
الْحَرِيرِ وَالذِّيْبَاجِ، وَأَنْ نَجْلِسَ عَلَيْهِ

*“Pejgamberi a.s. na ka ndaluar që të pimë në enë argjendi dhe të hamë në to, si dhe nga veshja e mëndafshit dhe ulja në to”.*<sup>37</sup>

Gjithashtu, për shkak se kjo është uniformë e kryelartëve dhe të perandorëve, ndërsa ngjashmëria me ta është e ndaluar.<sup>38</sup>

Po ashtu, për shkak se kuptimi i zbukurimit dhe kënaqësisë, ashtu siç arrihet me veshje, arrihet edhe me jastëk, ulje dhe fjetje.<sup>39</sup> Si dhe për shkak se veshja e tij nuk lejohet, po kështu edhe ulja në të nuk lejohet.<sup>40</sup>

Sipas Imamit përdorimi i mëndafshit është i lejuar, për shkak se mbështetja në jastëk, fjetja mbi të, si dhe shtroja, nuk është përdorim i plotë, por përdorim në formë përbuzjeje. Kështu që, kuptimi i përdorimit dhe i zbukurimit është kufizuar në të, andaj dispozita e ndalueshmërisë nuk e tejkalon veshjen, që është përdorimi i plotë i saj.<sup>41</sup>

<sup>37</sup> el-Buhari, nr: 5837, 7/151.

Përgjigje ndaj këtij hadithi: ndalueshmëria e veshjes së mëndafshit është transmetuar prej një numër sahabësh, si Enes ibën Maliku, Umer ibën el-Hatabi, Ibën Umeri, Ebu Hurejra r.a. dhe të tjerë, dhe në asnjërin prej tyre nuk ka asgjë, që ndalon uljen mbi mëndafsh. Ndërsa hadithin e Hudhejjes, prej tij e transmeton Abdurrahman ibën Ebi Lejla dhe Abdullah ibën Ukejmi dhe në hadithin e tyre nuk ka diçka që ndalon uljen, por është vetëm ajo që e ndalon veshjen.

Ndërsa hadithin e Abdurrahmanit e transmeton Hakem ibën Utejbe, Jezid ibën ebi Ziyadi dhe Muxhahidi. Në hadithin e Hakemit dhe të Jezidit nuk ka ndalueshmëri të uljes. Ndërsa, hadithin e Muxhahidit e transmeton Sejf ibën ebi Sulejmani, Ibën Avfi, Mensuri dhe Ibën ebi Nuxhejhi, dhe në transmetimin e Sufjanit, Ibën Avnit dhe Mensurit nuk ka ndalueshmëri të uljes. Hadithin e Ibën ebi Nuxhejhit, që e transmeton Sufjani dhe Xheriri, dhe në transmetimin e Sufjanit nuk ka ndalueshmëri të uljes. Por, kjo është vetëm në transmetimin e Xheririt. Kështu që, Xheriri edhe nëse është i besueshëm, prej të cilit transmetojnë, siç thuhet në “et-Takrib”: ‘*Ai ka iluzione kur flet nga mbamendja*’. Prandaj, kjo shtesë është iluzion i tij dhe nuk ka argument në të, siç thotë et-Tehanevi, në l’lau es-Sunen, 17/345-346.

<sup>38</sup> el-Hidajeh, 4/366; el-Ihtijar, 4/158; el-Binajeh, 12/99; Mexhma el-Enhur, 2/534; el-Lubab fi sherhi el-Kitab, 4/157; Fet’h babi el-Inajeh, 5/166, etj.

<sup>39</sup> el-Bedaï, 5/131; et-Tebjin, 6/14, etj.

<sup>40</sup> el-Xhevhere, 2/281;

<sup>41</sup> el-Muhit, 5/345; Mexhma el-Enhur, 2/534; Redu el-Muhtar ala ed-Durr, 6/355.

Po ashtu, për shkak se ulja mbi mëndafsh është nënçmim i tij dhe jo nderim, kështu ai u bë si pikturat në qilim, mbi të cilin lejohet ulja, por nuk lejohet veshja e pikturave.<sup>42</sup>

Duke u bazuar në unanimitetin e të gjithëve, se sasia e paktë e mëndafshit në rrobën e veshur është e lejuar, e që është në sasi të katër gishtërinjve, edhe veshja edhe përdorimi, janë të lejuara.<sup>43</sup> Ajo që bën bashkimin midis sasisë së paktë të mëndafshit në rrobën e veshur dhe përdorimit të paktë, është të qenit secila prej këtyre dyjave model. Shembull i kësaj është zbulimi i avretit në namaz. Zbulimi i paktë nuk e prishë atë. Po ashtu edhe zbulimi i shumtë në një periudhë të shkurtër nuk e prishë. Kjo është ndryshe nga ulja në karrige të argjendte ose të arit, në të cilën nuk lejohet ulja, sepse ky është përdorim i plotë. Këto të dyja nuk vishen, por nuk janë model, sepse vetë gjëja nuk është e vlefshme të jetë model, por është model nëse është një gjë e vogël prej saj.<sup>44</sup>

Mendimin e Imamit e mbështet edhe etheri, të cilin e transmeton Misar ibën Rashidi r.a., i cili thotë:

رَأَيْتَ عَلَى فِرَاشِ ابْنِ عَبَّاسٍ مِرْفَقَةَ حَرِيرٍ

*“Pashë në shtratin e Ibn Abasit një rrethim jastëk të mëndafshit”.*<sup>45</sup>

Në këtë ether të Ibën Abasit r.a. ka argument për lejueshmërinë e mbështetjes në jastëk të mëndafshit, si dhe ulje në shtrat të mëndafshit për burra.<sup>46</sup>

Gjithashtu, këtë e mbështet edhe etheri, të cilin e transmeton Amr ibën ebi el-Mikdami nga myezini Beni Vadijah, që ka thënë:

<sup>42</sup> el-Beda'i, 6/355; el-Ihtijar, 4/158; Redu el-Muhtar ala ed-Durr, 6/355, etj.

<sup>43</sup> El-Hidajeh, 4/366; el-Muhit, 5/345; el-Ihtijar, 4/158; Mexhma el-Enhur, 2/534, etj.

<sup>44</sup> Et-Tebjin, 6/14-15; el-Binajeh, 122/101.

<sup>45</sup> Et-Tabekat el-Kubra i Ibën Sadit, 1/193-194, në të thuhet: “Transmetuesit e tij janë të besueshëm, më përjashtim të Rashidit të cilit nuk i kemi gjetur përkthim”. et-Tehanevi, në l'lau es-Sunen, 17/346, thotë: “Nuk e kam gjetur përkthimin e Rashidit mevla Beni Amir apo Beni Temim, vetëm se ai është prej gjeneratave me të mira, mbi njerëzit e të cilëve mbizotëron drejtësia, prandaj dhe transmetimi i tij pranohet”; Nasbu err-Rrajeh, 4/227; ed-Dirajeh, 2/221; Umdetu el-Karij, 22/14.

<sup>46</sup> l'lau es-Sunen, 17/345.

دَخَلْتُ عَلَى عَبْدِ اللَّهِ بْنِ عَبَّاسٍ، وَهُوَ مُتَّكِيٌّ عَلَى مِرْفَقَةِ حَرِيرٍ، وَسَعِيدُ بْنُ جُبَيْرٍ  
عِنْدَ رِجْلَيْهِ، وَهُوَ يَقُولُ لَهُ: أَنْظِرْ كَيْفَ تُحَدِّثُ عَنِّي، فَإِنَّكَ خَفِضْتَ عَنِّي كَثِيرًا  
“Hyra te Abdullah ibën Abasi, i cili ishte i mbështetur në një jastëk  
mëndafshi, ndërsa Seid ibën Xhubejri ishte tek këmbët e tij dhe i  
thoshte: Shiko se si flet nga unë, vërtet ti ke memorizuar shumë nga  
unë”<sup>47</sup>.

Në jastëk të mëndafshit, siç pohon el-Kasani, është mbështetur edhe Enesi r.a.. El-Kasani m ekëtë rast thotë: “*Transmetohet se Enesi r.a. mori pjesë në një gosti dhe u ul në një jastëk mëndafshi, në të cilin kishte zogj*’.

Kështu veprimi i tij, r.a. tregon se lejohet ulja në mëndafsh dhe në jastëk të vogël, në të cilin ka fotografi. Me këtë u bë e qartë se ajo që nënkuptohet me ndalimin në hadith është ndalimi i veshjes, kështu që veprimi i sahabiut është sqarues i thënies së Pejgamberit a.s. dhe jo në kundërshtim me të. Ndërsa analogjia me veshjen nuk është e saktë, sepse stolisja në këto drejtime nuk është si stolisja me veshje. Sepse, kjo përdoret për të fyer gjënë e përdorur, ndryshe nga veshja, kështu që argumentimi me të është i pavlefshëm”.<sup>48</sup> Prandaj, sa i përket teksteve të transmetuara për mëndafshin, themi se ato janë transmetuar për ndalueshmërinë e veshjes se rrobës së mëndafshit, ndërsa fjetja mbi të, është me poshtë se sa veshja në përdorim, prandaj nuk e pason atë në dispozitë.<sup>49</sup> Sa i përket hadithit, të cilin e transmeton Hudhejfe r.a., atij i jemi kundërpërgjigjur në fusnotë të hadithit të tij.

Sa i përket mendimit të përzgjedhur brenda medhhebit, kemi mendime të ndryshme. et-Tehanevi, thotë: “Sa i përket asaj në të cilën mbështetemi, ai është mendimi i dy nxënësve, dhe ne e marrim atë siç e kanë marrë shumica e dijetarëve. Në *'el-Mavaħib'* është shprehur qartë saktësimi (i këtij mendimi)”.<sup>50</sup> Mirëpo, ky saktësim është në kundërshtim me

<sup>47</sup> Nasbu err-Rrajeh, 4/227; ed-Dirajeh, 2/221.

<sup>48</sup> El-Bedai, 5/131-132.

<sup>49</sup> el-Ihtijar, 4/158;

<sup>50</sup> l'au es-Sunen, 17/347.

mutunet, që merren në konsideratë dhe që janë të njohura dhe me shpjegimet, që u janë bërë atyre, siç thotë esh-Shurunbulali.<sup>51</sup> Këtë e mbështet edhe el-Haskefi, duke thënë se kjo është në kundërshtim me atë, që është e njohur.<sup>52</sup> Saktësimin e mendimit të Imamit e kanë zgjedh el-Burhani, en-Nesefi, Sadru esh-Sheria dhe të tjerë, siç thotë AbdulGani el-Mejdani.<sup>53</sup>

## Përfundim

Si përfundim, mund të themi se shumë prej dijetarëve tanë, për fetva e kanë marrë mendimin e dy nxënësve të Imamit, duke u mbështetur në fjalën e Bedrudin el-Ajnit, i cili thotë: “Në *'el-Hakaik'* thuhet: Shumica e dijetarëve tanë e morën mendimin e dy nxënësve”.<sup>54</sup> Këtë e thekson edhe Ibën Abidini nga el-Kahsetanij, se ai ka thënë: “Shumë prej dijetarëve tanë e kanë marrë këtë (mendim)”.<sup>55</sup> Kjo, sepse devotshmëri është kur personi braktisë atë, që nuk ka asgjë të keqe, nga frika se mos ajo është e keqe.<sup>56</sup>

---

<sup>51</sup> Hashijetu esh-Shurnbulali ala ed-Durrer, 1/312.

<sup>52</sup> ed-Durr el-Muhtar, 6/355.

<sup>53</sup> el-Lubab fi sherhi el-Kitab, 4/157.

<sup>54</sup> el-Binajeh, 12/101.

<sup>55</sup> Redu el-Muhtarr ala ed-Durr, 6/355.

<sup>56</sup> Mirkatu el-Mefatih, 7/2768.

# Myftiu në Malin e Zi me seli në Ulqin (1881-1887) sipas dokumenteve arkivore

---

Mr. Ali Bardhi\*

## Abstrakt

Tema që kemi marrë në shqyrtim për të trajtuar ka të bëjë me institucionin e Myftinisë në Malin e Zi në periudhën nga Kongresi i Berlinit deri te Konferenca e Londrës, me theks në çështjen e emërimit të myftiut në bazë të dokumentacionit arkivor dhe studimeve të publikuara. Në këtë artikull kemi trajtuar çështjet që ndërlidhen me institucionin e Myftinisë që nga formimi i tij me seli në Ulqin në kufijtë e Malit të Zi të dalë nga Kongresi i Berlinit, zhvendosjes së tij nga Ulqini në Podgoricë, kompetencat e emërimit dhe shkarkimit të myftiut, vendi prej nga vjen ai, përkatësinë e tij kombëtare, gjuhën, etj. Institucioni i Myftinisë u formua në kuadër të nenit 27 të Kongresit të Berlinit, i cili përfshin intervalin kohor mars 1881 - qershor 1912. Në këtë kuadër,

---

\* Autori Mr. Ali Bardhi, është kryeimam në Këshillin e Bashkësisë Islame në Ulqin të Malit të Zi. Masterin e ka përfunduar Master Degree-Istanbul të Marmara University, Instituti i Shkencave Sociale Dega Histori Islame në Republikën e Turqisë.  
E-mail:islam@t-com.me

myftinjë të emëruan nga Shejhu'l-Islami në Stamboll dhe u miratuan nga krahli i Malit të Zi. Gjatë periudhës 1881-1887 të cilën po e trajtojmë në këtë artikull, për çështjet e cekura më lart, vërehen marrëveshje e nganjëherë edhe mosmarrëveshje zyrtare ndërmjet Malit të Zi dhe qeverisë osmane.

**Fjalë kyçe:** Berlin; Defter; Fe; Myftinia e Malit të Zi; Ulqin.

## Abstract

The topic that we have taken into consideration to address concerns the institution of the Mufti in Montenegro in the period from the Berlin Congress to the London Conference, with emphasis on the issue of the appointment of the Mufti based on archival documentation and published studies. In this article, we have dealt with the issues related to the institution of the Mufti from its formation with headquarters in Ulcinj on the borders of Montenegro from the Congress of Berlin, its relocation from Ulcinj to Podgorica, the powers of appointing and dismissing the mufti, the country he comes from, his nationality, language, etc. The institution of the Mufti was formed within the framework of Article 27 of the Congress of Berlin, which includes the time interval March 1881 - June 1912. In this framework, the muftis were appointed by Shaykhul-Islami in Istanbul and were approved by the Kingdom of Montenegro. During the period 1881-1887, which we are dealing with in this article, there were agreements and sometimes even official disagreements between Montenegro and the Ottoman government on the issues mentioned above.

**Key words:** Berlin; Defter; Myftinia e Malit të Zi; Religion; Ulqin.

## 1. Në vend të hyrjes

Në këtë artikull do të trajtohet periudha e Myftinisë me seli në Ulqin ndërmjet viteve 1881-1887, kurse në numrin e ardhshëm studimi ynë do të përfshijë periudhën e Myftinisë gjatë viteve 1887-1912, kur selia e saj do të zhvendoset nga Ulqini në Podgoricë e më pas në Tivar.

Që të shihet konteksti i periudhës në të cilën trajtohet tema jonë rreth myftiut në Malin e Zi, e shohim të nevojshme që në fillim të bëjmë një hyrje të shkurtër përshkruese të rrethanave historike.

Në prag të Kongresit të Berlinit (1878) qytetet më të rëndësishme si Ulqini, Tivari dhe Podgorica administroheshin nga Vilajeti i Shkodrës. Këto njësi administrative, qendër kishin Shkodrën, nga e cila administroheshin. Për rrjedhojë, edhe besimi islam administrohej nga myftinia e këtij sanxhaku/vilajeti. Për momentin nuk kemi të dhëna që përpara vitit 1878 këto qytete të kenë pasur myftinitë e veta, njëjtë si shumë kaza të tjera në Perandorinë Osmane. Ndërkaq, të dhënat arkivore na japin të kuptojmë se këto kaza kenë pasur kaditë apo naibët (gjykatësit) e vet, myderrizët, etj.

Situata e re politike solli ndryshimin e kufijve. Kështu, në vitin 1878, edhe përkundër mbrojtjes, Tivari dhe Podgorica i takuan Malit të Zi. U okupuan me luftë dhe me vendimin e Kongresit të Berlinit, më 13 korrik të vitit 1878. Fuqitë e Mëdha e njohën pavarësinë e shtetit të Malit të Zi, ndërsa Ulqini, si rezultat i rezistencës së ulqinakëve me rrethinë dhe ndihmës së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, përkohësisht kaloi nën administrimin e qeverisë së re të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, dega e Shkodrës. Kjo situatë zgjati deri kur qeveria osmane shpërndau Lidhjen Shqiptare të Prizrenit dhe qeverinë e saj. Nga presioni i Fuqive të Mëdha në nëntorin e vitit 1880, Perandoria Osmane detyrohet që Ulqinin t'ia dorëzojë Malit të Zi.<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> Synimet e Malit të Zi për t'u shtrirë edhe më tej nuk ndaluan pasi në Kongresin e Berlinit kishte marrë miratimin për aneksimin e Plavës dhe të Gucisë. Por, pas dështimit të dorëzimit të Plavës e të Gucisë, si dhe të Hotit e Grudës, Malit të Zi, konsujt e Anglisë dhe të Austro-Hungarisë në Shkodër, përkatësisht Green dhe Lippich, ditët e para të

Në kuadër të këtyre ngjarjeve, me nene të veçanta për situatën e krijuar, nxirren edhe vendimet e përcaktuara në Kongresin e Berlinit. Ne do të ndalemi në ato pjesë, që tema ka në shqyrtim. Përkatësisht me nenin 27, që ndërlidhet me liritë fetare dhe organizimin e tyre në Malin e Zi. Sipas këtij neni, besimet fetare dhe feja nuk mund t'i ndalohen asnjë individi, garantohet e drejta e jetës, e punës, etj. Njëherësh garantohet e drejta e lirisë dhe e ushtrimit të të gjitha kulteve të huaja, ku do të jenë të sigurta për të gjithë banorët e Malit të Zi, si edhe për të huajt dhe asnjë pengesë nuk mund t'u bëhet, qoftë administratës hierarkike a komuniteteve të ndryshme, qoftë raporteve të tyre me krerët e tyre shpirtërorë.<sup>2</sup>

---

majit të vitit 1880 morën iniciativën për të përgatitur një projekt tjetër. Më 11 qershor të vitit 1880 propozimi i Rusisë iu njoftua Fuqive të Mëdha për projektin, i cili përfshinte dorëzimin e Ulqinit me rrethina dhe bregdetin e tij Malit të Zi. Gjatë gjithë kësaj periudhe, nga Fuqitë e Mëdha vetëm konsullata italiane në Shkodër ka qenë në anën e shqiptarëve, Ulqinit, madje duke i ndihmuar me ar dhe para. Por betejave diplomatike dyvjeçare të Portës së Lartë me Fuqitë e Mëdha dhe në mënyrë të veçantë të Abedin Pashë Dinos për mos dorëzimin e Ulqinit po u vinte fundi dhe më 26 nëntor 1880, Ulqini iu dorëzua Malit të Zi. Shih Xhafer Sadiku, "Si iu dha Ulqini Malit të Zi", publikuar në www.Koha.mk, 08.11.2020.

<sup>2</sup> Jusuf Buxhovi, *Kongresi i Berlinit dhe Lidhja Shqiptare 1878*, Faik Konica, Prishtinë, 2012, f. 325-349.

Në kuadër të njohjes së Malit të Zi nga Fuqitë e Mëdha në vitin 1878, ai u detyrua që të pranojë edhe komunitetet e tjera si ai katolik, mysliman, etj., të cilat numëroheshin si të huaja, me arsyetimin që të dy këto komunitete, selitë e tyre i kishin jashtë Malit të Zi. Bisedat për arritjen e marrëveshjes (concordatit) për Kishën Katolike në Mal të Zi, ndërmjet Vatikanit dhe Malit të Zi filluan në vitin 1879 dhe zgjatën tetë vite, deri në vitin 1886, nga ku u vendos administrata (Selia) në Argjipeshkvinë e Tivarit. Edhe për pjesëtarët e besimit islam në Mal të Zi u veprua njëjtë, vetëm se zbatimi filloi në fillim të vitit 1881, disa muaj pasi Malit të Zi iu dorëzua Ulqini, ku u vendos edhe administrata (selia).

E tërë veprimtaria e Bashkësisë së Fesë Islame është financuar nga mjetet vetanake, përkatësisht nga të ardhurat vakëfnore.

Me Kushtetutën e Principatës (1905), (neni 40) feja islame ka pasur statusin e besimit të pranuar, pra nuk ka qenë e barabartë me besimin ortodoks dhe me Kishën Ortodokse të Malit të Zi, pasi që këto kanë gëzuar statusin e institucioneve të veçanta shtetërore. Kisha Ortodokse e Malit të Zi ka qenë e proklamuar si kishë shtetërore, kurse besimi ortodoks si besim shtetëror dhe veprimtaria e saj financohej nga shteti. Në nenin 129 të Kushtetutës thuhet: "Qeverisja e brendshme e besimit muhamedan i takon Myftiut të Malit të Zi.", përkatësisht Shejhu'l-Islamit në Stamboll.

Edhe pse në këtë Kongres u garantua e drejta e organizimit të administratës hierarkike të komuniteteve të ndryshme fetare në Malin e Zi, për komunitetin islam nuk gjeti zbatim deri pas vitit 1880, kur Ulqini i dorëzohet Malit të Zi dhe Kongresi i Berlinit mbyll punimet e veta.

Në rrethanat e reja të krijuara në këtë Kongres, ajo që mund të bëhej për Ulqinin ishte që të sigurohej garantimi i disa të drejtave më të avancuara, si: e drejta e jetës, e pasurisë, e sidomos e fesë dhe të drejta të tjera<sup>3</sup>, të cilat vijnë si pasojë e dorëzimit të Ulqinit pa luftë.

Për të parën herë, pas vendimit të vitit 1878, në Kongresin e Berlinit, neni 27, i cili garanton të drejtën e organizimit të administratës hierarkike të komuniteteve të ndryshme fetare në Malin e Zi, kemi një aktmarrëveshje konkrete për Ulqinin, të nënshkruar gjatë dorëzimit të qytetit dhe rrethinës së tij, Malit të Zi, më 25 nëntor 1880 në Kunje nga përfaqësuesi i kryekomandës së Malit të Zi dhe kryekomandantit të divizionit të Shkodrës për Perandorinë Osmane. Sipas nenit 2 të kësaj marrëveshjeje, qeveria malazeze zotohej se do t'i respektonte të drejtat, jetën dhe nderin e banorëve, që nuk duan të largohen... duke iu përmbajtur Traktatit të Berlinit. Neni 3 thotë se me një marrëveshje të posaçme osmane-malazeze do të rregullohen çështjet e vlerësimit të pasurive të shtetit, të institucioneve fetare, në përputhje po me Traktatin e Berlinit. Ndërsa neni 4 obligon qeverinë malazeze t'i quajë të vlefshme të gjitha aktet e lëshuara nga gjykatat dhe autoritetet osmane në lokalitetet e cedura.<sup>4</sup>

Në këtë kuadër iu kushtua vëmendje edhe fesë islame në Ulqin, që pasoi me vendosjen e administratës (selisë) së myftiut në Ulqin, pasi ishte me rëndësi për Ulqinin dhe për vetë Perandorinë Osmane, sepse përbënte një lloj kompensimi për qytetin dhe njëherësh mundësonte edhe ruajtjen e vazhdimësisë së integritetit të institucionit islam si qendër e Malit të Zi të kohës, por duke mos pasur fatin e vendeve të tjera,

---

<sup>3</sup> Kristaq Prifti, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit në dokumentet osmane 1878-1880*, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Tiranë, 1978, f. 134-135.

<sup>4</sup> Hajrullah Hajdari, *Ulqini në dokumentet malazeze (1880-1915)*, Art Club, Ulqin, 2018, f. 50-52.

si Tivari, Nikshiqi, Podgorica, të cilët ishin marrë me luftë pa një marrëveshje konkrete në favor të organizimit të jetës fetare të tyre dhe për rrjedhojë këto qytete kishin pësuar dëmtime materiale dhe njerëzore.<sup>5</sup>

## 2. Vendosja e selisë së myftiut në Ulqin (1881-1887)

Para dorëzimit të Ulqinit Malit të Zi, Salih ef. Hyli ishte në detyrën e myderrizit të këtij qyteti si autoriteti më i lartë në hierarkinë fetare për kohën në Ulqin. Ai shquhet edhe si veprimtar i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit për degën e Ulqinit. Kjo gjë vërehet edhe nga dokumentacioni arkivor, ku në kërkesat e parisë së Ulqinit drejtuar trupit diplomatik për mos dorëzimin e Ulqinit, së bashku me nënshkrimet e kryesisë së Ulqinit, në krye të listës e shohim përfaqësuesin islam të qytetit, myderrizin e madh Salih ef. Hyli,<sup>6</sup> por, që në momentet e kalimit të Ulqinit nën Malin e Zi Dervish Pasha e merr me vete në Shkodër.<sup>7</sup>

<sup>5</sup> Deri në vitin 1912 vetëm kazatë/qytetet si Ulqini dhe Podgorica, të cilat kishin popullsi të besimit islam, si edhe Tivari e Nikshiqi, që kishin shumë pak, i kaluan nën administrim Malit të Zi, kurse qytetet e tjera të besimit islam, që sot ndodhen në veri të Malit të Zi, akoma i përkisnin Perandorisë Osmane. Nga një dokument i Arkivit Osman i vitit 1884, që mban vulën e ambasadorit osman në Cetinë, Ahmed Xhevat Pashës, shohim që ta ketë njoftuar Stambollin se 8 000 banorët e besimit islam të mbetur në Ulqin dhe Podgoricë, gjegjësisht në Malin e Zi, akoma ruajnë besnikërinë ndaj Padishahut. Nga ky dokument shohim se përveç popullsisë së besimit islam të mbetur në Ulqin dhe Podgoricë, në numër të paktë kishte Nikshiqi, që para lufte ka pasur 750 shtëpi, tani i kanë mbetur vetëm 20 prej tyre; Kollashini ka pasur 300 shtëpi, ndërsa tani kanë mbetur 30 shtëpi, kurse në Tivar kanë mbetur afërsisht 20 shtëpi, nga ku totali i popullsisë së besimit islam të mbetur në vitin 1884 në Mal të Zi arrinte në 8 500 banorë. Njëherazi duhet cekur se gjysma e kësaj shifre ndodhej në Ulqin, çka e bënte më të rëndësishëm si vend. Shih BOA (Arkivi Osman i Shtetit - Stamboll), *Y.PRK.EŞA*, 4/31.

Kjo ishte shkak që akoma më tepër Padishahu të ruante ekskluzivitetin e emërimit të myftiut në Malin e Zi.

<sup>6</sup> Stefanaq Pollo dhe Selami Pulaha, *Aktet e Rilindjes Kombëtare Shqiptare 1878- 1912*, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Tiranë, 1978, f. 113.

<sup>7</sup> Hajrullah Hajdari, *Po aty*, f. 58-59.

E kaluara e Salih Efendiut në Ulqin si myderriz me autoritet të lartë u bë shkak që ai të rikthehet disa muaj pas dorëzimit të Ulqinit Malit të Zi, por tashmë në rang myftinie, i emëruar nga Shejhu'l-Islami dhe miratuar nga Princi i Malit të Zi.

Ndërkaq dokumentet arkivore që kemi hulumtuar deri më tani nuk na japin datën e emërimit të Salih Efendi Hylit për myfti në Ulqin. Kurse studiuesit japin të dhëna të ndryshme rreth emërimit të tij si myfti, ku disa pohojnë që myftiu i parë në Mal të Zi u emërua në Ulqin që nga viti 1878.<sup>8</sup> Por një gjë e tillë është jashtë logjikës, pasi, siç u cek më lart, deri në nëntorin e vitit 1880, Ulqini akoma nuk ishte dorëzuar.

Sipas disa dokumenteve mund të nxjerrim datën e përafërt të emërimit të tij për myfti. Përmes një telegrami, që mban datën 02.03.1881, administratori i Ulqinit Simo Popoviq njofton ministrin e Punëve të Brendshme, vojvodë Masho Vrbicën për ardhjen e hoxhës së madh të Ulqinit, Haxhi Salih efendisë nga Shkodra në Ulqin një ditë më parë. Administratori i Ulqinit e përshkruan Salih efendiun si një figurë shumë të respektuar, të shkëlqyer, inteligjent dhe me ndikim në popull.<sup>9</sup> Me shumë gjasa, Salih ef. Hyli gëzonte respektin qysh më përpara, pasi ai i kishte prirë popullit të Ulqinit në momentet e vështira. Kurse sipas telegramit tjetër të S. Popoviqit, të datës 02.04.1881, shihet që Salih Efendiun të jetë miratuar nga Knjazi për hoxhë mbi të gjithë hoxhallarët në Mal të Zi,<sup>10</sup> pra i bie që të jetë emëruar myfti, me një pagë vjetore prej 100 lirave osmane nga qeveria osmane dhe 100 napolonave nga qeveria malazeze.<sup>11</sup> Por për ta saktësuar datën e emërimit të tij për myfti, në të ardhmen nevojiten të bëhen studime më të hollësishme.

Gjatë kohës sa Salih Efendi Hyli ishte myfti, qeveria osmane përgatiti udhëzimet për çështjet fetare të myslimanëve në Ballkan, duke shfrytëzuar autoritetin, që i dha Traktati i Berlinit. Një nga udhëzimet titullohej “Udhëzim në lidhje me Bashkësinë Myslimane të Rumelisë Lindore”, i miratuar në vitin 1881. Një udhëzim i ngjashëm, i lëshuar për Rumelinë Lindore, u përgatit nga Shejhu'l-Islami në vitin 1885 (1302). Ky udhëzim

---

<sup>8</sup> Šerbo Rastoder, “Muslimani u Crnoj Gori”, Glas Crnogorca, 41/1912, 4, 2-3; Bajro Agović, *Džamije u Crnoj Gori*, Almanah, Podgorica, 2022, f. 51.

<sup>9</sup> Hajrullah Hajdari, *Po aty*, f. 58-59.

<sup>10</sup> Hajrullah Hajdari, *Po aty*, f. 66-67.

<sup>11</sup> Šerbo Rastoder, *Po aty*, f. 18.

u titullua “Udhëzimi i shkruar nga Shejhu’l-Islami lidhur me karakteristikat e medh’hebeve të Bashkësisë Islame në Greqi, Rumani, Serbi, Bullgari dhe Mal të Zi”, i cili përbëhet nga 10 kapituj me 100 nene. Udhëzimet përfshijnë çështje të tilla, si, kushtet e islamit, hierarkia dhe procedurat e emërimit të zyrtarëve fetarë, struktura dhe administrimi i fondacioneve dhe jetimoreve. Ndërkaq, neni 20 i udhëzimit ka të bëjë me emërimet e myftinjve. Me këtë udhëzim emërimi i myftiut vërtetohet përfundimisht në dokumentin e lëshuar nga shejhu’l-Islami.<sup>12</sup>

Nga dokumentacioni arkivor shohim se Salih Efendiu kishte edhe një detyrë tjetër me rëndësi - rregullimin dhe regjistrimin e të gjithë pasurisë së vakëfit në Mal të Zi, detyrë e dhënë nga qeveria malazeze.<sup>13</sup>

Salih ef. Hyli në detyrën e myftiut në Ulqin qëndroi deri në momentin e lindjes së pakënaqësive me princ Nikollën. Ai u shkarkua në mënyrë të njëanshme dhe më pas u desh të shpërngulej në Shkodër.<sup>14</sup> Nga hulumtimet e publikuara deri më tani vërejmë se nuk kemi një kundërshtim zyrtar në lidhje me vendimin e princ Nikollës për shkarkimin e Salih ef. Hylit. Ndërkaq, pas këtij vendimi, pason kërkesa e princ Nikollës për emërimin e myftiut të ri.

<sup>12</sup> Abidin Temizer, “*Nikola'nin millî devlet kurma çalışmaları ve Karadağ müftülüğü (1878-1912)*”, History Studies, ISSN: 1309 4173 / (Online) 1309 - 4688 (Print) Volume: 13, Issue: 2, April 2021, f. 616-617.

<sup>13</sup> Hajrullah Hajdari, *Po aty*, f. 66.

<sup>14</sup> Šerbo Rastoder, *Po aty*, f. 18.

Po ashtu nuk ka një mendim të saktë edhe rreth datës së shkarkimit të tij. Ndërkaq që sipas një dokumenti të Arkivit Osman, në dhjetor të vitit 1912 në lidhje me emërimet e myftinjve në Mal të Zi, ceket se 28 vite më parë, myftiu i Malit të Zi, Salih Efendiu u shkarkua nga ish-Princi Nikolla, tani mbret, e që i bie që të jetë shkarkuar në fillim të vitit 1885. Shih BOA., *HR.HMŞ.İŞO.*, 235/5, 29 Kanun-i evvel 1912/19.12.1912. Abidin Temizer, “*Nikola'nin millî devlet kurma çalışmaları ve karadağ müftülüğü (1878-1912)*”, History Studies, Volume: 13, Issue: 2, April 2021, f. 617.

Sipas një të dhëne, që na jep një defter për financat e vakëfit të Ulqinit në osmanisht, datë 01 kanun-i evvel 1300 rumi / 13 dhjetor 1884, shohim të shënuar emrin e Haxhi Salih Efendiut.

Kurse sipas një dokumenti tjetër të arkivit osman të datës 6 prill 1885, shohim se Salih Efendiu figuron i shkarkuar më 28 kanuni sani 1300 rumi / 9 shkurt 1885 nga princ Nikolla. Shih BOA., *LMMS.*, 93/3916, f. 2.

Se cilat kanë qenë pakënaqësitë e princit ndaj Salih Efendiut si myfti, akoma janë të panjohura dhe ato duhet hulumtuar në të ardhmen. Por, duke përcjellë dhe duke analizuar të dhënat arkivore e ato të shtypit të kohës, fitojmë një pasqyrë të qartë të gjendjes së krijuar në vend.

Struktura e popullsisë së rajonit të Ulqinit në ditët e para të sundimit të Malit të Zi, si dhe ndryshimi i saj me kalimin e kohës duhet të jenë bërë shkaqet kryesore të pakënaqësisë. Referuar dokumentacionit, shohim se në këto vite janë ndërmarrë masa nga knjazi për malazezimin e rajonit të Ulqinit, ku më qartë e shohim të përpiluar në shkresën e Vojvoda Simo Popoviqit - guvernator i Ulqinit, që ia dërgon ministrit për Punë të Jashtme të Malit të Zi (22 prill 1884), ku i thotë se qarku i Ulqinit për malazezët është i huaj. Brenga e parë jona, për arsye të shumë shkaqeve të rëndësishme, duhet të jetë malazezimi i vendit. Kjo do të arrihet: Përmes shkollës<sup>15</sup> dhe kolonizimit me malazezë.<sup>16</sup> Sipas këtij plani, situata pasoi me shpërngulje, ardhje të reja të popullsisë malazeze në Ulqin, si edhe ndryshimet, që pasuan në fushën e arsimit, ku për një kohë pason mbyllja e shkollave dhe për rrjedhojë pasoi me shpërngulje të reja nga Ulqini.

Nëse do të merrej në shqyrtim mosha 65 vjeçe e Salih ef. Hylit në kohën e shkarkimit të tij (1885) duhet theksuar se për periudhën që flasim, nuk është që mosha të jetë marrë si shkas për t'i ndërprerë ushtrimin e detyrës, sepse, e vlen të theksohet, se ai ka jetuar edhe 8-9 vite pas shkarkimit (1893), e cila tregon për një gjendje të mirë dhe vitale shëndetë-

---

<sup>15</sup> Bëhet fjalë për shkollimin e nxënësve të përkatësisë islame në shkollat malazeze, të cilat në këto vite në kurrikulat e veta përmbanin lëndë fetare të krishtera dhe në gjuhën malazeze.

Presioni malazez i shkollimit të fëmijëve shqiptarë myslimanë në shkollat malazeze të krishtera vazhdoi edhe më pas, ku si shembull mund të paraqesim një dosje të datës 17.04.1322 rumi/ 30.06.1906, nëpërmjet së cilës shohim se për shkak të këtij detyrimi, nga kasabaja e Ulqinit për në Shkodër janë shpërngulur 25 familje. Shih BOA, *DH.ŞFR*. 366/57.

<sup>16</sup> MID 1884, dok. 263 (1, 2, 3, 4, 5), botuar edhe në librin *Ulqini në dokumente malazeze* të autorit Hajrullah Hajdari, f. 180.

sore, gjë që e përjashton mundësinë që të jetë shkarkuar për shkak të moshës së tij.<sup>17</sup>

Për një kohë, gjetja e një kandidati të ri për myfti mbeti pezull pasi Shejhu'l-islami kërkonte një person të përshtatshëm për këtë detyrë, i cili do të duhej të njihje gjuhën shqipe dhe malazeze, fakt të cilin e shohim edhe në dokumentacionin arkivor osman.<sup>18</sup> Po kështu prej këtij dokumentacioni shohim se pas Salih Efendiut, princ Nikolla kishte njoftuar ambasadorin osman se kishte në plan të emëronte Ymer (Omer) Efendi Prizrenin, i cili ishte i arratisur nga Prizreni, duke gjetur strehim në Ulqin.<sup>19</sup> Ndërkaq Porta e Lartë e kundërshtoi një gjë të tillë me arsyetimin

<sup>17</sup> Sipas studimeve të publikuara, Salih ef. Hylit ka lindur më 1820 dhe ka vdekur më 1900. Ndërkaq, referuar një dokumenti të Arkivit Osman – Stamboll të datës 2 shaban 1310 h. / 19 shkurt 1893, shohim se pas vdekjes së Salih Hylit u vendos që t'i lidhej një pagë bashkëshortes së tij 70-vjeçare Umugulsum dhe djalit të tij Mehmedit, të cilët tashmë jetonin në Shkodër. BOA, DH.MKT. 2053/91.

<sup>18</sup> BOA, HR.TO., 46/141 (17 kanuni evvel, 1302 rumi / 29.12. 1886)

<sup>19</sup> BOA, İMMS., 93/3916, f. 2.

Në një dokument të arkivit osman, të datës 6 prill 1885, ceket se pas shkarkimit të Salih Efendiut nga detyra e myftiut nga ana e princ Nikollës më 28 kanuni sani 1300 rumi / 9 shkurt 1885 kishte në plan që në vend të tij ta emëronte myfti myderizin Ymer Efendi Prizrenin, i cili ndodhej në Ulqin. BOA, İMMS., 93/3916, f. 2. Nuk e dimë sa ka qenë serioz dhe i saktë ky vendim i paraqitur nga princ Nikolla për emërimin e Ymer Efendi Prizrenit.

Njohja e tij me vojvodën Sima Popoviq dhe të tjerë pushtetarë është bërë nëpërmjet myftiut Salih Efendi Hylit, që në vitin 1881 kur ai mbërriti në Ulqin si i strehuar politik. Këtë gjë e shohim nëpërmjet dy dokumenteve të arkivit të Cetinës, të publikuar nga studiuesi Hajrullah Hajdari. I pari është një telegram i datës 06.05.1881, ku Vojvoda S. Popoviq njofton ministrin e Punëve të Brendshme në Cetinë, Masho Vrbicën se hoxha i Madh i Prizrenit, Haxhi Ymer Efendi ka ardhur në Ulqin dhe është vendosur te hoxha i madh Salih Efendi, të cilët i kanë qenë për vizitë, për ta paraqitur atë. Ndërkohë ai i rrëfen që Ymer efendi i ka treguar se edhe disa pjesëtarë të tjerë të Lidhjes së Prizrenit kanë ikur, e më kryesori Abdullah Beu (Abdyl Frashëri), ndoshta mund të vijë në Ulqin. Në telegram vojvoda shton, duke rrëfyer që të dëgjosh se Liga, e cila e ka mbajtur Ulqinin, tani kërkon që të vendoset aty.

Ndërsa dokumenti i dytë, i cili i përket datës 7 maj 1881, është përgjigjja që i jep ministri Vojvodës, ku i kujton që ka bërë mirë që e ka pranuar Ymer Efendiun dhe shton që lirisht mund t'i thuhet Abdullah Beut (Abdyl Frashëri) dhe shoqërisë së tij shqiptare,

se ai ishte i arratisur, kishte nxjerrë ngatërresa dhe ndodhej nën hetime.<sup>20</sup> Për rrjedhojë, Perandoria Osmane kërkoi që të ruhej statuskuoja e mëparshme në kuadër të vendimit të Kongresit të Berlinit, me të cilën myftiu emërohej nga Shejhu'l-islami, duke dhënë si shembull rastin e emërimit të myftiut të Rumanisë.

Siç shihet, edhe pse në këto dokumente situata paraqitet sikur ekziston një lloj pranimi ndërmjet Ymer Efendi Prizrenit me pushtetin malazias të kohës, nuk duhet harruar faktin që Ymer Efendiu kishte ardhur në Ulqin te miku i tij, myftiu Salih Efendi Hyli për t'u strehuar, ku njëherazi nëpërmjet këtij dokumentacioni shohim që për shkak të mosmarrëveshjeve, princ Nikolla e kishte shkarkuar nga detyra e myftiut këtë të fundit. Edhe pse shikuar nga këndvështrimi i dokumentit, që tregon propozimin e princit për emërimin e Ymer Efendiut si myfti, nuk mund të nxjerrim një përfundim nëse një propozim i tillë ka qenë në pajtim me vullnetin e Ymer Efendiut, pasi një gjë e tillë nuk na rezulton në dokumente. Nga dokumentacioni në fjalë nuk shohim as edhe ndonjë qëndrim të Ymer efendiut për t'u bërë pjesë e ndonjë marrëveshjeje me princin. Po kështu, vrasja<sup>21</sup> e tij në Ulqin në vitin 1877, në momentin kur po arri-

---

që të vijë në Mal të Zi, ku do të gjejnë mikpritje të përzemërt. Shih Hajrullah Hajdari, *Po aty*, f. 70-72.

<sup>20</sup> Pas shkarkimit të Salih Efendi Hylit nga detyra e myftiut, lajmi shkoi deri te Sulltan Abdylhamidi se Princ Nikolla kishte në plan që të emëronte myfti myderzin Ymer Efendi Prizrenin. Shih *BOA, HR.TO.*, 46/57. (12 kanuni sani 1301 rumi / 24 janar 1886 m.). Por në Perandorinë Osmane nuk ishte i mirëpritur që të caktohej si myfti, sepse ishte nën hetime. Meqenëse tagri për shkarkimin dhe emërimin e myftiut për vendet e mbetura nën Mal të Zi, i përkiste Shejhu'l-Islamit, ky qëndrim i Princit Nikolla u konstatua si i paligjshëm. Personi që do të bëhej myfti në Mal të Zi nuk duhej të ishte i arratisur, por një dijetar, që kishte fituar besimin e perandorisë. Për më tepër shih *BOA, I.MMS.*, 93/3916, 03 zilkade 1304 h./ 24 gusht 1887 m.; Uğur Özcan, *II. Abdülhamid dönemi Osmanlı-Karadağ siyasi ilişkileri*, Türk Tarih Kurumu, Ankara, 2012, f. 237.

<sup>21</sup> Sipas dëshmimeve të disa ulqinakëve të publikuara në përmbledhjen e kumtesave të sesionit shkencor kushtuar Ymer Prizrenit, të mbajtur në Ulqin, ai vdiq duke u helmuar, goditur me mjete të forta, etj. Vdekja e Ymer ef. Prizrenit ishte e paqartë deri në ekspertizën e inicuar nga Enti Republikan për Mbrojtjen e Monumenteve Kulturore të Prizrenit dhe të lejuar nga Komuna e Ulqinit dhe Enti Republikan për Mbrojtjen e Monumenteve Kulturore në Cetinë, me vendim 02-426/1, datë 10 prill 1978, për aplikimin

hej kompromisi malazezo-osman për çështjet, që u hapën rreth myftiut, akoma më tepër na çon në mendimin që ai më tepër të ketë qenë i padëshiruar sesa i përshtatshëm.

Referuar dokumentacionit shohim se qeveria e Malit të Zi ndaj tij kishte vendosur masa izoluese që në momentet e shkarkimit të Salih ef. Hylit nga myftiu. Në një telegram që i dërgon më 27 shkurt 1885 Vojvoda Bozho Petroviq nga Cetina Vojvodë Simo Popoviqit në Ulqin thuhet: “Ymer Prizrenin mbajeni nën mbikëqyrje të rojës”. Vojvoda Popoviq nga Ulqini i kthen këtë përgjigje Cetinës: “Jam duke e mbajtur nën mbikëqyrje të rojës Efendi Ymer Prizrenin”.<sup>22</sup>

Është absurd të mendohet që në një rën anë princi e donte për myfti shqiptarin Ymer Prizrenin e në anën tjetër i kërkonte sulltanit që të mos emëronte myfti pjesëtar me kombësi shqiptare. Në të vërtetë, princi nëpërmjet figurës së Ymer efendiut, si i padëshiruar që ishte për sulltanin, më tepër synonte që të bënte politikë, duke i dalë kundër vendimit të Perandorisë Osmane me qëllim që të prishte marrëveshjen e arritur në Kongresin e Berlinit dhe ta minimizonte faktorin shqiptar/mysliman në institucionin e myftinisë, pasi e drejta e hierarkisë fetare, e garantuar në Kongresin e Berlinit sipas modelit të shteteve evropiane iu imponua shtetit të ri të Malit të Zi. Porse me kalimin e viteve knjazi synonte që ta shndërronte Malin e Zi në shtet unitar, duke u përpjekur t’i fuste tërësisht në dorë edhe bashkësitë fetare.

Ndërkaq, e vërteta rreth planeve të administratës malazeze na shfaqet te kujtimet e administratorit të Ulqinit, Simo Popoviq, i cili në vitin 1886 informon qeverinë e Malit të Zi se ai është njoftuar që në Ulqin ka

---

e kërkimeve antropologjike të eshtrave të tij. Ekspertizën e bëri Dr. Sci. Janos Nemesekeri, ndërsa analizat laboratorike të rikonstruimit biologjik dhe kimik i bëri Dr. Sci. Imre Lenguel, që të dy nga Budapesti. Nga aspekti i mjekësisë ligjore u lëshua KOMUNIKATA se Ymer Prizreni ka përjetuar lëndime të rënda trupore në mënyrë mekanike nga veprimi i një mjeti të fortë topitës dhe të rëndë, nga të cilat goditje edhe ka vdekur. Shih Riza Rexha, “Ymer Prizreni dhe Ulqini”, në *Ymer Prizreni - personalitet i shquar i Lëvizjes Kombëtare*, Art Club, Ulqin, 2002, f. 159.

<sup>22</sup> Riza Rexha, *Po aty*, f. 158.

mbërritur një myfti i ri nga Stambolli dhe se i propozon që Qendra e Bashkësisë Islame të Malit të Zi të mos jetë më në Ulqin, por të transferohet në Tivar ose në Podgoricë, pasi ka arsye të mira që selia e tij të mos jetë në Ulqin.<sup>23</sup> Ndërkaq, nëpërmjet dokumentacionit arkivor osman mund të kuptohet që pas shkarkimit të Salih Efendi Hylit procedura e emërim-pranimit të myftiut të ri zgjati deri në shtatorin e vitit 1887, kur u arrit kompromisi me të cilin princi e pranon emërimin e myftiut të ri, Hasan Ismet Efendiut, nga Shejhu `l-islami<sup>24</sup>, e cila pason me zhvendosjen e selisë.

Nga sa shihet, ky presion diplomatik i princ Nikollës ndodhi për të rishqyrtuar rregullin e emërimit të myftiut, duke e vënë theksin si fillim të sanksionimi i myftiut nga kombësia shqiptare<sup>25</sup> dhe më pas në vitin

---

<sup>23</sup> Në dokument ceket: "G. Božu Petroviću, Javljaju mi iz Ulcinja, da je tamo juče doša iz Carigrada neki muftija koji kažu da je odredjen za Ulcinj. Molim da mi što javite odnosno njega. Ako je on odredjen za starešinu u zakonu turskom svijema turcima u našim granicama cjelishodnije bi bilo, da mu je središte u Bar ako ne Podgoricu. Ima dobrih razloga protiv toga da mu je sjedište Ulcinj. V. S. Popović", që d.m.th. "Z. Bozho Petroviqit, Më njoftojnë nga Ulqini se dje ka ardhur një myfti nga Stambolli dhe thonë se është caktuar për Ulqin. Ju lutem, më tregoni diçka në lidhje me të. Nëse ai është caktuar si udhëheqës në ligjin turk për të gjithë turqit brenda kufijve tanë, do të ishte më me vend që ai të vendosej në Tivar, ndoshta edhe në Podgoricë. Ka arsye të mira që selia e tij të mos jetë në Ulqin. V. S. Popović". Shih faksimilen nr. III. [www.arkiva.me](http://www.arkiva.me), shkarkuar më 27.05.2024.

<sup>24</sup> Rreth myftiut Hasan Ismet Efendiut kemi pak të dhëna. Edhe dosja e tij personale në Arkivin e Meshihatit në Stamboll ka pak të dhëna rreth jetës dhe veprimtarisë së tij. Por nga dokumentacioni arkivor mund të nxjerrim që në detyrën e myftiut në Mal të Zi qëndroi ndërmjet viteve 1887-1889. Sipas një dokumenti të Arkivit Osman të datës 8 muharrem 1305 h. / 26 shtator 1887 shohim se para se të ishte emëruar myfti i Malit të Zi ka qenë naib (gjykatës) i kazasë së Ishmit. Shih BOA, *HR.TH.*, 75/68. f. 1. Shih faksimilen nr. IV. Kurse pas dhënies së dorëheqjes nga detyra e myftiut, ai do të emërohej naib i kazasë së Turgutlus. Shih MŞH.SAİD, 249/47, f. 3.

<sup>25</sup> Debatet rreth emërimit të myftiut nuk munguan pasi shohim mjaft dokumente që e konstatojnë një gjë të tillë. Në një telegram të Ambasadës Osmane në Cetinë dërguar Ministrisë së Jashtme Osmane, rreth një muaj pas takimit të Ahmet Xhevad Pashës me Princ Nikollën, raportohet se e ka informuar princin që për momentin në Stamboll ishte e vështirë gjetja e një kandidati për myfti, që mund t'i fliste njëkohësisht gjuhën shqipe dhe malazeze. Me mendimin që në Vilajetin e Shkodrës mund të gjendet ndonjë kandidat për myfti, që mund të fliste gjuhën shqipe dhe malazeze i është bërë kërkesa

1887 edhe zhvendosjen e selisë së myftiut nga Ulqini në Podgoricë, një vend me më pak ndikim nga muhamedanët (shqiptarët, A.B.), siç cilësohet në kujtimet e Simo Popoviqit.<sup>26</sup>

Ndërkaq, nga dokumentet e marra në shqyrtim nuk kemi ndeshur në të dhëna rreth qëndrimit të hoxhallarëve dhe popullit të Ulqinit për situatën e krijuar, përveçse aq pak sa mund të kuptohet nëpërmjet realitetit zyrtar ndërshtetëror që e ndeshim në dokumentacionin e marrë në studim. Në të ardhmen duhet të ndriçohet situata dhe realiteti, parë nga perspektiva e hoxhallarëve dhe e popullit, si palë e ndërmjetme zyrtare.

## Përfundim

Në këtë artikull kemi trajtuar çështjet që ndërlidhen me institucionin e Myftinisë që nga formimi i tij me seli në Ulqin në kufijtë e Malit të Zi të dalë nga Kongresi i Berlinit, zhvendosjes së tij nga Ulqini në Podgoricë, kompetencat e emërimit dhe shkarkimit të myftiut, vendin prej nga vjen ai, përkatësinë e tij kombëtare, gjuhën, etj.

Institucioni i Myftinisë u formua në kuadër të nenit 27 të Kongresit të Berlinit, i cili përfshin periudhën kohore mars 1881 - qershor 1912. Në këtë kuadër myftinjte u emëruan nga Shejhu'l-Islami në Stamboll dhe u

---

Vilajetit të Shkodrës dhe se është në pritje të saj. Por nga ana tjetër, princ Nikolla tha se nuk mund të pranonte emërimin e një myftiu nga kombi shqiptar, të cilin e cilësoi si komunitet i pamarrë vesh. Përkundrazi, ai do të pranonte me kënaqësi një myfti nga një komb tjetër, qoftë edhe të mos e fliste gjuhën malazeze. Princi deklaroi se në këtë rast, ai mund të caktojë edhe një përkthyes mysliman për të siguruar komunikimin mes popullit të besimit islam dhe myftiut. Shih BOA, HR.TO., 46/141 (17 kanuni evvel, 1302 rumi / 29 dhjetor 1886); Po kështu çështja e kombësisë dhe e gjuhës së myftiut përsëritet edhe në dokumentin e datës 24 kanuni evvel 1302 rumi / 5 janar 1887 dhe të tjerë. Shih BOA, *ĽMMS.*, 93/3916, f. 3, 7; Uğur Özcan, *Po aty*, f. 237.


<sup>26</sup> Simo Popoviq pohon se pasi u emërua myftiu i Malit të Zi (1887), në fillim u vendos në Ulqin ku ishte selia e myftiut, ndërsa më pas me urdhër të princ Nikollës selia u transferua në Podgoricë. Në kujtimet (memuaret) e veta ai pohon që transferimi i selisë u krye me kërkesën e tij te Princ Nikolla, për të ulur ndikimin e Myftinisë në një vend mysliman (muhamedan), siç ishte Ulqini. Shih Šerbo Rastoder, *Bošnjaci/Muslimani Crne Gore između prošlosti i sadašnjosti*, Almanah, Podgorica, 2010, f. 19.

miratuan nga krajli i Malit të Zi, nëpërmjet të cilëve administrohej jeta fetare islame, duke i shtuar edhe tre kadinjtë (gjykatësit e sheriatit) në Ulqin, Tivar dhe Podgoricë.

Gjatë periudhës 1881-1887 të cilën e kemi trajtuar në këtë artikull, për çështjet e cekura më lart vërehen marrëveshje e nganjëherë edhe mosmarrëveshje zyrtare ndërmjet Malit të Zi dhe qeverisë osmane, pasi në njërën anë Mali i Zi donte që të rriste ndikimin e vet mbi administrimin e fesë islame aq sa të nxirrte nga drejtimi i Myftinisë faktorin shqiptar mysliman, duke qenë se në Ulqin ishte qendra e këtij institucioni.

Ndërkaq, në anën tjetër, qeveria osmane detyrohej që t'i bënte lëshime qeverisë malazeze deri në atë masë sa të mund të ruante lidhjet dhe influencën e vet mbi pjesëtarët e besimit islam, marrëveshje, e cila zgjati deri në qershorin e vitit 1912, kur krajli në mënyrë të njëanshme emëron myfti kadiun e Tivarit.

Nga debatet e hapura zyrtare të këtyre dy shteteve shohim praninë edhe të faktorit mysliman, kryesisht atij shqiptar në Ulqin, të cilët vërehej se nuk mund të ushtronin ndikimin e tyre në këto rrethana, fati i të cilëve diktohej në varësi të marrëveshjeve dhe mosmarrëveshjeve zyrtare ndërshtetërore. Për momentin nuk disponojmë të dhëna të mjaftueshme arkivore, të cilat do të sqaronin akoma më qartë pozicionin e tyre përgjatë këtyre viteve, si fillim në Ulqin e më pas në Tivar e Podgoricë, gjë e cila shton nevojën që në të ardhmen të bëhen hulumtime.




### Harta e Malit të Zi

- Me ngjyrë të verdhë – Përpara vitit 1876.
- Me ngjyrë të gjelbër – Tokat e fituara me Kongresin e Berlinit 1878-1880.
- Me ngjyrë të kaltër – Tokat e fituara në vitin 1913.

Istanbul, Askeri Matbaa-1933.


Shih Abidin Temizer, *Osmanlı-Kardağ sınır anlaşmazlıkları ve çözümü (1878-1912)*, (Temë magistrature), 2007. f. 119.



I.MMS.00093

**Nr. I**

Dokument i Arkivit Osman i datës 25 mars 1301 / 06 prill 1885 miladi, nëpërmjet të cilit shohim shkarkimin e myftiut të Malit të Zi Salih Hylit nga princ Nikolla dhe planet e tij për të emëruar për myfti Ymer Efendi Prizrenin, i cili ishte arratisur nga Prizreni dhe kishte gjetur strehim në Ulqin, por që u ndesh në kundërshtimin e Portës së Lartë.



## Nr. II

Dokument, telegram i ambasadorit të P. Osmane në Cetinë drejtuar Ministrisë së P. J. Osmane, i vitit 1886, nëpërmjet të cilit shohim kërkesen e Shejhu'l-islam-it në drejtim të Vilajetit të Shkodrës me qëllim gjetjen e një kandidati për myfti të Malit të Zi, i cili mund të fliste gjuhën shqipe dhe malazeze. Por nga ana tjetër, princ Nikolla i kishte thënë se nuk mund të pranonte emërimin e një myftiu nga kombi shqiptar, të cilin e cilësoi si komunitet i pa marrën vesh. Përkundrazi, ai do të pranonte me kënaqësi një myfti nga një komb tjetër, qoftë edhe mos njohës të gjuhës malazeze. Princi deklaroi se në këtë rast, ai mund të caktojë edhe një përkthyes mysliman për të siguruar komunikimin mes popullit të besimit islam dhe myftiut.

Архив                      Тора

Г. Кошћу Спасробућу


Јављају ми из Црне Горе, да је тамо јуре  
 гова из Црне Горе неки Мухомир који каже  
 да је одређен за језик. Молим га да ми  
 што јавише о овоме месту. Ако је он одређен  
 за савршени и заједно Црне Горе објекта  
 турског и нашим француским вјештачима  
 је да било, да ми је сједиште у Београду, ако  
 не у другој. Ума доприни разлога о овоме  
 месту да ми је сједиште језик.

Б. С. Спасробућу

**Nr. III**

Viti 1886 – Administratori i Ulqinit, Simo Popović, propozon që Qendra e Bashkësisë Islame të Malit të Zi të mos jetë më në Ulqin, por të zhvendoset në Tivar ose Podgoricë.

Arkivi Shtetëror i Malit të Zi. Shih [www.arkiva.me](http://www.arkiva.me)  
 shkarkuar më 27.05.2024.



IIR.TIT.00075.00068.001

Nr. IV

Dokument i datës 8 muharrem 1305 / 26 shtator 1887, nëpërmjet të cilit shohim përfundimin e procedurës së emërimit të myftiut të ri, Hasan Ismet ef.

---

**Bibliografi:**

***Arkiva***

(BOA) Arkivi Osman i Shtetit – Stamboll

DH.MKT. 2053/91.

DH.ŞFR. 366/57.

Y.PRK.EŞA, 4/31.

I.MMS., 93/3916.

HR.TO., 46/141; HR.TO., 46/57.

HR.TH., 75/68.

(MŞH.SAİD) Arkivi i Meshihatit – Stamboll

MŞH.SAİD, nr. 249/47, (Sejjid Hasan Ismet Efendi)

Bashkësia Islame - Ulqin

Defteri (Regjistri) i Vakëfit të Madh - Ulqin

[www.arkiva.me](http://www.arkiva.me)



# Mediat shqipe në Kosovë dhe përdorimi i internetit në informimin për pandeminë Corona-19

---

Prof. Ass. Dr. Ferid Selimi\*

## Abstrakt

Hulumtimi “Mediat Shqipe në Kosovë dhe Përdorimi i Internetit në Informimin për Pandeminë COVID-19” rrah një çështje të informimit të qytetarëve të Republikës së Kosovës rreth dhe për pandeminë COVID-19. Qëllimi i punimit ishte që të nxjerr në pah, se cilat burime të informacionit janë përdorur nga qytetarët e Republikës së Kosovës dhe cilat nga to ishin më të besueshme. Objektivat e punimit janë që të japim një pasqyrë të qartë rreth përdorimit të internetit, mediave sociale dhe rrjeteve sociale nga qytetarët e Republikës së Kosovës. Duke përdorur metodat sasiorë edhe cilësore, ne kemi arritur deri te konkluzionet që informimi i qytetarëve të Republikës së Kosovës më së tepërmi është bërë nëpërmjet mediave sociale dhe rrjeteve sociale, por që më të

---

\* Autori Prof.Ass.Dr. Ferid Selimi gradën e masterit e ka në Prishtinë Kolegji “Dardania” në fushën e administrimit publik, kurse doktoratën në Universitetin e Tiranës, Fakulteti Histori/Filologji, Departamenti i gazetarisë. Është profesor dhe njëherit dekan i Fakultetin Media dhe Komunikime në Kolegjin UBT në Prishtinë

besueshmet media mbeten edhe më tutje televizioni dhe radioja. Rezultatet janë të matshme dhe lehtë të disponueshme. Megjithatë, punimi ka edhe limitet dhe mangësitë e veta. Së pari mostra ishte e përcaktuar dhe e përzgjedhur. Së dyti, anketa nuk nënkupton që ka një rezultat të saktë 100%. Prandaj, duke pasur parasysh numrin e vogël të respondentëve, do të kishin rekomanduar që studiuesit e tjerë, që do të merren me këtë çështje, të kenë parasysh anketuesit e rastit, heterogjenitetin e etnive të përfshira në anketë, si dhe të zgjerohet kjo çështje në tërë rajonin e Ballkanit Perëndimor.

**Fjalët çelës:** Covid-19; Informimi; Internet; Media Sociale; Respondentë;

## Abstract

The research study titled “Albanian Media in Kosovo and the Use of the Internet in Public Information on the COVID-19 Pandemic” examines the ways in which citizens of the Republic of Kosovo were informed about the COVID-19 pandemic. The primary aim of this study was to identify the sources of information utilized by the citizens of Kosovo and assess their perceived reliability. The objectives include providing a comprehensive overview of internet usage, social media engagement, and the use of social networks among citizens of Kosovo. Utilizing both quantitative and qualitative methodologies, the findings indicate that the primary channels of information were social media platforms, though television and radio continued to be regarded as the most reliable media sources. The results are quantifiable and readily accessible. Nevertheless, the study acknowledges certain limitations. First, the sample was defined and selectively chosen, which may limit generalizability. Second, the survey does not claim absolute

accuracy in its findings. Thus, considering the limited sample size, it is recommended that future researchers explore random sampling methods, incorporate the ethnic diversity of respondents, and expand this research scope to encompass the wider Western Balkans region.

**Keywords:** Covid-19; Informing; Internet; Social Media; Respondents.

## Hyrje

Një nga çështjet më me rëndësi në ditët tona, saktësisht në periudhën nga viti 2020 deri në vitin 2023, e që nisi sërish kah mesi i vitit 2024, ishte përballja me informacione për virusin Korona. Kjo periudhë ishte një nga periudhat, ku qytetarët kanë pasur rastin dhe mundësinë të përcejellin informacione të ndryshme nga interneti, e që për temë kryesore kanë përhapjen dhe sfidat me virusin SARS-Cov-2. Informacioni nga interneti që nganjëherë nuk është i mjaftueshëm, në të vërtetë sjell implikime të tjera.<sup>1</sup> Interneti përfolët gjerësisht nga Mediat sociale për të shpërndarë informacion dhe gjithsesi që herë pas here ka mundur të vë në hamendje publikun e gjerë<sup>2</sup>. Gjatë këtyre ditëve, njerëzit ishin të detyruar të qëndronin në shtëpi dhe interneti dhe mediat sociale ishin mjetet më të shpeshta për informimin e tyre.<sup>3</sup> Përdorimi i platformave të

---

<sup>1</sup> Tina Harrison, Kathryn Waite, Gary Hunter, The internet, information and empowerment. *European Journal of Marketing*, 40(9/10), 972-993. 2006  
[https://www.researchgate.net/publication/242337838\\_The\\_internet\\_information\\_and\\_empowerment](https://www.researchgate.net/publication/242337838_The_internet_information_and_empowerment). DOI:10.1108/03090560610680961

<sup>2</sup> Eytan, Bakshy, Itamar Rosenn, Cameron Marlow, Lada Adamic. The role of social networks in information diffusion. In *Proceedings of the 21st international conference on World Wide Web*, 2012, april (pp. 519-528).

<sup>3</sup> Enakshie Jamnadass, Omar Aboumarzouk, Panagiotis Kallidonis, Esteban Emiliani, Thomas Tailly, Stephan Hruby, Francesco Sanguedolce, Gokhan Atis, Mehmet Ozsoy, Francesco Greco, Bhaskar K Somani The role of social media and internet search en-

mediave sociale është perceptuar dhe perceptohet si i lehtë dhe i arritshëm për çdo individ.<sup>4</sup> Çdo postim a reagim ndaj çdo informacioni mjekësor në lidhje me pandeminë përbënte një gamë më vete në ndërgjegjësimin e qytetarëve, duke ndarë informacionet brenda rrjetit të tyre të mbyllur social.<sup>5</sup> Këto reagime, zakonisht përhapeshin përmes komenteve në rrjetet sociale, si facebook, Instagram, Twitter, etj., si dhe në fund të publikimit të shkrimeve të publikuara në mediat sociale.

Qëllimi i punimit është që të vëmë në pah informimin e qytetarëve të Republikës së Kosovës për pandeminë COVID 19. Objektivat e hulumtimit janë të qarta: Të arrijmë që të paraqesim një pasqyrë të saktë të informimit për pandeminë COVID-19, gjithmonë duke pasur parasysh pyetjen hulumtuese se sa dhe si informoheshin qytetarët e Republikës së Kosovës për pandeminë COVID-19, dhe sa ishin të besueshme burimet e informacionit. Hipoteza e punimit është se qytetarët e Republikës së Kosovës informoheshin kryesisht nga televizionit, radiot, gazetat ditore të shtypura, nga mediat sociale dhe rrjetet sociale dhe burimet e informacionit, që vinin nga mediat audiovizive dhe të shtypura ishin më të besueshme. Punimi ka mangësitë dhe limitet e tija, ngase është përqendruar në një grup të izoluar të respondentëve, të cilët u gjendën dhe u përzgjedhën nëpërmjet rrjeteve sociale.

---

gines in information provision and dissemination to patients with kidney stone disease: a systematic review from European association of urologists young academic urologists. *Journal of Endourology*, 2018, 32(8), 673-684.

<sup>4</sup> Muhammad Saud, Musta'in Mashud, Rachmah Ida. Usage of social media during the pandemic: Seeking support and awareness about Covid,-19 through social media platforms. *Journal of Public Affairs*, 2020, 20(4), e2417.

<sup>5</sup> Muhammad Saud, Musta'in Mashud, Rachmah Ida Usage of social media during the pandemic: Seeking support and awareness about Covid,-19 through social media platforms. *Journal of Public Affairs*, 2020, 20(4), e2417.

## Shqyrtimi i literaturës

Teknologjia dhe interneti kanë ndryshuar mënyrën e komunikimit dhe të informimit të lexuesve.<sup>6</sup>

Informacionet dhe përmbajtjet që publikohen në to, kanë ndikuar në avantazhet, që interneti i ka<sup>7</sup>. Konvergjenca e mediave, që ka zënë vend në faqet e internetit, ka ndryshuar mënyrën se si gazetarët dhe qytetarët japin informacione<sup>8</sup>. Një shqetësim i veçantë është bollëku i informacionit dhe i devijimeve nga faktet e pranuar shkencore, madje edhe në vendet e ofruara nga burimet tradicionale mjekësore.<sup>9</sup> Sipas tyre shembuj të informacionit tepër të gabuar ishin edhe deklaratat se diarreja është metoda e trupit për eliminimin e elementeve të padëshirueshme, se ajo shkaktohet nga ushqimi i padëshiruar, sipas tyre, ka nevojë për informacion të besueshëm dhe të saktë mjekësor në internet.<sup>10</sup> Një shqetësim tjetër është ai psikologjik<sup>11, 12</sup>). Sipas tyre, njerëzit shqetësoheshin për shkak

---

<sup>6</sup> Wayne Buente, Alice Robbin. Trends in Internet information behavior, 2000–2004. *Journal of the American Society for Information Science and Technology*, 2008, 59(11), 1743-1760. <https://asistdl.onlinelibrary.wiley.com/doi/abs/10.1002/asi.20883>.

<sup>7</sup> Michael West, Internet. Michael West. Available from: <https://www.michaelwest.com.au.2018>, <https://files.eric.ed.gov/fulltext/ED406980.pdf#page=298>.

<sup>8</sup> Abdullayeva Shaxrizoda Akbarjonovna Evolution of media: History and development of media, new media, media convergence, influence of technology on media. *Global Scientific Review*, 2024, 30, 11-19. <http://www.scientificreview.com/index.php/gsr/article/view/448/360>.

<sup>9</sup> Thomas Lissman, James Boehnlein. A critical review of internet information about depression. *Psychiatric Services*, 2001, 52(8), 1046-1050. <https://psychiatryonline.org/doi/full/10.1176/appi.ps.52.8.1046>.

<sup>10</sup> Thomas Lissman, James Boehnlein. A critical review of internet information about depression. *Psychiatric Services*, 2001, 52(8), 1046-1050. <https://psychiatryonline.org/doi/full/10.1176/appi.ps.52.8.1046>

<sup>11</sup> Hiroyuki Kikuchi Masaki Machida, Itaru Nakamura, Reiko Saito Yuko Odagiri Takako Kojima Hidehiro Watanabe Keisuke Fukui Shigeru Inoue Changes in psychological distress during the COVID-19 pandemic in Japan: a longitudinal study. *Journal of Epidemiology*, 2020, 30(11), 522-528. [https://scholar.google.com/scholar?hl=en&as\\_sdt=0%2C5&q=Psychological+distress+in+the+population+during+the+pandemic+period&btnG=](https://scholar.google.com/scholar?hl=en&as_sdt=0%2C5&q=Psychological+distress+in+the+population+during+the+pandemic+period&btnG=).

të ndikimeve të informacioneve, që merrnin nga interneti. Dezinformatat dhe thashethemet për virusin, publikimet e pa verifikuara ishin burime të zakonshme shqetësimi<sup>13</sup>, sepse, duhet theksuar që Pandemia COVID 19, në plan të parë solli rolin kryesor të mediave në informimin e publikut dhe krijimin e perceptimeve të qytetarëve dhe pa dyshim edhe krimin e sjelljeve të tyre në kohën, në të cilën përpjekja për marrje të informacionit të saktë ishte shumë e rëndësishme.<sup>14</sup> Kjo periudhë kohore kur interneti ziente nga informacionet e kur mediat shfrytëzonin internetin, ishte një periudhë kohore kur domosdo që interneti dhe informacioni në to, luanin rol thelbësor në formimin e bindjeve dhe të krijimit të perceptimeve të individëve<sup>15</sup>. Në këtë kontekst, gjatë pandemisë COVID-19 në Kosovë, si interneti ashtu edhe mediat luajtën një rol kyç në debatin publik,<sup>16</sup> sepse përmes ofrimit të një mbulimi të gjerë të informacionit

<sup>12</sup> Juan Gómez-Salgado, Ingrid Adanaque-Bravo, Mónica Ortega-Moreno, Regina Allande-Cussó, Cristian Arturo Arias-Ulloa, Carlos Ruiz-Frutos, Psychological distress during the first phase of the COVID-19 pandemic in Ecuador: Cross-sectional study. *PLoS One*, 2021, 16(9), e0257661.

[https://scholar.google.com/scholar?hl=en&as\\_sdt=0%2C5&q=Psychological+distress+in+the+population+during+the+pandemic+period&btnG=](https://scholar.google.com/scholar?hl=en&as_sdt=0%2C5&q=Psychological+distress+in+the+population+during+the+pandemic+period&btnG=).

<sup>13</sup> Samia Tasnim, Md Mahbub Hossain, Hoimonty Mazumder Impact of rumors and misinformation on COVID-19 in social media. *Journal of preventive medicine and public health*, 2020, 53(3), 171-174

<sup>14</sup> Samuli Laato, A. K. M. Najmul Islam, Muhammad Nazrul Islam, Eoin Whelan What drives unverified information sharing and cyberchondria during the COVID-19 pandemic?. *European journal of information systems*, 2020, 29(3), 288-305.

[https://scholar.google.com/scholar?hl=en&as\\_sdt=0%2C5&q=Misinformation+and+rumsors+about+the+virus%2C+unverified+publications+and+uncertainty&btnG=#d=gs\\_cit&t=1726044534139&u=%2Fscholar%3Fq%3Dinfo%3AYBgDurGb1YIJ%3Ascholar.google.com%2F%26output%3Dcite%26scirp%3D5%26hl%3Den](https://scholar.google.com/scholar?hl=en&as_sdt=0%2C5&q=Misinformation+and+rumsors+about+the+virus%2C+unverified+publications+and+uncertainty&btnG=#d=gs_cit&t=1726044534139&u=%2Fscholar%3Fq%3Dinfo%3AYBgDurGb1YIJ%3Ascholar.google.com%2F%26output%3Dcite%26scirp%3D5%26hl%3Den).

<sup>15</sup> Miriam Metzger, Andrew Flanagin. Credibility and trust of information in online environments: The use of cognitive heuristics. *Journal of pragmatics*, 2013, 59, 210-220. [https://scholar.google.com/scholar?hl=en&as\\_sdt=0%2C5&q=the+internet+and+information+in+t+and+their+role+in+forming+beliefs+and+creating+perceptions+of+individuals&btnG=](https://scholar.google.com/scholar?hl=en&as_sdt=0%2C5&q=the+internet+and+information+in+t+and+their+role+in+forming+beliefs+and+creating+perceptions+of+individuals&btnG=).

<sup>16</sup> Jakub Parnes, Internet media as the digital public sphere: Possibilities and problems. *Central European Journal of Communication*, 2016, 9(16), 90-103. <https://www.ceeol.com/search/article-detail?id=458799>.

rreth pandemisë, mediat shpalosën ndikimin e virusit në shëndetin publik dhe me këtë, me qëllim ose pa qëllim shkaktuan debat.<sup>17</sup> Raportimet dhe përditësimet ditore shërbyen si mjet për të informuar publikun e gjithashtu edhe për të formuar perceptimin publik, duke caktuar prioritetet dhe rëndësinë e temave të veçanta. Kështu, mediat në Kosovë, duke shfrytëzuar internetin si dritare, përmes të cilit informonin qytetarët me lajme dhe me analiza të tyre, e që kanë kontribuar në ndërtimin e një perceptimi publik me raste të përshtatshëm për këtë krizë shëndetësore.<sup>18</sup> Duke pasur parasysh teorinë e përgjegjësisë sociale i mbështetur nga Hutchins Commission, në vitin 1947, që thekson detyrimin etik të medias për të vepruar në interesin më të mirë të publikut, duke siguruar informacion të saktë dhe të besueshëm (Hutchins Commission, 1947) roli vendimtar i mediave do të duhej të përqendrohej në parandalimin e shpërndarjes së informacioneve të pasakta, miteve dhe teorive konspirative lidhur me COVID-19, të cilat kishin shfaqur përhapje gjatë kohës së krizës. (Hutchins Commission, 1947) Pra, mediat, duke shfrytëzuar internetin do të duhej që duke përdorur burime të besueshme, me fokus informacionin faktik, të ndihmojnë qytetarët të marrin vendime të arsyeshme për shëndetin dhe sigurinë e tyre. (Qader, I & Zainuddin, 2011)

## Metodologjia

Në këtë punim kemi përdorur metodat sasiore dhe cilësore të hulumtimit shkencor, duke pasur parasysh gjithnjë kornizën teorike relevante, që nënkupton literaturën përkatëse, pastaj edhe anketën, si një nga instrumentet ose të teknikave të grumbullimit të të dhënave. Sa i përket li-

---

<sup>17</sup> Chiara Achangwa, Huikyung Park, Sukhyun Ryu, Moo-Sik Lee, Collateral impact of public health and social measures on respiratory virus activity during the COVID-19 pandemic 2020–2021. *Viruses*, 2022, 14(5), 1071.  
<https://www.mdpi.com/1999-4915/14/5/1071>.

<sup>18</sup> Gëzim Qerimi, Dren Gërguri. Infodemic and the crisis of distinguishing disinformation from accurate information: Case study on the use of facebook in Kosovo during COVID-19. *Information & Media*, 2022, 94, 87-109.  
<https://www.ceeol.com/search/article-detail?id=1129904>

teraturës, kemi përdorur teknikën e topit të borës, gjithmonë duke pasur parasysh relevancën dhe rëndësinë e dobinë e asaj literature të cituar e të parafrzuar. Anketën e kemi kryer nëpërmjet Google Forme, ku i kemi përpiluar pyetjet dhe ato i kemi shpërndarë nëpërmjet rrjetit social Facebook në një hapësirë të kufizuar njerëzish të njohur, përkatësisht nëpërmjet mesazheve të facebookut. Pra, mostra ishin njerëz, që i njihnim dhe atyre u dërguam pyetjet nëpërmjet mesazheve. Përgjigjet e tyre i grumbulluam dhe nga to dolën rezultatet. Anketuesit ishin të përzgjedhurit tanë me mosha të ndryshme, me vendbanime të ndryshme dhe janë të përfshira të dy gjinitë. Gjetjet treguan, që mediat sociale dhe rrjetet sociale janë burimet më të përdorura për informim nga qytetarët, por, edhe pse janë më të përdorura, ato nuk janë aq të besueshme sa janë televizionet e radiot. Mangësitë e punimit janë se anketuesit ishin të përzgjedhurit tanë, pra nuk ishte ndonjë anketues i rastit, por të piketuar, si dhe hulumtimi kishte të bënte vetëm me qytetarët e Republikës së Kosovës, ndërsa ka pasur respondentë edhe nga vendet e rajonit, prandaj edhe rezultatet mbase janë këto që janë.

## Gjetjet

Sipas një kërkimi të mëhershëm të kryer nga “Data Reporter” përdorimi i internetit dhe i rrjeteve sociale në Republikën e Kosovës është mjaftë evident. Saktësisht rrjetet Facebook, Instagram, Snapchat e Twitter, janë rrjetet, që prijnë në përdorim nga qytetarët e Republikës së Kosovës.<sup>19</sup>

Meqenëse, në internet, përdoruesit kanë mundësi të kërkojnë në aplikacione të ndryshme, ne e kemi përgjithësuar përdorimin e internetit, por i kemi specifikuar katër rrjete sociale, që përdoren më së tepërmi nga qytetarët e Republikës së Kosovës, e që janë Facebook, Instagram, Snapchat e Twitter. Rezultatet nga hulumtimi jonë paraqiten në formë tabelare dhe poshtë tabelave, secila veç e veç diskutohet.

---

<sup>19</sup> <https://gazetaenigma.com/facebooku-me-i-perdoruri-ne-kosove/>. (Rishikuar më 23 shtator 2024)

*Tabela 1. Vendbanimi respondentëve*

Vendbanimi i respondentëve		
Respondentët	Nr	%
Urban	322	72
Rural	124	28
Gjithsejtë	446	100

Sipas tabelës 1., ku jepen të dhënat për vendbanimin e respondentëve, shihet që 72% e respondentëve jetojnë në pjesën urbane të Republikës së Kosovës, pa specifikuar rajonin. Ndërsa, 28% e tyre, banojnë në pjesët rurale të vendit. Duke u bazuar në këto përqindje të vendbanimeve, mbase edhe përgjigjet janë ashtu si janë paraqitur në tabelat më poshtë.

*Tabela 2. Moshë e respondentëve*

Moshë e respondentëve		
Vitet	Nr	%
18-39	328	73.5
40-64	98	22
65+	20	4.5
Gjithsejtë	446	100

Tabela 2., paraqet moshën e respondentëve. Në të vërtetë kemi bërë një ndarje të moshës në tri kategori, duke nisur nga moshë 18 vjeçare, kur respondentit mbërrin moshën e rritur dhe këtë kategori e kemi bashkuar me moshën 39 vjeçare, që konsiderohet një moshë e re dhe një moshë e pjekur. Më pas kemi vazhduar me moshën nga 40 deri në moshën 64 vjeçare, që konsiderohet një moshë e mesme, që është e aftë të punojë, dhe në kategorinë e fundit e kemi marrë parasysh moshën nga 65 e tutje, kur personi përfundon etapën kohore të punës dhe hyn në moshën e tretë, atë të pensionimit. Shikuar sipas kësaj ndarjeje, siç shihet në tabelën 2., 328 respondentë ose diku rreth 74% e tyre është e moshës 18-39 vjeçare. Moshë, që mbase më së tepërmi e përdorin internetin. Pastaj, 98 janë të moshës nga 40-64 vjeçare, ose 22% e tyre, dhe krejt në fund,

ata të moshës së tretë, e që janë të moshës mbi 65 vjeçare, që përbën numrin 20 të repondentëve, ose vetëm 4.5%.

*Tablea 3. Gjinia e respondentëve*

Mosha		
Respondentët	Nr	%
Meshkuj	240	54
Femra	206	46
Gjithsejtë	446	100

Siç shihet edhe në tabelën 3., sa i përket gjinisë së respondentëve, në këtë hulumtim janë përfshirë 240 meshkuj ose 54% e respondentëve të përgjithshëm dhe 206 femra ose 46% e tyre. Kjo përzgjedhje nuk ishte e qëllimshme, edhe pse siç e kemi shpjeguar te metodologjia, të anketuar ishin miqtë e facebookut, por kjo përqindje kaq e përafërt ndërmjet meshkujve dhe të femrave, ishte e rastësishme. Në të vërtetë të gjithë këta ishin miq tanë, por ne, anketën e kemi shpërndarë në mesenxher të 4800 vetave, aq sa kemi miq në facebook. Prej këtij numri, janë përgjigjur vetëm 446 respondentë ose rreth 10 % e miqve nga numri i përgjithshëm, që figurojnë si miq në facebook.

*Tabela 4. Koha e kaluar në internet e respondentëve për informim rreth pandemisë COVID 19*

Koha e kaluar në internet për informim për pandeminë COVID 19		
Orë	Nr	%
Një orë deri në dy orë	268	60
Tri orë deri në pesë orë	98	22
Pesë orë e më shumë	80	18
Gjithsejtë	446	100

Kohëzgjatja e përdorimit të internetit për t'u informuar rreth pandemisë COVID-19, siç është paraqitur në tabelën 4, tregon që më së shumti, që përdoret interneti është nga 1-2 orë, e që e kanë konfirmuar 268 respondentë ose 60% e tyre. Nga 3-5 orë e përdorin 98 respondentë ose

rreth 22% e tyre, dhe më shumë se 5 orë përdoret nga 80 respondentë ose prej rreth 18% të respondentëve.

*Tabela 5. Burimi i informacionit për pandeminë COVID 19*

Burimi i informacioneve për pandeminë COVID 19		
Mediat	Nr.	%
Gazetë e shtypur	20	4.5
Televizion	88	19.8
Radio	49	10.9
Media online	138	30.9
Rrjete Sociale: Facebook, Instagram; Snapchat, Twitter	151	33.9
Gjithsejtë	446	100

Te burimi i informacionit, që kishte të bënte me pandeminë COVID-19, ka një larmishmëri e përgjigjeve. Siç shihet në tabelën 5., përderisa 20 veta ose 4.5% e tyre e përdorin gazetën e shtypur, Radion e përdorin 49 ose rreth 11%. Televizionin e përdorin vetëm 88 veta ose rreth 20%. Këtu prijnë rrjetet sociale: facebook, Instagram. Snapchat e Twitter me 151 respondentë ose me rreth 34% të tyre, e pas saj janë mediat online, që e përbëjnë numrin prej 138 respondentëve ose rreth 31% e tyre. Pra, sipas këtyre rezultateve, del që rrjetet sociale dhe mediat sociale prijnë për nga burimi i informacionit të respondentëve. Pastaj vjen televizioni, radioja e në fund gazetatat e shtypura.

*Tabela 6. Besueshmëria e informacionit për pandeminë COVID 19*

Besueshmëria e informacionit për pandeminë COVID 19		
Mediat	Nr	%
Gazetat e shtypura	20	4.5
Televizion	206	46
Radio	178	40
Media Sociale	28	6.3
Rrjetet Sociale: Fb, Instagram; Twitter	14	3.2
Gjithsej	446	100

Te besueshmëria ndryshon rezultati. Siç shihet në tabelën 6., televizioni prin me besueshmëri. Në të vërtetë 206 respondentë ose rreth 46% e respondentëve u besojnë më së shumti lajmeve ose burimit të informacionit, që kanë marrë ose marrin nga televizioni. I dyti për besueshmëri vjen radioja që përfshin numrin prej 178 respondentëve ose me rreth 40%. Ndërsa Mediat Sociale me 28 respondentë ose 6.3%, mediat e shtypura me 4.5% dhe rrjetet sociale me 14 respondentë e me 3.2% shihet që nuk kanë ndonjë besueshmëri të madhe te respondentët. Kjo në të vërtetë tregon se si mediat e shtypura (në Kosovë nuk kanë mbetur asnjë) dhe mediat sociale, të cilat pavarësisht se vizitohen më së shumti prej respondentëve, sa i përket besueshmërisë, janë të fundit.

## Konkluzione

Bazuar në të dhënat dhe gjetjet e këtij hulumtimi, mund të konkludohet, që qytetarët e Republikës së Kosovës, sa i përket informimit për Pandeminë COVID-19, janë furnizuar me informacione nga të gjitha burimet e mundshme, por më së shpeshti janë furnizuar nga mediat sociale dhe nga rrjetet sociale. Gazetat e shtypura janë përdorur më së paku rreth informacioneve, që kishin të bënin me pandeminë COVID-19, nga fakti se që nga marsi i vitit 2020, ato më nuk funksionojnë në Kosovë, por që qytetarët mund të përcillnin gazetat ditore të shtypura në shtetet e rajonit. Për përdorim të burimeve informative, qytetarët janë shërbyer dhe shërbehen edhe nga televizionet dhe radiot, të cilat sipas tyre janë më të besueshmet. Pra, edhe pse pjesa dërrmuese e qytetarëve, thuhet tërë informimin për pandeminë COVID-19 e kanë marrë nga mediat sociale dhe rrjetet sociale, megjithatë, këtyre burimeve të informacionit nuk i kanë besuar sa u kanë besuar burimeve të informacionit nga televizionet dhe nga radiot.

# KRONIKĚ



# Aktivitete të Fakultetit të Studimeve Islame

## 1 janar 2024 - 30 qershor 2024

---

Mr. Vedat Shabani\*

### “AKADEMI PËR STUDIME ISLAME DHE LIDERSHIP”

Më 2 maj të vitit 2024, në ambientet e Fakultetit të Studimeve Islame, është bërë promovimi i “Akademisë për Studime Islame dhe Lidërsip”.

Kjo Akademi është projekt i përgatitur nga Bashkësia Islame e Kosovës, implementues i të cilit do të jetë Fakulteti i Studimeve Islame.

Kjo akademi ka një program njëvjeçar për të diplomuarit jashtë vendit në Studime Islame dhe për të tjerët të interesuar për këto studime. Qëllimi i programit është të ndihmojë të diplomuarit jashtë vendit, që të ambientohen me rrethanat dhe traditat vendore dhe që të arrijnë t'i artikulojnë e të zbatojnë njohuritë e tyre në mënyrë efektive.

Programi përmban elemente akademike dhe profesionale për të ofruar një përvojë të pasur intelektuale dhe praktike.

---

\* Autori Mr. Vedat Shabani, masterin e ka përfunduar në Universitetin e Prishtinës, Fakultetin Juridik, drejtimi civil. Ligjëron lëndën e Drejta Civile në Fakultetin të Studimeve Islame në Prishtinë

Dhe njëherit është edhe sekretar i Fakultetit. E-Mail: Vedat.Shabani@fsi-edu.ne

## KONFERENCA SHKENCORE, TRYEZA, LIGJËRATA, TRAJNIME

Në vazhden e aktiviteteve të Fakultetit të Studimeve Islame në fuqshën e ngritjes së kapaciteteve shkencore dhe hulumtuese janë edhe aktivitetet në vijim, të cilat janë realizuar në gjashtëmujorin e parë të vitit kalendarik 2024:

Më 5 shkurt, në Bibliotekën e Fakultetit të Studimeve Islame në Prishtinë, për të shënuar 1 shkurtin, Ditën Ndërkombëtare të Hixhabit, muajin kundër diskriminimit ndaj grave besimtare, që bartin shami, u mbajt një panel diskutimi me gratë aktive në jetën publike, akademike dhe fetare të Kosovës. Për të hedhur dritë mbi padrejtësitë historike me të cilat janë ballafaquar gratë e Kosovës dhe për të mësuar për sakrificat, fuqinë intelektuale dhe shpirtërore të grave heroina, në panel diskutuan:

Panelistet:

1. Dr. Sabile Keçmezi Basha - akademike, historiane dhe poete, "*Kontributi i grave në çështjen kombëtare*".
2. Dr. Flora Brovina - mjeke, politikane dhe poete, "*Krijimtaria letrare e grave gjatë okupimit serb*".
3. Dr. Ilmije Kuqi – Profesoreshë e jurisprudencës islame në Fakultetin e Studimeve Islame në Prishtinë, "*Besimi si burim i fuqisë në tejkalimin e padrejtësive historike*".

Më 22 prill, në sallën e Konferencave të Fakultetit të Studimeve Islame është mbajtur ligjëratë me temë: "**Ndërpresim zinxhirin e dhunës ndaj grave me zinxhirin e mbështetjes ndaj grave**", për t'u ngritur kundër dhunës ndaj grave dhe për të zgjeruar zinxhirin e mbështetjes për gratë. Për të ligjëruar këtë temë, ishin të ftuara profesoresha e Fakultetit të Studimeve Islame **Mr. Besa Ismaili**, dhe konsulentja në Këshillin e Evropës **znj. Adelina Toplica**.

Më 2 maj, Fakulteti i Studimeve Islame organizoi një trajnim me studentët e vitit të tretë dhe katërt me temë **“Lidershipi dhe intelegjenca emociale”**. Qëllimi i këtij trajnimi ishte ngritja dhe avancimi i dijeve dhe i shkathtësive të studentëve në karrierën e tyre akademike.

Me 4 dhe 5 maj, FSI në bashkëpunim me Qendrën për Studime të Avancuara në Sarajevë CNS dhe qendra Nahla po ashtu në Sarajevë organizuan seminar rajonal me temën: **“Gratë Muslimane në Institucionet Arsimore dhe Fetare - Sfidat dhe Mundësitë”**. Qëllimi i takimit ishte të jetë një platformë pasuruese dhe nxitëse për diskutime, rrjetëzim dhe shkëmbim njohurish mbi një temë me rëndësi të madhe. Konferenca bashkoi gra mësuese, studiuese, praktikante dhe aktiviste nga Kosova, Bosnja, Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Novi Pazari dhe Mali i Zi, për të eksploruar sfidat e ndryshme me të cilat përballen gratë muslimane në institucione dhe qendra të ndryshme arsimore dhe fetare, si dhe mundësi për fuqizim dhe përparim.

## VIZITAT DHE BASHKËPUNIMI VENDOR DHE NDËRKOMBËTAR

Më 22 shkurt, Dekani i Fakultetit të Studimeve Islame, Prof. Asoc. Dr. Islam Hasani, ka pritur në takim zëvendëskryetarin e DIJANET-it të Turqisë, z. Kadir Dinç, i cili shoqërohej nga drejtori i Përgjithshëm i Administratës, z. Bunjamin Kahraman, shefi i Departamentit të Vendeve të Euro-Azisë, z. Salih Gör dhe nga atasheu për Çështje Fetare në Ambasadën e Turqisë, z. Bunjamin Albayrak.

Pas takimit me dekanin, mysafirët zhvilluan një takim edhe me disa prej studentëve të Fakultetit dhe një pjesë të stafit akademim, ku u bisedua rreth sistemit të arsimit fetar në Turqi.

Më 4 mars, në FSI ishte për vizitë një delegacion nga Fondacion “Shejh Zayed” të Emirateve të Bashkuara Arabe, në përbërje të z. Maxhid

al Mansuri, znj. Aljae al Ubejdli, znj. Shejhata al Bulushi dhe znj. Menaal al Vahbi. Mysafirët i priti dekani i FSI-së, Prof. Asoc. Dr. Islam Hasani, me bashkëpunëtorë.

Dekani fillimisht i falënderoi mysafirët për vizitën e tyre në FSI dhe i njohu me aktivitetet e FSI-së, stafin akademik, studentët dhe programet, të cilat ofron FSI për studentët e interesuar.

Më 4 mars, në FSI ishte për vizitë Reisi i Bashkësisë Islame të Malit të Zi, z. Rifat ef. Fejzić, i shoqëruar nga z. Omer Kajoshaj.

Mysafirët i priti dekani i FSI-së, Prof. Asoc. Dr. Islam Hasani, me bashkëpunëtorë, i cili fillimisht i falënderoi për vizitën në FSI, duke u shprehur mirëseardhje. Dekani i FSI-së, shprehu gatishmëri për lehtësimin e procedurave të pranimit të të gjithë kandidatëve, të cilët vijnë nga Mali i Zi për vazhdimin e studimeve në nivelin BA dhe MA.

Më 7 mars, për vizitë në Fakultetin e Studimeve Islame në Prishtinë, ishte ambasadori jorezident i Malajzisë, sh.t. Zahid Rastam.

Më 18 prill, në FSI ishte për vizitë Rektori i “Universitetit Xhumhurijet” të Sivasit – Turqi, Prof. Dr. Alim Yildiz, i shoqëruar nga dekani i Fakultetit të Edukimit dhe përgjegjës për marrëdhënie me jashtë, Prof. Dr. Ali Aksu. Qëllimi i vizitës ishte nënshkrimi i marrëveshjes në kuadër të Erasmus+ për mobilitet të stafit dhe të studentëve të të dy institucioneve.

Më 14 maj, në FSI për vizitë ishte drejtori i Institutit “Yunus Emre”, z. Ramazan Yilmaz, të cilin e priti dekani, Prof. Asoc. Dr. Islam Hasani së bashku me sekretarin e Fakultetit, Mr. Vedat Shabani.

Më 14 maj, maturanët e Medresesë “Alauddin” në Prishtinë, të shoqëruar nga profesorët e kësaj shkolle, Mr. Ekrem Maqedonci, Mr. Driton Arifi dhe Mr. Hysni Beka, vizituan Fakultetin e Studimeve Islame në Prishtinë. Qëllimi i kësaj vizite ishte që të informoheshin më për së afër-

mi me programet, të cilat ofron FSI për kandidatët e interesuar për studime në këtë institucion.

Më 15 maj, maurantet e Medresesë “Alauddin” në Prishtinë, të shoqëruar nga profesorët e kësaj shkolle, Dr. Samir Ahmeti dhe Prof. Hatixhe Jashanica, vizituan Fakultetin e Studimeve Islame në Prishtinë. Qëllimi i kësaj vizite ishte, që ato të informohen më për së afërmi me programet, të cilat ofron FSI për kandidatët e interesuar për studime në këtë institucion.

Më 17 maj, në FSI ishte për vizitë kapelani i KFOR-it amerikan, Major Lovel dhe asistenti i tij z. Youngblood. Mysafirët i priti dekani i Fakultetit së bashku me sekretarin. Dekani fillimisht u shprehu mirëseardhje mysafirëve dhe i njoftoi me historikun e FSI-së, stafin akademik dhe programet, të cilat ofron FSI për studentët e interesuar. Karakteri i vizitës ishte me qëllim të njoftimit më për së afër dhe mundësisë së bashkëpunimit e të ofrimit të shërbimeve komunitetit.

## AKTIVITETE TË STUDENTËVE

Më 6 mars, studentët e Fakultetit të Studimeve Islame kanë organizuar një aktivitet në prag të muajit të Ramazanit. Qëllimi i aktivitetit ishte shpërndarja e disa librave, të cilat flasin rreth vlerës dhe dispozitave të agjërimit.